

**PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI
PËR PERSONAT ME AFTËSI
TË KUFIZUAR**

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë, 2020

ISBN: 978-9928-01-115-2

Adresa

Rruga: “Nikolla Jorga”

Tel/fax: +355 42 427005, 04 2427006

E-mail: info@qbz.gov.al,

Web: www.botimezyrtare.gov.al

PËRMBAJTJA

Ligj nr. 108/2012 datë 15.11.2012	Për ratifikimin e konventës së OKB-së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”	7
Vendim i KM nr. 460, datë 27.5.2015	Për miratimin e raportit të parë kombëtar për zbatimin e konventës së OKB-SË “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”	28
Ligj nr. 7889 datë 14.12.1994	Për statusin e invalidëve të punës - <i>ndryshuar me ligjin nr. 8052, datë 21.12.1995; nr. 9143, datë 16.10.2003</i>	28
Vendim i KM nr. 199, datë 3.5.1995	Për lehtësitë që u krijojnë invalidëve në ndërtimet publike	31
Vendim i KM nr. 612, datë 6.11.1995	Për favorizimin e invalidëve në sistemin e kulturës, rinisë dhe sporteve	32
Vendim i KM nr. 869, datë 18.6.2008	Për zbatimin e ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 “Statusi i invalidit” - <i>ndryshuar me VKM nr. 1075, datë 23.7.2008; nr. 1235, datë 16.12.2009; nr. 38, datë 19.1.2011</i>	33
Vendim i KM nr. 1503, datë 19.11.2008	Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”	34
Ligj nr. 8098 datë 28.3.1996	Për statusin e të verbërit - <i>ndryshuar me ligjin nr. 26/2012, datë 15.3.2012</i>	34
Vendim i KM nr. 671, datë 15.12.2000	Për krijimin e Komisionit Mjekësor të Përcaktimit të Verbërisë - <i>ndryshuar me VKM nr. 221, datë 10.4.2003</i>	37
Udhëzim i MSHIAP nr. 4038, datë 4.9.2015	Për përcaktimin e shërbimeve universale postare, që ofrohen pa pagesë, për personat e verbër dhe pjesërisht të verbër	38
Urdhër i MSHMS nr. 47/1, datë 11.1.2018	Për miratimin e rregullores “Për organizimin, të drejtat, detyrat dhe funksionimin e Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për punë, për vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe Komisionit Mjekësor të Përcaktimit të Verbërisë”	39
Ligj nr. 8626 datë 22.6.2000	Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik - <i>ndryshuar me ligjin nr. 9506, datë 3.4.2006; nr. 27/2012, datë 15.3.2012</i>	46
Vendim i KM nr. 31, datë 20.1.2001	Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik - <i>ndryshuar me VKM: nr. 302, datë 27.6.2002; nr. 619, datë 7.9.2006; nr. 871, datë 18.6.2008; nr. 1689, datë 17.12.2008; nr. 326, datë 12.3.2009; nr. 1236, datë 16.12.2009; nr. 604, datë 23.7.2010; nr. 37, datë 19.1.2011</i>	49
Vendim i KM nr. 387, datë 31.5.2001	Për përjashtimin nga taksat dhe tatimet të invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë	51
Vendim i KM nr. 78, datë 7.2.2007	Për masën, kriteret dhe procedurat e përfitimit të një pakete të veçantë higjieno-sanitare, për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë - <i>ndryshuar me VKM: nr. 873, datë 18.6.2008; nr. 327, datë 12.3.2009; nr. 1238, datë 16.12.2009; nr. 39, datë 19.1.2011</i>	52

Vendim i KM nr. 404, datë 20.6.2012	Për përcaktimin e masës së kritereve e të procedurave të përfitimit të kompensimit financiar, nga personat me statusin e të verbrit dhe invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik, për faturën e energjisë elektrike dhe faturën e telefonisë fikse	53
Udhëzim i MMSR nr. 3, datë 10.3.2014	Për planifikimin e fondeve të pagesave për aftësinë e kufizuar <i>-ndryshuar me udhëzimin nr. 7, datë 25.2.2015; nr. 620, datë 27.12.2017</i>	54
Udhëzim i MMSR nr. 9, datë 25.2.2015	Mbi zbatimin e vendimit nr. 404, datë 20.6.2012 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e masës së kritereve e të procedurave të përfitimit të kompensimit financiar, nga personat me statusin e të verbrit dhe invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik, për faturën e energjisë elektrike dhe faturën e telefonisë fikse”	58
Ligj nr. 93/2014 datë 24.7.2014	Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara	60
Vendim i KM nr. 48, datë 21.1.2015	Për miratimin e rregullores për funksionimin e Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar <i>-ndryshuar me VKM nr. 196, datë 4.4.2018</i>	67
Vendim i KM nr. 708, datë 26.8.2015	Për llojet, periodicitetin dhe mënyrën e raportimit të të dhënave statistikore për aftësinë e kufizuar nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor <i>- ndryshuar me VKM nr. 411, datë 19.6.2019</i>	73
Vendim i KM nr. 1074, datë 3.12.2015	Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara	78
Urdhër i MTI nr. 329, datë 2.12.2014	Për miratimin e rregullores “Për të drejtat e invalidëve dhe personave me aftësi të kufizuara lëvizëse kur udhëtojnë nëpërmjet ajrit”	82
Ligj nr. 121/2016 datë 24.11.2016	Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë	90
Udhëzim i MSHMS nr. 597, datë 22.12.2017	Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, asistencë shtëpiake, për personat me aftësi të kufizuara	109
Ligj nr. 57/2019 datë 18.7.2019	Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë	110
Vendim i KM nr. 722, datë 11.11.2019	Për përcaktimin e masës, të kritereve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre	123
Vendim i KM nr. 182, datë 26.2.2020	Për përcaktimin e masës, të kritereve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ndihmës personal	128
Udhëzim i MSHMS nr. 667, datë 1.10.2019	Për metodologjinë e kontrollit të vlerësimit bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar	138
Vendim i KM nr. 617, datë 7.9.2006	Për përcaktimin e treguesve të vlerësimit dhe të monitorimit të programeve të ndihmës ekonomike, të pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe të shërbimeve shoqërore	162

Udhëzim i MPÇSSHB nr. 1945, datë 4.10.2010	Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.617, datë 7.9.2006 “Për përcaktimin e treguesve të vlerësimit dhe të monitorimit të programeve të ndihmës ekonomike, të pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe të shërbimeve shoqërore” <i>-ndryshuar me udhëzimin nr. 10, datë 3.7.2014</i>	170
Vendim i KM nr. 822, datë 6.12.2006	Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuar, në qendrat rezidenciale dhe ditor	192
Udhëzim i MPÇSSHB nr. 1730, datë 27.8.2010	Për zbatimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për personat me aftësi të kufizuara, në qendrat rezidenciale dhe ditore	201
Vendim i KM nr. 526, datë 6.8.2014	Për kategoritë e personave me aftësi të kufizuara që trajtohen me përparësi si përfitues të programeve sociale të strehimit	205
Vendim i KM nr. 8, datë 14.1.2015	Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 kWh në muaj <i>- ndryshuar me VKM nr. 495, datë 29.6.2016</i>	206
Udhëzim i përbashkët i MF, MEI, MMSR nr. 1, datë 2.2.2015	Mbi zbatimin e vendimit nr. 8, datë 14.1.2015 të Këshillit të Ministrave për mbrojtjen e shtresave në nevojë, nga heqja e fashës deri në 300 kWh për faturimin e çmimit të energjisë elektrike <i>-ndryshuar me udhëzimin nr. 15, datë 8.4.2015</i>	207
Vendim i KM nr. 431, datë 8.6.2016	Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit, procedurave dhe të masës për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre në zonat pilot <i>- ndryshuar me VKM nr. 150, datë 13.3.2018; nr. 722, datë 11.11.2019</i>	213
Udhëzim i përbashkët i MMSR dhe MSH nr. 21, datë 7.10.2016	Për miratimin e kriterëve për vlerësimin bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar të rriturit dhe fëmijët në zonat pilot	218
Udhëzim i MMSR nr. 1, datë 3.2.2017	Për procedurën e hedhjes së të dhënave në arkivin e Regjistrat Elektronik Kombëtar të Aftësisë së Kufizuar	219
Udhëzim i përbashkët i MMSR dhe MSH nr. 7, datë 21.4.2017	Mbi zbatimin e vendimit nr. 431, datë 8.6.2016 të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit, procedurave dhe të masës për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre në zonat pilot <i>-ndryshuar me udhëzimin nr. 598, datë 22.12.2017</i>	222
Udhëzim i MSHMS nr. 596, datë 1.8.2019	Mbi përcaktimin e masës për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal	274
Vendim i KM nr. 566, datë 29.9.2018	Për procedurat e kryerjes së kontrollit të veprimtarisë e të zbatimit të legjislacionit për ndihmën ekonomike dhe aftësinë e kufizuar në strukturat e varësisë së Shërbimit Social Shtetëror dhe pranë njësive të vetëqeverisjes vendore	276
Udhëzim i MASR nr. 26, datë 25.11.2019	Për mësuesin ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar	279

LIGJ
Nr. 108/2012

**PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS SË OKB-SË “PËR TË DREJTAT E
PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet konventa e OKB-së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”, bërë në Nju-Jork më 13 dhjetor 2006.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 15.11.2012

**Shpallur me dekretin nr. 7842, datë 3.12.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

KONVENTA
MBI TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Preambulë

Shtetet palë në këtë konventë:

a) *Duke pasur parasysh se*, në përputhje me parimet e shpallura në Kartën e Kombeve të Bashkuara, të cilat njohin dinjitetin e lindur dhe të drejtat e barabarta dhe të patjetërsueshme të të gjithë anëtarëve të familjes së njeriut si bazë të lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë;

b) *Duke pranuar se* Kombet e Bashkuara, në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe në paktet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, kanë shpallur dhe kanë pranuar që çdo njeri gëzon të gjitha të drejtat dhe liritë të parashtruara në to, pa asnjë dallim të çfarëdo lloji;

c) *Duke pohuar se* universaliteti, pandashmëria, ndërvarësia dhe ndërlidhja e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe nevojës së personave me aftësi të kufizuara për t'i garantuar ato pa diskriminim;

d) *Duke pasur parasysh se* Konventa ndërkombëtare mbi të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore, Konventa ndërkombëtare mbi të drejtat civile dhe politike, Konventa ndërkombëtare mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racial, Konventa ndërkombëtare mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave, Konventa kundër torturës dhe formave të tjera të trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor apo poshtërues, Konventa mbi të drejtat e fëmijëve dhe Konventa ndërkombëtare mbi mbrojtjen e të drejtave të të gjithë punonjësve migrues dhe anëtarëve të familjeve të tyre;

e) *Duke pranuar se* aftësia e kufizuar është një koncept evolues dhe se aftësia e kufizuar rezulton nga ndërveprimi ndërmjet personave me dëmtime dhe barrierave të qëndrimit/mentalitetit dhe ambientit, që pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në nivel të barabartë me të tjerët;

f) *Duke pranuar* rëndësinë e parimeve dhe udhëzimeve politike të shprehura në programin botëror të veprimit lidhur me personat me aftësi të kufizuara dhe në rregullat standarde mbi barazinë e mundësive për personat me aftësi të kufizuara, të cilat ndikojnë në promovimin, formulimin dhe vlerësimin e politikave, planeve, programeve dhe veprimeve në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar për të çuar më tej barazinë e mundësive për personat me aftësi të kufizuara;

g) *Duke theksuar* rëndësinë e përfshirjes së çështjeve të aftësisë së kufizuar si një pjesë përbërëse të strategjive përkatëse për zhvillim të qëndrueshëm;

h) *Duke pranuar gjithashtu se* diskriminimi ndaj çdo personi i bazuar në aftësinë e kufizuar është një dhunim i dinjitetit të lindur dhe vlerës së personit;

i) *Duke pranuar* më tej diversitetin e personave me aftësi të kufizuara;

j) *Duke pranuar* nevojën për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e njeriut të të gjithë personave me aftësi të kufizuara, përfshirë dhe ata që kërkojnë mbështetje më intensive;

k) *Duke qenë të shqetësuar se*, pavarësisht nga të gjitha këto instrumente dhe ndërmarrje, personat me aftësi të kufizuara vazhdojnë të ndeshen me barrierë në pjesëmarrjen e tyre si anëtarë të barabartë të shoqërisë dhe me dhunime të të drejtave të tyre njerëzore në të gjitha pjesët e botës;

l) *Duke pranuar* rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar për përmirësimin e kushteve të jetesës së personave me aftësi të kufizuara në çdo vend dhe veçanërisht në vendet në zhvillim;

m) *Duke pranuar* kontributet e vlefshme ekzistuese dhe potenciale të bëra nga personat me aftësi të kufizuara për mirëqenien e përgjithshme dhe diversitetin e komuniteteve të tyre, dhe se promovimi i gëzimit të plotë të të gjitha të drejtave të tyre njerëzore dhe lirive themelore nga personat me aftësi të kufizuara, si dhe pjesëmarrjes së plotë nga personat me aftësi të kufizuara do të çojë në rritjen e sensit të tyre të përkatësisë dhe në një përparim të konsiderueshëm të zhvillimit njerëzor, shoqëror dhe ekonomik të shoqërisë dhe zhdukjes së varfërisë;

n) *Duke pranuar rëndësinë* që ka për personat me aftësi të kufizuara autonomia dhe pavarësia e tyre personale, duke përfshirë dhe lirinë për të bërë vetë zgjedhjet e tyre;

o) *Duke pasur në konsideratë se* personat me aftësi të kufizuara duhet të kenë mundësinë të përfshihen aktivisht në proceset vendimmarrëse për politikën dhe programet, përfshirë ato që kanë të bëjnë direkt me ta;

p) *Duke qenë të shqetësuar* për kushtet e vështira që ndeshin personat me aftësi të kufizuara, të cilët u nënshtrohen formave shumëfishe apo të rënduara të diskriminimit mbi bazë race, ngjyre, gjinie, gjuhe, besimi fetar, bindje politike apo të tjera, kombësie, origjine etnike apo shoqërore, pasurie, lindjeje, moshe apo gjendje të tjera;

q) *Duke pranuar se* gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara janë shpeshherë më shumë të rrezikuara, si brenda dhe jashtë shtëpisë, nga dhuna, dëmtimi apo abuzimi, neglizhenca apo trajtimi neglizhent, keqtrajtimi apo shfrytëzimi;

r) *Duke pranuar se* fëmijët me aftësi të kufizuara duhet të gëzojnë plotësisht të drejtat e njeriut dhe liritë themelore në baza të barabarta me fëmijët e tjerë, dhe duke pasur parasysh detyrimet lidhur me këtë qëllim të ndërmarra nga shtetet palë në Konventën mbi të drejtat e fëmijës;

s) *Duke theksuar* nevojën për të përfshirë një perspektivë gjinore në të gjitha përpjekjet për të promovuar që personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë plotësisht të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut;

t) *Duke theksuar faktin se* shumica e personave me aftësi të kufizuara jetojnë në kushte të varfërisë dhe duke pranuar kështu nevojën kritike për të zgjidhur ndikimin negativ të varfërisë te personat me aftësi të kufizuara;

u) *Duke pasur në mendje se* kushtet e paqes dhe të sigurisë, të bazuara në respektimin e plotë të qëllimeve dhe parimeve që përmban Karta e Kombeve të Bashkuara dhe vëzhgimi i

instrumenteve të aplikuara për të drejtat e njeriut janë të domosdoshme për mbrojtjen e plotë të personave me aftësi të kufizuara, veçanërisht gjatë konflikteve të armatosura dhe pushtimeve të huaja;

v) *Duke pranuar* rëndësinë e mundësimit të ambienteve fizike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore, në shëndet dhe arsimim dhe informacionit e komunikimit, për të mundësuar personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë plotësisht të drejtat dhe liritë themelore të njeriut;

w) *Duke kuptuar* se individë, duke pasur detyrime ndaj individëve të tjerë dhe komunitetit të cilit ai apo ajo i përket, ka përgjegjësinë të bëjë përpjekje për promovimin dhe respektimin e të drejtave të njohura në paketat ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut;

x) *Duke qenë* të bindur se familja është njësia e përbërë natyrale dhe themelore e shoqërisë dhe ka të drejtë të mbrohet nga shoqëria dhe shteti, dhe se personat me aftësi të kufizuara dhe anëtarët e tyre të familjes duhet të marrin mbrojtjen dhe asistencën e duhur, me qëllim që të bëjnë të mundur që familjet të kontribuojnë që personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë të drejtat e tyre në mënyrë të plotë dhe të barabartë;

y) *Duke qenë të bindur* se një konventë ndërkombëtare gjithëpërfshirëse dhe integrale për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat dhe dinjitetin e personave me aftësi të kufizuara do të japë një kontribut domethënës për të balancuar dizavantazhin e thellë shoqëror të personave me aftësi të kufizuara dhe të promovojë pjesëmarrjen në sferat shoqërore, politike, ekonomike dhe kulturore me mundësi të barabarta, si në vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim,

kanë rënë dakord për sa më poshtë:

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj konvente është të promovojë, të mbrojë dhe të sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të promovojë respektimin e dinjitetit të tyre të lindur.

Personat me aftësi të kufizuara përfshijnë ata që kanë dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata, të cilat, në ndërveprim me barrierat të ndryshme, mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët.

Neni 2 Përkufizimet

Për qëllimet e kësaj konvente:

“Komunikim” përfshin gjuhët, shfaqje teksti, *Braille*, komunikimin me prekje, printim me germë të madhe, multimedian digjital, si dhe gjuhë të qartë, të dëgjuar dhe të shkruar, lexues dhe mënyra, mjete dhe forma komunikimi shtesë apo alternative, përfshirë informacionin digjital dhe teknologjinë e komunikimit.

“Gjuha” përfshin gjuhën e folur dhe gjuhën e shenjave, si dhe forma të tjera të gjuhës jo të folur.

“Diskriminim me bazë aftësinë e kufizuar” do të thotë që çdo dallim, përjashtim apo kufizim me bazë aftësinë e kufizuar, që ka si qëllim ose ndikon në dëmtimin apo anulimin e njohjes, gëzimit apo ushtrimit, mbi baza të barabarta me të tjerët, të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile apo në ndonjë fushë tjetër. Ky përkufizim përfshin të gjitha format e diskriminimit, duke përfshirë dhe mohimin e akomodimit të arsyeshëm.

“Akomodim i arsyeshëm” do të thotë modifikim dhe rregullim i nevojshëm dhe i përshtatshëm që nuk krijon një barrë disproporcionale, që është i nevojshëm në raste të veçanta, për t’u siguruar personave me aftësi të kufizuara gëzimin dhe ushtrimin e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut me baza të barabarta me të tjerët.

“Projektim universal” do të thotë projektim i mallrave, mjedisit, programeve dhe shërbimeve për t’i bërë të përdorshme për të gjithë njerëzit, në masën më të madhe të mundshme, pa pasur nevojë për përshtatje apo projektim të veçantë. Projektimi universal nuk duhet të përjashtojë pajisjet ndihmese për grupe të veçanta të personave me aftësi të kufizuara, kur është e nevojshme.

Neni 3

Parimet e përgjithshme

Parimet e kësaj konvente duhet të jenë:

- a) Respekt për dinjitetin e natyrshëm, autonomi individuale, përfshirë lirinë për të bërë zgjedhjet personale dhe pavarësi e personit;
- b) Mosdiskriminim;
- c) Pjesëmarrje dhe përfshirje e plotë dhe efektive në shoqëri;
- d) Respekt për ndryshimin dhe pranimin e personave me aftësi të kufizuara si pjesë e diversitetit njerëzor dhe humanizmit;
- e) Barazi mundësish;
- f) Heqje barrierash;
- g) Barazi ndërmjet burrave dhe grave;
- h) Respekt për kapacitetet në zhvillim të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe respekt për të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuar për të ruajtur identitetin e tyre.

Neni 4

Detyrime të përgjithshme

1. Shtetet palë marrin përsipër të sigurojnë dhe promovojnë realizimin e plotë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për të gjithë personat me aftësi të kufizuara pa diskriminim të ndonjë lloji me bazë aftësinë e kufizuar. Për këtë qëllim, shtetet palë marrin përsipër:

- a) Të miratojnë të gjitha masat e duhura legjislative dhe administrative, si dhe masa të tjera për zbatimin e të drejtave të njohura nga kjo konventë;
- b) Të marrin të gjitha masat e duhura, përfshirë legjislacionin, për të modifikuar apo zhvlerësuar ligjet, rregulloret, zakonet dhe praktikën ekzistuese që përbëjnë diskriminim ndaj personave me aftësi të kufizuara;
- c) Të marrin parasysh mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut për personat me aftësi të kufizuara në të gjitha politikën dhe programet;
- d) Të mos marrin pjesë në veprime apo praktika që nuk janë në përputhje me këtë konventë dhe të sigurojnë që autoritetet dhe institucionet publike të veprojnë në përputhje me këtë konventë;
- e) Të marrin të gjitha masat e duhura për të eliminuar diskriminimin me bazë aftësinë e kufizuar nga personat, organizatat apo ndërmarrjet private;
- f) Të ndërmarrin apo të promovojnë punën kërkimore dhe zhvillimin e mallrave, shërbimeve, pajisjeve dhe lehtësive të projektuara në mënyrë universale, siç përcaktohen në nenin 2 të kësaj konvente, të cilat duhet të kërkojnë adaptimin më minimal të mundshëm dhe koston më të ulët për të plotësuar nevojat specifike të personave me aftësi të kufizuara, për të promovuar gjendjen dhe përdorimin e tyre, dhe për të promovuar projektim universal në zhvillimin e standardeve dhe udhëzimeve;
- g) Të ndërmarrin apo të promovojnë punën kërkimore dhe zhvillimin, si dhe të promovojnë gjetjen dhe përdorimin e teknologjive të reja, përfshirë teknologjitë e informacionit dhe komunikimit, mjeteve ndihmëse lëvizëse, pajisjeve, teknologjive ndihmëse, të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara, duke u dhënë prioritet teknologjive me kosto të përballueshme;
- h) Të sigurojnë mundësimin e informacionit për personat me aftësi të kufizuara lidhur me mjetet ndihmëse lëvizëse, pajisjet, dhe teknologjitë ndihmëse, përfshirë teknologjitë e reja, si dhe forma të tjera ndihmëse, shërbimesh dhe lehtësirash mbështetëse.

i) Të përmirësojnë trajnimin e profesionistëve dhe personelit që punon me personat me aftësi të kufizuara lidhur me të drejtat që njeh kjo konventë, me qëllim që ndihma dhe shërbimet e garantuara nga këto të drejta të sigurohen më mirë.

2. Lidhur me të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore, çdo shtet palë merr përsipër të ndërmarrë të gjitha masat në masën maksimale të burimeve ekzistuese dhe, kur është e nevojshme, në kuadrin e bashkëpunimit ndërkombëtar, me synimin për të arritur në mënyrë progresive realizimin e plotë të këtyre të drejtave, pa cenuar ato detyrime të paraqitura në këtë konventë, të cilat sipas të drejtës ndërkombëtare janë drejtpërdrejt të zbatueshme.

3. Në zhvillimin dhe zbatimin e legjislacionit për zbatimin e kësaj konvente, si dhe për proceset e tjera vendimmarrëse në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me personat me aftësi të kufizuara, shtetet palë duhet të konsultojnë dhe të përfshijnë aktivisht personat me aftësi të kufizuara, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara nëpërmjet organizatave të tyre përfaqësuese.

4. Asgjë nga kjo konventë nuk duhet të prekë ato dispozita që janë më të favorshme për realizimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara dhe që mund të përmbahen në ligjin e shtetit palë apo të drejtën ndërkombëtare në fuqi për atë shtet. Nuk duhet të ketë asnjë kufizim apo cenim të asnjë prej të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të njohura apo ekzistuese në cilindo shtet palë në këtë konventë në përputhje me ligjin, konventat, rregulloret apo zakonet me pretekstin se kjo konventë nuk i njeh këto të drejta apo liri apo se ajo i njeh ato në një masë më të vogël.

5. Dispozitat e kësaj konvente zbatohen në të gjitha pjesët e shteteve federale pa asnjë kufizim apo përjashtim.

Neni 5

Barazia dhe mosdiskriminimi

1. Shtetet palë pranojnë se të gjithë personat janë të barabartë para ligjit dhe sipas ligjit dhe se kanë të drejtë pa asnjë diskriminim për mbrojtje të barabartë dhe përfitim të barabartë nga ligji.

2. Shtetet palë duhet të ndalojnë çdo lloj diskriminimi me bazë aftësinë e kufizuar dhe t'u garantojnë personave me aftësi të kufizuara mbrojtje ligjore të barabartë dhe efektive ndaj çdo lloj diskriminimi në të gjitha situatat.

3. Me qëllim që të promovohet barazia dhe të eliminohet diskriminimi, shtetet palë duhet të ndërmarrin të gjithë hapat e duhur për të siguruar që është arritur akomodimi i arsyeshëm.

4. Masat specifike të cilat janë të nevojshme për të përshpejtuar apo arritur *de facto* barazinë e personave me aftësi të kufizuara nuk duhet të konsiderohen diskriminim sipas termave të kësaj konvente.

Neni 6

Gratë me aftësi të kufizuara

1. Shtetet palë pranojnë se gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara i nënshtrohen një diskriminimi shumëformësh, dhe për këtë do të marrin masa për të siguruar se ato gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

2. Shtetet palë duhet të marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar zhvillimin, përparimin dhe fuqizimin e plotë të grave, me qëllim që t'u garantohet atyre ushtrimi dhe gëzimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të përcaktuara në këtë konventë.

Neni 7

Fëmijët me aftësi të kufizuara

1. Shtetet palë duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që fëmijët me aftësi të kufizuara të gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut në bazë të barabartë me fëmijët e tjerë.

2. Në të gjitha veprimet lidhur me fëmijët me aftësi të kufizuara, interesit të lartë të fëmijëve duhet t'i kushtohet rëndësi parësore.

3. Shtetet palë duhet të sigurojnë se fëmijët me aftësi të kufizuara kanë të drejtën për të shprehur pikëpamjet e tyre lirisht në të gjitha çështjet që prekin ata, pikëpamjeve të tyre i është dhënë vlerësimi i duhur në përputhje me moshën dhe maturinë e tyre, në baza të barabarta me fëmijët e tjerë, dhe për t'u pajisur me asistencën e duhur sipas moshës dhe aftësisë së kufizuar për të realizuar këtë të drejtë.

Neni 8

Rritja e ndërgjegjësimit

1. Shtetet palë marrin përsipër të miratojnë masat e duhura, efektive dhe të menjëhershme:

a) Për të rritur ndërgjegjësimin e shoqërisë, përfshirë familjen, lidhur me personat me aftësi të kufizuara, dhe për të ushqyer respekt ndaj të drejtave dhe dinjitetit të personave me aftësi të kufizuara;

b) Për të luftuar stereotipat, paragjykimet dhe praktikat e dëmshme lidhur me personat me aftësi të kufizuara, përfshirë dhe ato me bazë seksin dhe moshën në të gjitha fushat e jetës;

c) Për të promovuar rritjen e ndërgjegjësimit lidhur me aftësitë dhe kontributet e personave me aftësi të kufizuara.

2. Masat për këtë qëllim përfshijnë:

a) Ndërmarrjen e nismave dhe mbarëvajtjen e fushatave efektive për ndërgjegjësimin e publikut të synuara:

i) të ushqejnë të kuptuarit e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara;

ii) të përmirësojnë perceptimin pozitiv dhe një ndërgjegjësim më të madh shoqëror ndaj personave me aftësi të kufizuara;

iii) të promovojnë njohjen e aftësive, meritave, mundësive të personave me aftësi të kufizuara dhe kontributeve të tyre në ambientin (vendin) e punës dhe tregun e punës;

b) Të ushqejnë një mentalitet respekti për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha nivelet e sistemit të edukimit, përfshirë të gjithë fëmijët që nga mosha e hershme;

c) Inkurajimin e të gjitha organeve të medias për të portretizuar personat me aftësi të kufizuara, në mënyrë të tillë që të jetë në pajtim me këtë konventë;

d) Promovimin e programeve trajnuese ndërgjegjësuere lidhur me personat me aftësi të kufizuara dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

Neni 9

Heqja e barrierave

1. Me qëllim që të bëhet e mundur që të gjithë personat me aftësi të kufizuara të jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës, shtetet palë duhet të marrin masat e duhura për të siguruar mundësimin për personat me aftësi të kufizuara, në baza të barabarta me të tjerët, në ambientet fizike, transport, informacion dhe komunikim, përfshirë dhe teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit, si dhe në mjete apo shërbime të tjera të hapura apo të siguruar për publikun, si në zonat urbane dhe ato rurale. Këto masa, të cilat duhet të përfshijnë identifikimin dhe eliminimin e pengesave dhe barrierave për mundësimin, zbatohen ndër të tjera për:

a) ndërtesa, rrugë, transport dhe mjete të tjera në ambiente të brendshme apo të jashtme, përfshirë shkollat, strehimin, shërbime mjekësore apo vendet e punës;

b) informacion, komunikim dhe shërbime të tjera, përfshirë shërbimet elektronike dhe shërbimet e emergjencës.

2. Shtetet palë duhet gjithashtu të marrin masat e duhura:

- a) për të zhvilluar, shpallur dhe monitoruar implementimin e udhëzimeve dhe standardeve minimale për mundësimin e mjeteve dhe shërbimeve të hapura apo të siguruara për publikun;
- b) për të siguruar se subjektet private që ofrojnë mjete dhe shërbime, të cilat janë të hapura apo të siguruara për publikun, të marrin parasysh të gjitha aspektet e mundësimit për personat me aftësi të kufizuara;
- c) për të siguruar trajnim për pjesëmarrësit në proces lidhur me çështjet e heqjes së barrierave që ndeshin personat me aftësi të kufizuara;
- d) për të siguruar në ndërtesat dhe mjete të tjera të hapura për publikun, shenja në *Braille* dhe në një formë lehtësisht të lexueshme dhe të kuptueshme;
- e) për të siguruar forma asistence të drejtpërdrejta dhe të ndërmjetme, përfshirë udhëzues, lexues dhe përkthyes profesionalë të gjuhës së shenjave, për të lehtësuar hyrjen në ndërtesa dhe mjete të tjera të hapura për publikun;
- f) për të promovuar forma të tjera të përshtatshme asistence dhe mbështetjeje për personat me aftësi të kufizuara për të siguruar që atyre t'u mundësohet informacioni;
- g) për të promovuar mundësimin e informacionit të ri dhe sistemet e teknologjitë e reja të komunikimit për personat me aftësi të kufizuara, përfshirë dhe internetin;
- h) për të promovuar projektimin, zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e sistemeve të informacionit të mundësueshëm dhe teknologjisë së komunikimit në një fazë të hershme, në mënyrë që këto teknologji dhe sisteme të bëhen të mundshme me një kosto minimale.

Neni 10

E drejta për të jetuar

Shtetet palë ripohojnë se çdo qenie njerëzore ka të drejtën e lindur për jetën dhe se duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që personat me aftësi të kufizuara e gëzojnë këtë të drejtë në mënyrë efektive në baza të barabarta me të tjerët.

Neni 11

Situatat e rrezikut dhe emergjencat humanitare

Shtetet palë, në përputhje me detyrimet e tyre sipas së drejtës ndërkombëtare, përfshirë të drejtën ndërkombëtare humanitare dhe të drejtën ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut, do të marrin të gjitha masat për të siguruar mbrojtjen dhe sigurinë e personave me aftësi të kufizuara në situata rreziku, përfshirë situatat e konfliktit të armatosur, emergjencat humanitare dhe fatkeqësitë natyrore.

Neni 12

Njohja e barabartë para ligjit

1. Shtetet palë riafirmojnë se personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtën e njohjes kudo si persona para ligjit.

2. Shtetet palë do të pranojnë se personat me aftësi të kufizuara gëzojnë zotësi ligjore në bazë të barabartë me të tjerët në të gjitha aspektet e jetës.

3. Shtetet palë do të marrin masat e duhura për të siguruar mundësimin ndaj personave me aftësi të kufizuara për mbështetjen që ata mund të kërkojnë në ushtrimin e kapacitetit të tyre ligjor.

4. Shtetet palë do të sigurojnë se të gjitha masat që lidhen me ushtrimin e zotësisë ligjore sigurojnë masat mbrojtëse të duhura dhe efektive për të parandaluar abuzimin në përputhje me të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Masa të tilla mbrojtëse do të sigurojnë se masat e lidhura me ushtrimin e zotësisë ligjore respektojnë të drejtat, vullnetin dhe preferencat e personit, nuk kanë konflikt interesi dhe ndikim të panevojshëm, janë në proporcion dhe të përshtatura

sipas rrethanave të personit, aplikohen për periudhën më të shkurtër të mundshme dhe u nënshtrohen rishikimeve të rregullta të një autoriteti kompetent, të pavarur dhe të paanshëm apo një organi gjyqësor. Masat mbrojtëse do të jenë proporcionale, në shkallën ku masa të tilla prekin të drejtat dhe interesat e personit.

5. Në bazë të dispozitave të këtij neni, shtetet palë do të marrin të gjitha masat e duhura dhe efektive për të siguruar të drejtën e barabartë të personave me aftësi të kufizuara për të pasur në pronësi apo për të trashëguar prona, për të kontrolluar çështjet e tyre financiare dhe për të pasur mundësi të barabartë në kredi bankare, hipoteka dhe forma të tjera të kredive financiare, dhe do të sigurojë se personave me aftësi të kufizuara nuk u hiqet prona në mënyrë arbitrare.

Neni 13

Mundësimi i drejtësisë

1. Shtetet palë duhet të sigurojnë akses efektiv në drejtësi për personat me aftësi të kufizuara në baza të barabarta me të tjerët, përfshirë nëpërmjet sigurimit të mundësive të përshtatshme procedurale dhe të moshës, me qëllim që të lehtësohet roli i tyre efektiv si pjesëmarrës direkt dhe jodirekt, përfshirë dhe si dëshmitarë, në të gjitha gjykimet, përfshirë hetimet dhe stadi të tjera paraprake.

2. Me qëllim që të jepet ndihmesë në sigurimin e mundësimit efektiv në drejtësi për personat me aftësi të kufizuara, shtetet palë duhet të promovojnë trajnime për ata persona që punojnë në fushën e administrimit të drejtësisë, përfshirë policinë dhe personelin e burgut.

Neni 14

Liria dhe siguria e personit

1. Shtetet palë duhet të sigurojnë se personat me aftësi të kufizuara, në baza të barabarta me të tjerët:

- a) gëzojnë të drejtën për lirinë dhe sigurinë e personit;
- b) nuk u hiqet liria në mënyrë të paligjshme dhe arbitrare, dhe se çdo heqje lirie është në përputhje me ligjin, dhe se ekzistenca e aftësisë së kufizuar nuk duhet në asnjë rast të justifikojë heqjen e lirisë.

2. Shtetet palë duhet të sigurojnë se nëse personave me aftësi të kufizuara u është hequr liria nëpërmjet çfarëdo lloj procesi, mbi baza të barabarta me të tjerët, ata kanë të drejtë për garanci në përputhje me të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe duhet të trajtohen në përputhje me objektivat dhe parimet e kësaj konvente, përfshirë sigurimin e akomodimit të arsyeshëm.

Neni 15

Lirimi nga tortura, trajtimi i egër, çnjerëzor apo degradues

1. Askush nuk duhet t'i nënshtrohet torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor apo degradues. Në veçanti, askush nuk duhet t'i nënshtrohet eksperimentimit mjekësor apo shkencor pa pëlqimin e saj/tij të lirë.

2. Shtetet palë duhet të marrin të gjitha masat efektive legjislative, administrative, gjyqësore apo masa të tjera për të parandaluar që personat me aftësi të kufizuara, në bazë të barabartë me të tjerët, t'u nënshtrohen torturës apo trajtimit apo dënimit të egër, çnjerëzor apo degradues.

Neni 16

Lirimi nga shfrytëzimi, dhuna dhe abuzimi

1. Shtetet palë duhet të marrin masat e duhura legjislative, administrative, shoqërore, arsimore dhe masa të tjera për të mbrojtur personat me aftësi të kufizuara, si brenda familjes dhe jashtë saj, nga të gjitha format e shfrytëzimit, dhunës dhe abuzimit, përfshirë aspektet me bazë gjinore.

2. Shtetet palë duhet të marrin gjithashtu të gjitha masat e duhura për të parandaluar të gjitha format e shfrytëzimit, dhunës dhe abuzimit, duke siguruar, ndër të tjera, format e duhura të asistencës në bazë të gjinisë dhe moshës dhe mbështetje për personat me aftësi të kufizuara, familjeve të tyre dhe punonjësve të kujdesit, përfshirë nëpërmjet sigurimit të informacionit dhe edukimit se si të shmangen, njihen apo raportohen rastet e shfrytëzimit, dhunës apo abuzimit. Shtetet palë duhet të sigurojnë se shërbimet e mbrojtjes tregojnë ndjeshmëri ndaj moshës, gjinisë dhe aftësisë së kufizuar.

3. Me qëllim që të parandalohen të gjitha format e shfrytëzimit, dhunës dhe abuzimit, shtetet palë duhet të sigurojnë që të gjitha mjetet dhe programet e projektuara për t'u shërbyer personave me aftësi të kufizuara të monitorohen në mënyrë efektive nga autoritete të pavarura.

4. Shtetet palë duhet të marrin të gjitha masat e duhura për të promovuar shërimin dhe rehabilitimin fizik, njohës dhe psikologjik dhe riintegrimin shoqëror të personave me aftësi të kufizuara, të cilët janë viktimë të çdo lloji forme shfrytëzimi, dhune apo abuzimi, përfshirë nëpërmjet sigurimit të shërbimeve mbrojtëse. Një shërim dhe riintegrim i tillë duhet të ndodhë në një ambient që mbështet shëndetin, mirëqenien, vetërespektin, dinjitetin dhe autonominë e personit dhe merr parasysh nevojat specifike gjinore dhe të moshës.

5. Shtetet palë duhet të sigurojnë legjislacionin dhe politika efektive, përfshirë legjislacionin dhe politikat në lidhje me gratë dhe fëmijët, për të siguruar se janë identifikuar, hetuar dhe kur duhet, janë ndjekur ligjërisht rastet e shfrytëzimit, dhunës dhe abuzimit ndaj personave me aftësi të kufizuara.

Neni 17

Mbrojtja e integritetit të personit

Çdo person me aftësi të kufizuar ka të drejtën për respekt ndaj integritetit të saj apo të tij fizik dhe mendor në bazë të barabartë me të tjerët.

Neni 18

Liria e lëvizjes dhe shtetësia

1. Shtetet palë duhet të njohin të drejtat e personave me aftësi të kufizuara për lirinë e lëvizjes, lirinë për të zgjedhur rezidencën dhe shtetësinë e tyre, në baza të barabarta me të tjerët, përfshirë dhe sigurimin e faktit se personat me aftësi të kufizuara:

a) kanë të drejtë të marrin dhe ndryshojnë shtetësinë dhe nuk u hiqet shtetësia në mënyrë arbitrare apo në bazë të aftësisë së kufizuar;

b) nuk iu hiqet mundësia, në bazë të aftësisë së kufizuar, për të marrë, pasur dhe përdorur dokumentacionin e shtetësisë së tyre apo dokumentacion tjetër identifikues, apo për të përdorur proceset përkatëse, të tilla si procedurat e imigrimit, që mund të nevojiten për të lehtësuar ushtrimin e të drejtës për lirinë e lëvizjes;

c) janë të lirë të largohen nga çdo vend/shtet, përfshirë dhe vendin/shtetin e tyre;

d) nuk iu hiqet e drejta, në mënyrë arbitrare apo në bazë të aftësisë së kufizuar, për të hyrë në vendin/shtetin e tyre.

2. Fëmijët me aftësi të kufizuara duhet të regjistrohen menjëherë pas lindjes dhe që nga lindja duhet të kenë të drejtën për një emër, të drejtën për të marrë një shtetësi dhe, sa më shpejt të jetë e mundur, të drejtën për të njohur dhe për të pasur kujdesin e prindërve.

Neni 19

Jetesa e pavarur dhe përfshirja në komunitet

Shtetet palë në këtë konventë pranojnë të drejtën e barabartë të të gjithë personave me aftësi të kufizuara për të jetuar në komunitet, me zgjedhje të barabarta me të tjerët, dhe duhet të marrin

masat e duhura dhe efektive për të mundësuar që personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë plotësisht këtë të drejtë dhe përfshirjen e pjesëmarrjen e tyre të plotë në komunitet, përfshirë dhe sigurimin e faktit se:

a) Personat me aftësi të kufizuara kanë mundësinë për të zgjedhur vendin e tyre të banimit, ku dhe me kë do të jetojnë në baza të barabarta me të tjerët dhe nuk janë të detyruar të jetojnë në një mënyrë të veçantë të caktuar jetese;

b) Personat me aftësi të kufizuara kanë mundësi për një gamë të gjerë shërbimesh mbështetëse në shtëpi, shërbime rezidenciale dhe shërbime në komunitet, dhe për parandalimin e izolimit dhe veçimit nga komuniteti;

c) Shërbimet dhe mjetet komunitare për popullatën në përgjithësi janë të disponueshme në baza të barabarta për personat me aftësi të kufizuara dhe u përgjigjen nevojave të tyre.

Neni 20

Lëvizshmëria personale

Shtetet palë duhet të marrin masat efektive për të siguruar lëvizshmërinë personale me pavarësinë më të madhe të mundshme për personat me aftësi të kufizuara, si më poshtë:

a) Lehtësimin e lëvizshmërisë personale të personave me aftësi të kufizuara sipas mënyrës dhe kohës së zgjedhur prej tyre, dhe me kosto të përballueshme;

b) Lehtësimin e mundësitë për personat me aftësi të kufizuara në mjetet lëvizëse, pajisjet, teknologjitë ndihmëse dhe format e asistencës direkte dhe të ndërmjetme, përfshirë sigurimin e tyre me kosto të përballueshme;

c) Sigurimin e trajnimit lidhur me aftësitë lëvizëse të personave me aftësi të kufizuara dhe stafit të specializuar që punon me personat me aftësi të kufizuara;

d) Inkurajimin e subjekteve që prodhojnë mjete lëvizëse, pajisje dhe teknologji ndihmëse të marrin parasysh të gjitha aspektet e lëvizjes së personave me aftësi të kufizuara.

Neni 21

Liria e të shprehurit dhe mendimit, dhe mundësimi i informacionit

Shtetet palë duhet të marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar se personat me aftësi të kufizuara mund të ushtrojnë të drejtën e tyre të të shprehurit dhe mendimit, përfshirë lirinë për të kërkuar, marrë dhe përhapur informacionin dhe idetë në baza të barabarta me të tjerët dhe nëpërmjet të gjitha formave të komunikimit sipas zgjedhjes së tyre, siç përcaktohen në nenin 2 të kësaj konvente, si më poshtë:

a) Sigurimin e informacionit të synuar për publikun e gjerë ndaj personave me aftësi të kufizuara në formate dhe teknologji të realizueshme e të përshtatshme për lloje të ndryshme të aftësisë së kufizuar në kohën e duhur dhe pa kosto shtesë;

b) Pranimin dhe lehtësimin e përdorimit të gjuhës së shenjave, *Braille*, komunikimit shtesë dhe alternativ, dhe e të gjitha mjeteve, mënyrave dhe formave të tjera të komunikimit të realizueshme sipas zgjedhjes së personave me aftësi të kufizuara në ndërveprimet zyrtare;

c) Nxitjen e subjekteve private që sigurojnë shërbime për publikun e gjerë, përfshirë dhe internetin, që të sigurojnë informacion dhe shërbime në formate të realizueshme dhe të përdorshme për personat me aftësi të kufizuara;

d) Inkurajimin e masmedias, përfshirë dhe sigurimin e informacionit nëpërmjet internetit, për t'i bërë shërbimet e tyre të mundshme për personat me aftësi të kufizuara;

e) Njohjen dhe promovimin e përdorimit të gjuhës së shenjave.

Neni 22

Respektimi i jetës private

1. Asnjë person me aftësi të kufizuar, pavarësisht nga vendqëndrimi apo mënyra e jetesës, nuk duhet t'u nënshtrohet ndërhyrjeve arbitrare apo të paligjshme në jetën private të tij apo të saj, në familjen, korrespondencën, llojet e tjera të komunikimit apo t'u nënshtrohet sulmeve të paligjshme ndaj nderit apo reputacionit të tij/saj. Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtën të mbrohen nga ligji ndaj këtyre ndërhyrjeve dhe sulmeve.

2. Shtetet palë mbrojnë fshehtësinë e informacionit personal për shëndetin dhe rehabilitimin e personave me aftësi të kufizuara në baza të barabarta me të tjerët.

Neni 23

Respektimi i shtëpisë dhe familjes

1. Shtetet palë duhet të marrin masat e duhura dhe efektive për të eliminuar diskriminimin ndaj personave me aftësi të kufizuara në të gjitha çështjet lidhur me martesën, familjen, prindërimin dhe raportet njerëzore, në bazë të barabartë me të tjerët, për të siguruar se:

a) njihet e drejta e të gjithë personave me aftësi të kufizuara, të cilët janë në një moshë për martesë, për t'u martuar dhe për të krijuar një familje bazuar në pëlqimin e lirë dhe të plotë të çiftit;

b) njihen të drejtat e personave me aftësi të kufizuara për të vendosur lirshëm dhe me përgjegjësi për numrin dhe hapësirën e fëmijëve të tyre dhe të kenë mundësi informacioni sipas moshës, edukim mbi planifikimin familjar dhe riprodhimin, si dhe sigurohen mjetet e nevojshme që i mundësojnë ata të ushtrojnë këto të drejta.

c) personat me aftësi të kufizuara, përfshirë fëmijët, ruajnë aftësinë riprodhuese e tyre në bazë të barabartë me të tjerët.

2. Shtetet palë sigurojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e personave me aftësi të kufizuara lidhur me kujdestarinë, ruajtjen dhe birësimin e fëmijëve apo institucione të ngjashme ku këto koncepte ekzistojnë në legjislacionin kombëtar; në të gjitha rastet interesi i lartë i fëmijës do të jetë dominues. Shtetet palë duhet të japin asistencën e duhur ndaj personave me aftësi të kufizuara në përmbushjen e përgjegjësiave për rritjen e fëmijëve të tyre.

3. Shtetet palë duhet të sigurojnë se fëmijët me aftësi të kufizuara kanë të drejta të barabarta lidhur me jetën në familje. Me qëllim realizimin e këtyre të drejtave dhe parandalimin e fshehjes, të braktisjes, neglizhimit dhe izolimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara, shtetet palë duhet të marrin përsipër të sigurojnë informacion, shërbime dhe mbështetje të hershme dhe të gjithanshme për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre.

4. Shtetet palë duhet të sigurojnë se fëmija nuk duhet të ndahet nga prindërit e tij apo të saj kundër dëshirës së tyre, përveç rasteve kur autoritetet kompetente sipas rishikimit gjyqësor përcaktojnë, në përputhje me ligjet dhe procedurat e zbatueshme, që një ndarje e tillë është e domosdoshme për interesin më të mirë të fëmijës. Në asnjë mënyrë nuk duhet ndarë një fëmijë nga prindërit bazuar në aftësinë e kufizuar të fëmijës apo në aftësinë e kufizuar të njërit apo të dy prindërve.

5. Shtetet palë, në rastet kur rrethi më i afërt familjar nuk është në gjendje të kujdeset për fëmijën me aftësi të kufizuar, do të ndërmarrë çdo përpjekje për të siguruar kujdes alternativ brenda familjes së zgjeruar, dhe në rast se dështon, brenda komunitetit në një ambient familjeje.

Neni 24

Edukimi

1. Shtetet palë njohin të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për edukim. Me qëllim që të realizohet kjo e drejtë pa diskriminim dhe në bazë të mundësive të barabarta, shtetet palë duhet të

sigurojnë një sistem edukimi përfshirës në të gjitha nivelet, dhe të mësuar gjatë gjithë jetës, të drejtuar nga:

a) zhvillimi i plotë i potencialit njerëzor dhe sensit të dinjitetit dhe vlerës së vetvetes, fuqizimit të respektit për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, dhe diversitetit njerëzor;

b) zhvillimi nga personat me aftësi të kufizuara të personalitetit, talenteve dhe krijimtarisë së tyre, si dhe aftësive të tyre mendore dhe fizike, në potencialin e tyre të plotë;

c) mundësimin e personave me aftësi të kufizuara për të marrë pjesë në mënyrë efektive në një shoqëri të lirë.

2. Për të realizuar këtë të drejtë, shtetet palë duhet të sigurojnë se:

a) personat me aftësi të kufizuara nuk janë përjashtuar nga sistemi i edukimit të përgjithshëm për shkak të aftësisë së kufizuar, dhe se fëmijët me aftësi të kufizuara nuk janë përjashtuar nga arsimi pa pagesë dhe i detyruar fillor, ose arsimi i mesëm, me bazë aftësinë e kufizuar;

b) personat me aftësi të kufizuara mund të kenë mundësinë për edukimin fillor gjithëpërfshirës, cilësor dhe pa pagesë dhe arsimin tetëvjeçar në baza të barabarta me të tjerët në komunitetet ku ata jetojnë;

c) sigurohet akomodimi i arsyeshëm i kërkesave individuale;

d) personat me aftësi të kufizuara marrin mbështetjen e kërkuar brenda sistemit të edukimit të përgjithshëm, për të mundësuar arsimimin e tyre efektiv.

e) sigurohen masa mbështetëse efektive të individualizuara në ambiente që rrisin zhvillimin akademik dhe shoqëror, në pajtim me qëllimin për përfshirje të plotë.

3. Shtetet palë duhet të mundësojnë personat me aftësi të kufizuara të mësojnë mjeshteri për zhvillim shoqëror dhe jetësor për të lehtësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe të barabartë në edukim dhe si anëtarë të komunitetit. Për këtë qëllim shtetet palë duhet të marrin masat e duhura, përfshirë:

a) lehtësimin e të mësuarit të *Braille*, shkrimeve alternative, mënyrave shpesh dhe alternative, mjeteve dhe formateve të komunikimit, aftësive të orientimit dhe lëvizshmërisë, dhe lehtësim të mbështetjes dhe kujdesit nga moshatarët;

b) lehtësimin e të mësuarit të gjuhës së shenjave dhe promovimin e identitetit linguistik të komunitetit të personave që nuk dëgjojnë;

c) sigurimin e faktit se edukimi i personave, dhe në veçanti i fëmijëve të cilët janë të verbër, që nuk dëgjojnë apo që nuk dëgjojnë e nuk shikojnë, në të njëjtën kohë u është dhënë në gjuhën, mënyrat dhe mjetet e komunikimit më të përshtatshme për individin dhe në ambiente të cilat rrisin zhvillimin akademik dhe shoqëror.

4. Me qëllim që të sigurohet realizimi i kësaj të drejte, shtetet palë duhet të marrin masat e duhura për të punësuar mësuesit, përfshirë mësuesit me aftësi të kufizuara, të cilët janë të kualifikuar në gjuhën e shenjave dhe/apo *Braille*, dhe të trajnojnë profesionistët dhe stafin që punon në të gjitha nivelet e edukimit. Trajnime të tilla duhet të përfshijnë ndërgjegjësimin mbi aftësinë e kufizuar dhe përdorimin e mënyrave të duhura shpesh dhe alternative, mjeteve dhe formateve të komunikimit, teknikave edukuese dhe materialeve për të mbështetur personat me aftësi të kufizuara.

5. Shtetet palë duhet të sigurojnë që personat me aftësi të kufizuara të jenë në gjendje të kenë mundësi për arsimin e lartë, trajnime profesionale, edukimin për të rritur dhe të mësuarit gjatë të gjithë jetës pa diskriminim dhe në baza të barabarta me të tjerët. Për këtë qëllim, shtetet palë duhet të sigurojnë që akomodimi i arsyeshëm është siguruar për personat me aftësi të kufizuara.

Neni 25

Shëndeti

Shtetet palë pranojnë se personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtën të gëzojnë standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit pa diskriminim mbi bazë aftësinë e kufizuar. Shtetet palë duhet të marrin masat e duhura për të siguruar mundësimin për personat me aftësi të kufizuara te

shërbimet shëndetësore të lidhura me gjininë, përfshirë rehabilitimin në lidhje me shëndetin. Në veçanti, shtetet palë:

a) do të sigurojnë për personat me aftësi të kufizuara të njëjtën gamë, cilësi dhe standarde të shërbimeve shëndetësore pa pagesë ose të përballueshme, siç u sigurohet personave të tjerë, përfshirë programe të shëndetit publik me bazë popullsinë në fushat e shëndetit riprodhues dhe seksual;

b) do të sigurojnë ato shërbime shëndetësore të nevojshme për personat me aftësi të kufizuara, për shkak të aftësisë së tyre të kufizuar, përfshirë dhe identifikimin e hershëm dhe ndërhyrjen sipas rastit, si dhe shërbime të planifikuara, për të minimizuar dhe parandaluar përkeqësimin e aftësive të kufizuara, përfshirë ato të fëmijët dhe të moshuarit;

c) do të sigurojnë këto shërbime shëndetësore sa më pranë të jetë e mundur komuniteteve të këtyre personave, përfshirë zonat rurale;

d) do të kërkojnë profesionistë të kujdesit shëndetësor për të siguruar kujdes të së njëjtës cilësi për personat me aftësi të kufizuara si për të tjerët, përfshirë dhe faktin se në bazë të pëlqimit të lirë dhe të informuar, ndër të tjera, të rrisë ndërgjegjësimin mbi të drejtat, dinjitetin, autonominë e njeriut dhe nevojave të personave me aftësi të kufizuara nëpërmjet trajnimeve dhe shpalljes së standardeve etike për kujdesin shëndetësor publik dhe privat;

e) do të ndalojnë diskriminimin ndaj personave me aftësi të kufizuara në realizimin e sigurimit shëndetësor dhe sigurimit për jetën, kur një sigurim i tillë lejohet nga ligji kombëtar, i cili duhet të sigurohet në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme;

f) do të parandalojë mohimin diskriminues të kujdesit shëndetësor, shërbimeve shëndetësore apo të ushqimeve dhe pijeve mbi bazën e aftësisë së kufizuar.

Neni 26

Aftësimi dhe rehabilitimi

1. Shtetet palë duhet të marrin masat e duhura dhe efektive, përfshirë dhe mbështetjen e moshatarëve, për të bërë të mundur që personat me aftësi të kufizuara të arrijnë dhe të ruajnë pavarësinë e tyre maksimale, aftësinë e plotë fizike, mendore, shoqërore dhe profesionale, dhe përfshirjen e pjesëmarrjen e plotë në të gjitha aspektet e jetës. Për këtë qëllim, shtetet palë do të organizojnë, fuqizojnë dhe zgjerojnë shërbimet aftësuese dhe rehabilituese gjithëpërfshirëse, veçanërisht në fushat e shërbimeve të shëndetit, punësimit, edukimit dhe shërbimeve shoqërore, në mënyrë të tillë që këto shërbime dhe programe:

a) të fillojnë në fazën më të hershme të mundshme dhe të jenë të bazuara në vlerësimet multidisiplinore të nevojave dhe pikave të forta;

b) të mbështesin pjesëmarrjen dhe përfshirjen në komunitet dhe në të gjitha aspektet e shoqërisë, dhe të jenë me bazë vullnetare, dhe të disponueshme për personat me aftësi të kufizuara sa më pranë komuniteteve të tyre të jetë e mundur, përfshirë zonat rurale.

2. Shtetet palë duhet të promovojnë zhvillimin e trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm për profesionistët dhe stafin që punon në shërbimet aftësuese dhe rehabilituese.

3. Shtetet palë duhet të promovojnë ekzistencën, njohuritë dhe përdorimin e pajisjeve ndihmëse dhe teknologjisë, të projektuar për personat me aftësi të kufizuara, pasi ato lidhen me aftësimin dhe rehabilitimin.

Neni 27

Puna dhe punësimi

1. Shtetet palë njohin të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për të punuar, në baza të barabarta me të tjerët; kjo përfshin të drejtën për të pasur mundësinë për të fituar jetesën, duke bërë punë të zgjedhur lirisht apo të pranuar në tregun e punës dhe ambientin e punës që është i hapur, përfshirës dhe i arritshëm nga personat me aftësi të kufizuara. Shtetet palë duhet të mbrojnë dhe promovojnë realizimin e së drejtës për punë, përfshirë dhe ata që e fitojnë aftësinë e

kufizuar gjatë punësimit, duke marrë hapat e duhur, përfshirë nëpërmjet legjislacionit, ndër të tjera:

a) Për të ndaluar diskriminimin me bazë aftësinë e kufizuar në të gjitha çështjet lidhur me punësimin, përfshirë kushtet e rekrutimit, punësimit, vazhdimësisë së punësimit, përparimit në karrierë dhe ofrimin e kushteve të punës të sigurta dhe të shëndetshme;

b) Për të mbrojtur të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, në baza të barabarta me të tjerët, duke përfshirë mundësi të barabarta dhe pagesë të barabartë për punën me vlerë, siguri dhe kushte pune të shëndetshme të barabarta, përfshirë dhe mbrojtjen nga ngacmimet dhe trajtimin e ankesave;

c) Për të siguruar se personat me aftësi të kufizuara janë në gjendje të ushtrojnë të drejtat e punës dhe të drejtat sindikaliste në baza të barabarta me të tjerët;

d) Për të mundësuar personat me aftësi të kufizuara për të pasur mundësi efektive për programet e përgjithshme udhëzuese teknike dhe profesionale, shërbimet e vendosjes në vendin e punës dhe trajnim të vazhdueshëm profesional;

e) Për të promovuar mundësitë dhe përparimin në karrierë për personat me aftësi të kufizuara në tregun e punës, si dhe asistencë në gjetjen, fitimin, mbajtjen dhe kthimin në punë;

f) Për të promovuar mundësitë për vetëpunësim, aktivitete të lirë privat, zhvillimin e kooperativave dhe për të filluar biznesin e vet;

g) Për të punësuar personat me aftësi të kufizuara në sektorin publik;

h) Për të promovuar punësimin e personave me aftësi të kufizuara në sektorin privat nëpërmjet politikave dhe masave të duhura, të cilat mund të përfshijnë programe veprimi afirmative, nxitëse dhe masa të tjera;

i) Për të siguruar se akomodimi i arsyeshëm u është siguruar personave me aftësi të kufizuara në vendin e punës;

j) Për të promovuar fitimin e përvojës së punës nga personat me aftësi të kufizuara në tregun e hapur të punës;

k) Për të promovuar programe për rehabilitim profesional, mbajtjen e vendit të punës dhe kthimit në punë për personat me aftësi të kufizuara.

2. Shtetet palë duhet të sigurojnë se personat me aftësi të kufizuara nuk mbahen në skllavëri apo si shërbëtorë dhe janë të mbrojtur, në baza të barabarta me të tjerët, nga puna e detyruar.

Neni 28

Standardi i përshtatshëm i jetesës dhe mbrojtja shoqërore

1. Shtetet palë njohin të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për një standard të përshtatshëm jetese për ta dhe për familjet e tyre, përfshirë ushqimin, veshjen dhe strehimin e përshtatshëm dhe përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të jetesës dhe duhet të ndërmarrin hapat e duhur për të mbrojtur dhe përmirësuar realizimin e kësaj të drejte pa diskriminim me bazë aftësinë e kufizuar.

2. Shtetet palë njohin të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për mbrojtje shoqërore, dhe që ata ta gëzojnë atë të drejtë pa diskriminim me bazë aftësinë e kufizuar dhe duhet të marrin hapat e duhur për të mbrojtur dhe përmirësuar realizimin e kësaj të drejte, përfshirë masat:

a) Për t'u siguruar mundësim të barabartë personave me aftësi të kufizuara ndaj shërbimeve për ujë të pastër dhe për të siguruar mundësimin e shërbimeve, pajisjeve dhe formave të tjera të asistencës të përshtatshme dhe të përballueshme për nevoja të lidhura me aftësinë e kufizuar;

b) Për të siguruar mundësi për personat me aftësi të kufizuara në veçanti gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara dhe personat më të moshuar me aftësi të kufizuara, në programet e mbrojtjes shoqërore dhe programeve të reduktimit të varfërisë;

c) Për të siguruar mundësi për personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre që jetojnë në kushtet e varfërisë, në asistencën e ofruar nga shteti me shpenzime lidhur me aftësinë e kufizuar, përfshirë trajnimin, këshillimin, ndihmën financiare dhe kujdesin gjatë pushimeve;

- d) Për të siguruar mundësi për personat me aftësi të kufizuara në programet e strehimit publik;
- e) Për të siguruar mundësi të barabartë për personat me aftësi të kufizuara nga programet dhe përfitimet e pensionit.

Neni 29

Pjesëmarrja në jetën politike dhe publike

Shtetet palë duhet t'u garantojnë personave me aftësi të kufizuara të drejtat politike dhe mundësinë për t'i gëzuar ato në baza të barabarta me të tjerët dhe duhet të marrin përsipër:

a) Të sigurojnë se personat me aftësi të kufizuara mund të marrin pjesë në mënyrë të plotë dhe efektive në jetën politike dhe publike mbi bazë të barabartë me të tjerët, drejtpërsëdrejti apo nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, përfshirë dhe të drejtën dhe mundësinë për personat me aftësi të kufizuara për të votuar dhe për t'u zgjedhur, ndër të tjera duke:

i) siguruar që procedurat, mjetet dhe materialet e votimit të jenë të përshtatshme, të mundshme dhe të thjeshta për t'u kuptuar dhe përdorur;

ii) mbrojtur të drejtën e personave me aftësi të kufizuara të votojnë me votë të fshehtë në zgjedhje dhe referendume publike, pa kërcënim, të kandidojnë për zgjedhje, të punojnë në zyrë në mënyrë efektive dhe të kryejnë të gjitha funksionet publike në të gjitha nivelet e qeverisë, duke lehtësuar përdorimin e teknologjive ndihmëse dhe të reja, kur të jetë e përshtatshme;

iii) garantuar shprehjen e lirë të vullnetit të lirë të personave me aftësi të kufizuara si zgjedhës dhe për këtë qëllim, kur është e nevojshme, me kërkesën e tyre, lejohet asistenca në votim nga një person që zgjidhet prej tyre,

b) Promovimin në mënyrë aktive një ambient në të cilin personat me aftësi të kufizuara mund të marrin pjesë në mënyrë efektive dhe të plotë në kryerjen e punëve publike, pa diskriminim dhe në një bazë të barabartë me të tjerët dhe të inkurajojë pjesëmarrjen e tyre në punët publike, përfshirë:

i) pjesëmarrjen në organizatat joqeveritare dhe shoqatat që kanë të bëjnë me jetën publike dhe politike në vend dhe në aktivitetet dhe administrimin e partive politike;

ii) krijimin apo pjesëmarrjen në organizata për personat me aftësi të kufizuara për të përfaqësuar personat me aftësi të kufizuara në nivele ndërkombëtare, kombëtare, rajonale dhe lokale.

Neni 30

Pjesëmarrja në jetën kulturore, argëtim, kohën e lirë dhe sport

1. Shtetet palë njohin të drejtën e personave me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në bazë të barabartë me të tjerët në jetën kulturore dhe duhet të marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar se personat me aftësi të kufizuara:

a) gëzojnë mundësimin për materialet kulturore në të gjitha formatet e realizueshme;

b) gëzojnë mundësimin për programet televizive, filmat, teatrot dhe aktivitete të tjera kulturore, në formate të realizueshme;

c) gëzojnë mundësimin në vendet për punë apo shërbime kulturore, të tilla si: teatrot, muzetë, kinematë, bibliotekat dhe shërbimet për turistët dhe aq sa është e mundur, gëzojnë mundësi hyrjeje për në monumentet dhe sheshet me rëndësi për kulturën kombëtare.

2. Shtetet palë duhet të marrin masat e duhura për të bërë të mundur që personat me aftësi të kufizuara të kenë mundësinë për të zhvilluar dhe përdorur potencialin e tyre krijues, artistik dhe intelektual, jo vetëm për të mirën e tyre, por edhe për pasurimin e shoqërisë.

3. Shtetet palë duhet të marrin hapat e duhur në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, për të siguruar se ligjet që mbrojnë të drejtat e pronësisë intelektuale nuk përbëjnë një barrierë të paarsyeshme apo diskriminuese që personat me aftësi të kufizuara të kenë mundësinë e materialeve kulturore.

4. Personat me aftësi të kufizuara duhet të kenë të drejtën, në baza të barabarta me të tjerët, që t'u njihet dhe të mbështetet identiteti i tyre specifik kulturor dhe linguistik, përfshirë dhe gjuhën e shenjave dhe kulturën e të shurdhërve.

5. Me idenë për të mundësuar që personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në baza të barabarta me të tjerët në aktivitete, argëtuese, të kohës së lirë dhe sportive, shtetet palë duhet të marrin masat e duhura:

a) Për të inkurajuar dhe promovuar pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në aktivitetet sportive gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet, në masën më të madhe të mundshme;

b) Për të siguruar se personat me aftësi të kufizuara kanë mundësinë të organizojnë, zhvillojnë dhe marrin pjesë në aktivitete sportive specifike për aftësinë e kufizuar dhe argëtuese dhe për këtë qëllim, të inkurajojë sigurimin e udhëzimeve, trajnimit dhe burimeve të duhura, në baza të barabarta me të tjerët; c) Për të siguruar se personat me aftësi të kufizuara kanë mundësi hyrjeje në vendet sportive, argëtuese dhe turistike;

d) Për të siguruar se fëmijët me aftësi të kufizuara kanë mundësi të barabartë për të marrë pjesë në lojë, argëtim, aktivitete sportive dhe të kohës së lirë, përfshirë dhe ato aktivitete që zhvillohen në sistemin shkollor;

e) Për të siguruar se personat me aftësi të kufizuara kanë mundësi në shërbimet nga ato që përfshihen në organizimin e aktiviteteve argëtuese, turistike, sportive dhe të kohës së lirë.

Neni 31

Statistikat dhe mbledhja e të dhënave

1. Shtetet palë marrin përsipër të mbledhin informacionin e duhur, përfshirë të dhëna statistikore dhe kërkimore, për të mundur që këto shtete të formulojnë dhe zbatojnë politika që do i japin fuqi kësaj konvente. Procesi i mbledhjes dhe i mbajtjes së këtij informacioni:

a) duhet të jetë në përputhje me masat mbrojtëse ligjore, përfshirë legjislacionin mbi mbrojtjen e të dhënave, për të siguruar fshehtësinë dhe respektimin e jetës private të personit me aftësi të kufizuar;

b) duhet të jetë në përputhje me normat ndërkombëtare të pranuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, si dhe parimet etike në mbledhjen dhe përdorimin e statistikave.

2. Informacioni i mbledhur në përputhje me këtë nen mund të shpërndahet sipas rastit dhe përdoret për të ndihmuar për të vlerësuar zbatimin e detyrimeve të shteteve palë në këtë konventë, dhe të identifikojë dhe adresojë barrierat që ndeshen nga personat me aftësi të kufizuara gjatë ushtrimit të të drejtave të tyre.

3. Shtetet palë marrin përgjegjësinë për përhapjen e këtyre statistikave dhe sigurojnë që ato të jenë të mundshme për personat me aftësi të kufizuara dhe për të tjerët.

Neni 32

Bashkëpunimi ndërkombëtar

1. Shtetet palë pranojnë rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe promovimin e tij, në mbështetje të përpjekjeve kombëtare për realizimin e qëllimit dhe objektivave të kësaj konvente dhe do të ndërmarrin masat e duhura dhe efektive në këtë drejtim, ndërmjet shteteve dhe sipas rastit në partneritet me organizatat përkatëse ndërkombëtare dhe rajonale dhe shoqërinë civile, në veçanti organizatat për personat me aftësi të kufizuara. Këto masa mund të përfshijnë ndër të tjera:

a) të sigurojnë se bashkëpunimi ndërkombëtar, përfshirë dhe programet ndërkombëtare të zhvillimit, të jenë përfshirëse dhe të mundshme për personat me aftësi të kufizuara;

b) të lehtësojnë dhe mbështesin krijimin e kapaciteteve, përfshirë faktin e shkëmbimit dhe ndarjes së informacionit, përvojës, programeve të trajnimit dhe praktikës më të mirë;

c) të lehtësojnë bashkëpunimin në punën kërkimore dhe mundësimin e njohurive shkencore dhe teknike; dhe

d) të sigurojnë, sipas rastit, asistencë teknike dhe ekonomike, përfshirë dhe lehtësimin e mundësimin dhe përdorimin e përbashkët të teknologjisë ndihmëse dhe të mundshme dhe nëpërmjet transferimit të teknologjisë.

2. Dispozitat e këtij neni nuk cenojnë detyrimet e secilit shtet palë për të plotësuar detyrimet e tij në këtë konventë.

Neni 33

Zbatimi dhe monitorimi kombëtar

1. Shtetet palë, në përputhje me sistemin e tyre të organizimit, duhet të caktojnë një apo më shumë pika kontakti në qeveri për çështje që kanë të bëjnë me zbatimin e kësaj konvente dhe duhet të shqyrtojnë ngritjen apo caktimin e një mekanizmi bashkëpunimi brenda qeverisë për të lehtësuar veprimet e lidhura me të në sektorë të ndryshëm dhe në nivele të ndryshme.

2. Shtetet palë, në përputhje me sistemet e tyre ligjore dhe administrative, mbajnë, fuqizojnë, caktojnë ose ngrenë brenda shtetit palë, një kuadër, i cili do të përfshijë një apo më shumë mekanizma të pavarur, si të jetë më e përshtatshme, për të promovuar, mbrojtur dhe monitoruar zbatimin e kësaj konvente. Gjatë caktimit apo ngritjes së një mekanizmi të tillë, shtetet palë duhet të kenë parasysh parimet lidhur me statusin dhe funksionimin e institucioneve kombëtare për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut.

3. Shoqëria civile dhe veçanërisht personat me aftësi të kufizuara dhe organizatat e tyre përfaqësuese, duhet të përfshihen dhe të marrin pjesë plotësisht në procesin monitorues.

Neni 34

Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

1. Do të ngrihet një Komitet për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (më poshtë quhet “Komiteti”), i cili do të kryejë funksionet e paraqitura më poshtë.

2. Komiteti, në momentin kur kjo konventë hyn në fuqi, do të përbëhet prej dymbëdhjetë ekspertësh. Pas gjashtëdhjetë ratifikimesh apo aderimesh shtesë në konventë, anëtarësia e Komitetit do të shtohet me gjashtë anëtarë, duke ruajtur një numër maksimal prej tetëmbëdhjetë anëtarësh.

3. Anëtarët e Komitetit do të shërbejnë në zotësinë e tyre personale dhe do të jenë me një qëndrim të lartë moral dhe kompetencë e përvojë të njohur në fushën e paraqitur në këtë konventë. Shtetet palë ftohen t’i kushtojnë vëmendjen e duhur dispozitës së parashtruar në nenin 4.3 të kësaj konvente, kur bëjnë caktimin e kandidatëve të tyre.

4. Anëtarët e Komitetit do të zgjidhen nga shtetet palë, ku do t’u kushtohet vëmendje shpërndarjes së barabartë gjeografike, përfaqësimit të formave të ndryshme të civilizimit dhe të sistemeve ligjore kryesore, përfaqësimit të barabartë gjinor dhe pjesëmarrjes së ekspertëve me aftësi të kufizuara.

5. Anëtarët e Komitetit do të zgjidhen me votim të fshehtë nga një listë me shtetas të caktuar nga shtetet palë në takimet e konferencës së shteteve palë. Në ato takime, për të cilat dy të tretat e shteteve palë duhet të përbëjnë kuorumin, personat e zgjedhur në Komitet do të jenë ata që sigurojnë numrin më të madh të votave dhe një shumicë absolute të votave të përfaqësuesve të shteteve palë që janë të pranishëm dhe votojnë.

6. Zgjedhjet fillestare do të mbahen jo më vonë se gjashtë muaj pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj konvente. Së paku katër muaj para datës së zgjedhjeve, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do t’u dërgojë një letër shteteve palë duke i ftuar ata që të paraqesin caktimet brenda dy muajve. Sekretari i Përgjithshëm do të përgatitë më pas në rend alfabetik një listë me të gjithë personat e caktuar, duke treguar shtetet palë që i kanë caktuar ata dhe do t’ua paraqesë atë shteteve palë të kësaj konvente.

7. Anëtarët e Komitetit do të zgjidhen për një mandat katërvjeçar. Ata do të kenë të drejtën e rizgjedhjes një herë. Megjithatë, mandati për të gjashtë anëtarët e zgjedhur në zgjedhjet e para do të skadojë në fund të dy viteve; menjëherë pas zgjedhjeve të para, emrat e këtyre gjashtë anëtarëve do të zgjidhen me short nga kryetari i takimit siç referohet në paragrafin 5 të këtij neni.

8. Zgjedhja e gjashtë anëtarëve shtesë të Komitetit do të mbahet me rastin e zgjedhjeve të rregullta, në përputhje me dispozitat përkatëse të këtij neni.

9. Në qoftë se një anëtar i Komitetit vdes apo jep dorëheqjen apo deklaron se për çfarëdo shkakui ai apo ajo nuk mund të kryejë detyrat e tij apo të saj, shteti palë, i cili ka caktuar anëtarin/anëtarene duhet të emërojë një ekspert tjetër që i ka kualifikimet dhe plotëson kriteret e përcaktuara në dispozitat përkatëse të këtij neni, që të shërbejë për pjesën e mbetur të mandatit.

10. Komiteti duhet të vendosë rregullat e tij të procedurës.

11. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të sigurojë stafin dhe mjetet e nevojshme për realizimin efektiv të funksioneve të Komitetit në këtë konventë dhe do të thërrasë mbledhjen e tij të parë.

12. Me miratimin e Asamblesë së Përgjithshme, anëtarët e Komitetit të ngritur sipas kësaj konvente do të marrin pagesë nga burimet e Kombeve të Bashkuara sipas termave dhe kushteve që mund të vendosë Asambleja, duke pasur parasysh rëndësinë e përgjegjësisë të Komitetit.

13. Anëtarët e Komitetit do të kenë të drejtë për lehtësi, privilegje dhe imunitete të ekspertëve në misione për Kombet e Bashkuara siç parashtrohet në seksionet përkatëse të konventës mbi privilegjet dhe imunitetet e Kombeve të Bashkuara.

Neni 35

Raportet nga shtetet palë

1. Çdo shtet palë do të paraqesë në Komitet, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, një raport gjithëpërfshirës mbi masat e marra për të bërë efektive detyrimet e tij në këtë konventë dhe mbi progresin e bërë në këtë drejtim, brenda dy viteve pas hyrjes në fuqi të kësaj konvente për atë shtet palë.

2. Pas kësaj, shtetet palë paraqesin raportet pasuese të paktën çdo katër vjet, si dhe sa herë që kërkohet nga Komiteti.

3. Komiteti do të vendosë udhëzimet e zbatueshme për përmbajtjen e raporteve.

4. Shteti palë, i cili i ka paraqitur Komitetit një raport fillestar gjithëpërfshirës nuk nevojitet të përsërisë informacionin e paraqitur më parë në raportet e tij të tjera pasuese. Kur bëjnë përgatitjen e raporteve për Komitetin, shtetet palë ftohen të kenë parasysh që ta bëjnë këtë në një proces të hapur dhe transparent, si dhe t'u kushtojnë vëmendjen e duhur dispozitave të përcaktuara në nenin 4.3 të kësaj konvente.

5. Raportet mund të tregojnë faktorë dhe vështirësi që ndikojnë në shkallën e plotësimit të detyrimeve të kësaj konvente.

Neni 36

Shqyrtimi i raporteve

1. Çdo raport duhet të shqyrtohet nga Komiteti, i cili do të bëjë sugjerime dhe rekomandime të përgjithshme mbi raportin siç ai e konsideron të përshtatshme dhe do t'ua dërgojë ato shtetit palë përkatës. Shteti palë mund të përgjigjet me çdo informacion, që ai zgjedh për Komitetin. Komiteti mund të kërkojë nga shtetet palë informacion të mëtejshëm lidhur me zbatimin e kësaj konvente.

2. Në qoftë se shteti palë e ka tejkaluar shumë afatin për paraqitjen e raportit, Komiteti mund të njoftojë shtetin palë përkatës lidhur me nevojën për të shqyrtuar zbatimin e kësaj konvente në atë shtet palë, mbi bazën e informacionit të besueshëm të disponueshëm për Komitetin, në qoftë se raporti përkatës nuk paraqitet brenda tre muajve nga njoftimi. Komiteti do të ftojë shtetin palë përkatës për të marrë pjesë në këtë shqyrtim. Nëse shteti palë përgjigjet me paraqitjen e raportit përkatës, do të zbatohen dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni.

3. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të vërë raportet në dispozicion të të gjitha shteteve palë.

4. Shtetet palë do t'ia paraqesin raportin e tyre sa më gjerësisht publikut të vendeve të tyre dhe do të lehtësojnë mundësimin e sugjerimeve dhe rekomandimeve të përgjithshme lidhur me këto raporte.

5. Komiteti do të transmetojë, siç mund ta çmojë të përshtatshme, tek agjencitë e specializuara, fondet dhe programet e Kombeve të Bashkuara dhe organizma të tjerë kompetentë, raportet nga shtetet palë me qëllim për të paraqitur një kërkesë apo tregues të nevojës për këshillim apo asistencë teknike të përfshirë në raport, krahas vëzhgimeve dhe rekomandimeve të Komitetit, në rast se ka të tilla, lidhur me këto kërkesa ose tregues.

Neni 37

Bashkëpunimi midis shteteve palë dhe Komitetit

1. Çdo shtet palë do të bashkëpunojë me Komitetin dhe do të asistojë anëtarët e tij në përmbushjen e mandatit të tyre.

2. Komiteti, në marrëdhëniet e tij me shtetet palë, do t'i kushtojë vëmendjen e duhur rrugëve dhe mënyrave për rritjen e kapaciteteve kombëtare për implementimin e kësaj konvente, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkombëtar.

Neni 38

Marrëdhëniet e Komitetit me organizmat e tjerë

Me qëllim për të inkurajuar implementimin efektiv të kësaj konvente dhe bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e mbuluar nga kjo konventë:

a) Agjencitë e specializuara dhe organet e tjera të Kombeve të Bashkuara do të kenë të drejtë të përfaqësohen në shqyrtimin e implementimit të dispozitave të kësaj konvente, të cilat bëjnë pjesë gjithashtu në mandatin e tyre. Komiteti mund të ftojë agjencitë e specializuara dhe organet e tjera kompetente, siç mund ta çmojë të përshtatshme, për të siguruar këshillim të specializuar lidhur me implementimin e konventës në ato çështje që bëjnë pjesë në mandatet e tyre përkatëse. Komiteti mund të ftojë agjenci të specializuara dhe organe të tjera të Kombeve të Bashkuara të paraqesin raportet mbi zbatimin e konventës për çështje që bëjnë pjesë në gamën e aktiviteteve të tyre;

b) Komiteti, në realizimin e mandatit të tij, do të konsultojë, si të jetë e përshtatshme, organe të tjera përkatëse të institucionalizuara nga traktatet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, me qëllim për të siguruar përputhshmëri të udhëzimeve të tyre raportuese përkatëse, sugjerimeve dhe rekomandimeve të tyre të përgjithshme dhe për të mënjанuar duplikimin apo mbivendosjen në realizimin e këtyre funksioneve.

Neni 39

Raporti i Komitetit

Komiteti do të raportojë çdo dy vjet tek Asambleja e Përgjithshme dhe Këshilli Ekonomik dhe Shoqëror lidhur me aktivitetet e tij dhe mund të bëjë sugjerime dhe rekomandime të përgjithshme bazuar në shqyrtimin e raporteve dhe informacionin e marrë nga shtetet palë. Këto sugjerime dhe rekomandime të përgjithshme do të përfshihen në raportin e Komitetit së bashku me komentet, në rast se ka, nga shtetet palë.

Neni 40

Konferenca e shteteve palë

1. Shtetet palë do të takohen rregullisht në Konferencën e shteteve palë, për të shqyrtuar çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e kësaj konvente.

2. Konferenca e shteteve palë do të thirret nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara jo më vonë se gjashtë muaj pasi kjo konventë të hyjë në fuqi. Takimet pasuese do të thirren nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara çdo dy vjet ose me vendim të Konferencës së shteteve palë.

Neni 41

Depozitari

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të jetë depozitari i kësaj konvente.

Neni 42

Nënshkrimi

Kjo konventë do të jetë e hapur për t'u nënshkruar nga të gjitha shtetet dhe nga organizata integruese rajonale në zyrat qendrore të Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork më 30 mars 2007.

Neni 43

Pëlqimi për ta respektuar

Kjo konventë i nënshtrohet ratifikimit nga shtetet nënshkruese dhe konfirmimit formal nga organizata integruese rajonale nënshkruese. Do të jetë e hapur për aderimin e çdo shteti apo organizate rajonale integruese, që nuk e ka firmosur konventën.

Neni 44

Organizatat integruese rajonale

1. "Organizatrat integruese rajonale" do të thotë një organizatë e përbërë nga shtetet sovrane të një rajoni të caktuar, tek të cilat shtetet anëtare kanë transferuar kompetenca lidhur me çështjet e përcaktuara nga kjo konventë. Organizata të tilla do të deklarojnë, në instrumentet e tyre të konfirmimit apo pranimit formal, nivelin e kompetencave të tyre lidhur me çështjet e përcaktuara nga kjo konventë. Si rrjedhojë, ato duhet të informojnë autoritetin përgjegjës për çdo modifikim thelbësor në nivelin e kompetencave.

2. Termi "shtete palë" në këtë konventë do të zbatohet për organizata të tilla brenda kufijve të kompetencave të tyre.

3. Për qëllimet e nenit 45 paragrafi 1 dhe nenit 47 paragrafi 2 dhe 3, asnjë instrument i depozituar nga organizata integruese rajonale nuk do të numërohet.

4. Organizatat integruese rajonale, në çështjet brenda kompetencave të tyre, mund të ushtrojnë të drejtën e tyre për të votuar në Konferencën e shteteve palë, me një numër votash të barabartë me numrin e shteteve të tyre anëtare, që janë palë në këtë konventë. Një organizatë e tillë nuk do të ushtrojë të drejtën e saj për të votuar nëse ndonjë prej shteteve anëtare ushtron të drejtën e tij dhe anasjellas.

Neni 45

Hyrja në fuqi

1. Kjo konventë do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas depozitimit të instrumentit të njëzet të ratifikimit apo aderimit.

2. Për çdo shtet apo organizatë integruuese rajonale që ratifikon, konfirmon apo pranon formalisht konventën pas depozitimit të instrumentit të njëzet, konventa do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas depozitimit të instrumentit të saj.

Neni 46

Rezervat

1. Rezervat e papajtueshme me objektin dhe qëllimin e kësaj konvente nuk do të lejohen.
2. Rezervat mund të tërhiqen në çdo moment.

Neni 47

Ndryshimet

1. Çdo shtet palë mund të propozojë një ndryshim të kësaj konvente dhe ta paraqesë atë te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara. Sekretari i Përgjithshëm do t'ua komunikojë çdo ndryshim të propozuar shteteve palë, me një kërkesë për të njoftuar nëse ato janë në favor të një konference të shteteve palë, me qëllim për të shqyrtuar dhe vendosur lidhur me propozimet. Në rast se brenda katër muajve nga data e një komunikimi të tillë dhe së paku një e treta e shteteve palë janë në favor të një konference, Sekretari i Përgjithshëm do të mbledhë konferencën nën kujdesin e Kombeve të Bashkuara. Çdo ndryshim i miratuar duhet të paraqitet nga Sekretari i Përgjithshëm në Asamblenë e Përgjithshme për miratim dhe pas kësaj të shtetet palë për pranim.

2. Ndryshimi i mbështetur dhe i miratuar në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë, pasi numri i instrumenteve të pranimit të depozituara arrin dy të tretat e numrit të shteteve palë në datën e miratimit të ndryshimit. Pas kësaj, ndryshimi do të hyjë në fuqi për çdo shtet palë në ditën e tridhjetë pas depozitimit të instrumentit të tij të pranimit. Ndryshimi do të jetë detyrues vetëm për ato shtete të cilat e kanë pranuar atë.

3. Nëse vendoset me konsensus në Konferencën e shteteve palë, një ndryshim i mbështetur dhe i miratuar në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, i cili lidhet ekskluzivisht me nenet 34, 38, 39 dhe 40, do të hyjë në fuqi për të gjitha shtetet palë në ditën e tridhjetë pasi numri i instrumenteve të pranimit të depozituara arrin dy të tretat e numrit të shteteve palë në datën e miratimit të ndryshimit.

Neni 48

Denoncimi i marrëveshjes

Një shtet palë mund të denoncojë marrëveshjen për këtë konventë me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Denoncimi i marrëveshjes do të bëhet efektiv një vit pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 49

Formati i lexueshëm

Teksti i kësaj konvente do të përgatitet në format të lexueshëm.

Neni 50

Tekstet autentike

Tekstet e kësaj konvente në gjuhët arabe, kineze, angleze, frënge, ruse dhe spanjolle janë njëlloj autentike.

Në dëshmi sa më sipër, të plotfuqishmit e poshtëshënuar, të autorizuar për këtë qëllim nga qeveritë përkatëse, kanë firmosur këtë konventë.

VENDIM
Nr. 460, datë 27.5.2015

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË PARË KOMBËTAR PËR ZBATIMIN E
KONVENTËS SË OKB-SË “PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË
KUFIZUARA”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të konventës së OKB-së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”, ratifikuar me ligjin nr. 108/2012, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e Raportit të Parë Kombëtar për zbatimin e konventës së OKB-së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij¹.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LIGJ
Nr.7889, datë 14.12.1994

PËR STATUSIN E INVALIDËVE TË PUNËS²

(Ndryshuar me ligjin nr. 8052, datë 21.12.1995; me ligjin nr. 9143, datë 16.10.2003)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

(ndryshuar me ligjin nr. 9143, datë 16.10.2003)

Statusin e invalidit e gëzon personi i aksidentuar në punë, i sëmurë nga sëmundje profesionale ose sëmundje të ndryshme, që përfiton pension invaliditeti nga sistemi i sigurimeve shoqërore, sipas ligjit nr. 4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 "Për pensionin e ish-anëtarëve të kooperativave bujqësore", i ndryshuar dhe ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Neni 2

Shoqëria dhe shteti marrin në mbrojtje invalidët, në mënyrë që ata të marrin pjesë në jetën shoqërore njëjloj si të tjerët, t'u sigurohet niveli ekonomik i nevojshëm për të jetuar në mënyrë

¹ - Raporti i Parë Kombëtar për zbatimin e konventës së OKB-së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara” është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 94, datë 9.6.2015.

² Ndryshuar titulli me ligjin nr. 9143, datë 16.10.2003

dinjitoze, të kenë kushte banimi, të shfrytëzojnë mjedisin e jashtëm, të kenë një punë të përshtatshme, si dhe t'u krijohen mundësi normale për kurim, arsimim dhe veprimtari çlodhëse e argëtuese.

Neni 3

Shteti mbron invalidët nga të gjitha llojet e shfrytëzimit, diskriminimit, abuzimit, fyerjes dhe talljes.

Neni 4

(ndryshuar me ligjin nr. 8052, datë 21.12.1995)

Invalidët pajisen me dëshmi zyrtare identifikimi. Dëshmia lëshohet nga Shoqata e Invalidëve të Punës, në bazë të KMAC.

Neni 5

Asnjë organ nuk ka të drejtë të japë të dhëna për gjendjen e invaliditetit të një personi pa pëlqimin e tij.

Neni 6

Statusi i invalidit vazhdon edhe pas mbushjes së moshës për pension pleqërie.

Neni 7

(ndryshuar me ligjin nr. 9143, datë 16.10.2003)

Invalidët e punës, që kanë qenë të punësuar në ndërmarrjet, institucionet shtetërore, ish-kooperativat bujqësore, repartet ushtarake, si dhe ushtarët e shërbimit të detyrueshëm, që vuajnë nga sëmundje profesionale, të aksidentuar në punë dhe me sëmundje të ndryshme, që marrin pension invaliditeti, në mbështetje të ligjit nr. 4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 "Për pensionin e ish-anëtarëve të kooperativave bujqësore", i ndryshuar dhe ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, përfitojnë një shtesë mujore mbi pensionin e invaliditetit, si përfitim paafësie, nga Buxheti i Shtetit.

Kriteret e marrjes së përfitimit të paafësisë dhe masa e tij përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 8

(shtuar fjalë në shkronjën "a" të pikës 1 me ligjin nr. 8052, datë 21.12.1995)

8.1. Instituti i Sigurimeve Shoqërore administron pajisjen e invalidëve me:

- a) mjete lëvizëse përfshi dhe autovetura dhe pajisje të ndryshme ortopedike;
- b) me mjete ndihmëse dëgjimore e pamore speciale;
- c) me mjete ndihmëse kardiake etj.

Kriteret përcaktohen me rregullore të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

8.2. Invalidët nuk paguajnë taksa doganore për mjetet lëvizëse dhe ndihmëse të përcaktuara në pikat "a", "b" dhe "c" të pikës 8.1 të nenit 8.

Neni 9

(ndryshuar me ligjin nr. 8052, datë 21.12.1995)

Në shtëpitë ekzistuese të pushimit shteti në marrëveshje me subjektet që i kanë në pronësi cakton një kontingjent vendesh për pushimin e invalidëve.

Në vendet e përshtatshme klimaterike, shteti cakton sipërfaqe të lira për ndërtimin e kampeve të pushimit dhe qendrave të rehabilitimit për invalidët. Rregullat e financimit për ndërtimin e tyre vendosen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 10

Për të paralizuarit dhe të gjymtuarit rëndë që nuk lëvizin, organizohet shërbimi mjekësor në banesë falas.

Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit nxjerr aktet nënligjore përkatëse.

Neni 11

11.1. Udhëtimi i invalidëve me mjetet e komunikacionit shtetëror dhe privat qytetas bëhet falas.

11.2. Udhëtimi me mjetet e komunikacionit shtetëror dhe privat ndërqytetës bëhet me 50 përqind të vlerës së biletës.

11.3. Të gjitha mjetet e udhëtimit qytetas dhe ndërqytetës rezervojnë vende të veçanta për invalidët.

Ministria që mbulon transportin dhe komunikacionin nxjerr aktet nënligjore përkatëse.

Neni 12

Hyrja e invalidëve në shfaqje artistike, muze, ndeshje e manifestime sportive bëhet me 50 përqind të çmimit të biletës.

Ministria që mbulon kulturën, rininë e sportet nxjerr aktet nënligjore përkatëse.

Neni 13

13.1. Mjediset e institucioneve shëndetësore, të përkujdesjes shoqërore dhe ato publike përshtaten për përdorimin e tyre nga të verbrit dhe paraplegjikët.

Procedura dhe fazat e përshtatjes përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

13.2. Të gjitha ndërtimet e reja publike që realizohen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet të ofrojnë mundësi përdorimi nga kategoritë e ndryshme të personave me aftësi të kufizuara.

Ministria që mbulon ndërtimin, strehimin dhe rregullimin e territorit nxjerr aktet nënligjore përkatëse.

Neni 14

(ndryshuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 8052, datë 21.12.1995)

Invalidët punësohen dhe ripunësohen në ndërmarrje shtetërore dhe private në procese pune të përshtatshme që rekomandohen nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë.

Rregullat e punësimit dhe ripunësimit të invalidit caktohen me ligj të veçantë.

Neni 15

Invalidët favorizohen në ndjekjen e kurseve të kualifikimit e të rikualifikimit profesional, si dhe ndjekjen e shkollave të larta.

Neni 16

16.1. Invalidët përjashtohen nga taksat e drejtpërdrejta të parashikuara në ligjin nr.7680, datë 3.3.1993 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”.

16.2. Kur invalidi ushtron veprimtari private, nuk përjashtohet nga taksat.

Neni 17

Gjatë përgatitjes së akteve ligjore e nënligjore dhe të programeve qeveritare mbahen parasysh interesat e nevojat e invalidëve.

Shoqatat që mbrojnë interesat e invalidëve, marrin pjesë në mbledhjet për diskutimin dhe miratimin e akteve ligjore dhe nënligjore që prekin drejtpërdrejt a tërthorazi interesat e invalidëve.

Neni 18

18.1. Shteti financo veprimtarinë e Shoqatës së Invalidëve të Punës sipas mundësive dhe burimeve financiare të planifikuara për këtë qëllim.

18.2. Mjediset që shteti vë në dispozicion të Shoqatës së Invalidëve të Punës për të zhvilluar veprimtarinë e saj, jepen në përdorim pa shpërblim.

Neni 19

(shtuar fjalë në fund të pikës 2 me ligjin nr. 8052, datë 21.12.1995)

19.1. Të drejtat që gëzojnë invalidët sipas statusit të tyre, afishohen në vende të dukshme në mjediset publike.

19.2. Për shkelje të të drejtave që sanksionohen nga ky ligj, invalidi ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës individualisht ose nëpërmjet shoqatave që mbrojnë interesat e tyre.

Neni 20

20.1. Për zbatimin e këtij ligji ngarkohet Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe e ish të Përndjekurve Politikë.

20.2. Ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore përkatëse nxjerrin aktet nënligjore të përcaktuara me këtë ligj brenda 90 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 21

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1000, datë 28.12.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha

VENDIM

Nr.199, datë 3.5.1995

PËR LEHTËSITË QË U KRIJOHEN INVALIDËVE NË NDËRTIMET PUBLIKE

Në zbatim të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit", me propozimin e Ministrisë së Ndërtimit dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të gjitha ndërtimet e reja publike që realizohen pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit" dhe të këtij vendimi, duhet të ofrojnë kushte të përshtatshme përdorimi dhe për invalidët, që mënjanojnë barrierat arkitektonike.

2. Të gjithë personat fizikë e juridikë që hartojnë projekte për ndërtime publike (spitale, shtëpi pushimi, shkolla), në mjediset e jashtme të këtyre ndërtimeve parashikojnë kushte që mbajnë parasysh interesat e invalidëve dhe të personave me aftësi të kufizuar.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Ndërtimit dhe e Turizmit, Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë, si dhe gjithë institucionet projektuese e zbatuese, publike e private.

4. Llojet dhe kategoritë e barrierave arkitektonike do të përcaktohen me udhëzim të veçantë të Ministrisë së Ndërtimit dhe Turizmit.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

VENDIM
Nr.612, datë 6.11.1995

**PËR FAVORIZIMIN E INVALIDËVE NË SISTEMIN E KULTURËS, RINISË
DHE SPORTEVE**

Në mbështetje të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit", me propozimin e Ministrisë së Kulturës, të Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të gjithë invalidët që gëzojnë zyrtarisht statusin si të tillë, në bazë të ligjit të sipërpërmendur, kanë të drejtë të hyjnë në të gjitha llojet e institucionet buxhetore e jobuxhetore, për të gjitha llojet e veprimtarive kulturore e artistike, rinore e sportive, që zhvillohen në mjedise publike, të hapura ose të mbyllura.

2. Institucionet e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, në nivel kombëtar e lokal, janë të detyruara të pranojnë në çdo rast ata invalidë që paraqesin dëshminë e invaliditetit, për të gjitha veprimtaritë, kundrejt pagesës prej 50 për qind të çmimit të biletës, të vendosur për atë shfaqje ose veprimtari.

Invalidi, në momentin e prerjes së biletës, duhet të paraqesë dokumentin identifikues që e njeh zyrtarisht si të tillë, siç parashikohet në ligjin nr.7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit".

3. Për pjesëmarrjen e invalidëve në veprimtari të tilla, institucionet janë të detyruara të rezervojnë për ta vende të përshtatshme.

4. Personeli i shërbimit të institucionit ku zhvillohet veprimtaria, duhet ta ndihmojë invalidin pa asnjë lloj shpërblimi, për t'i siguruar atij një qëndrim sa më normal në institucion, gjatë kohës së zgjatjes së veprimtarisë.

5. Invalidët të favorizohen në ndjekjen e kurseve të kualifikimit profesional që zhvillojnë institucionet e sistemit të kulturës, rinisë dhe sporteve.

6. Mjediset që institucionet shtetërore të sistemit të kulturës, rinisë dhe sporteve vënë në dispozicion të Shoqatës së Invalidëve për të zhvilluar veprimtarinë e tyre, vihen në përdorim pa shpërblim.

7. Efekti financiar që rrjedh nga shitja e biletave me 50 për qind të çmimit, të përballohet nga të ardhurat e vetë institucionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

VENDIM
Nr.869, datë 18.6.2008

PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.7889, DATË 14.12.1994 "STATUSI I INVALIDIT"

(Ndryshuar me VKM nr. 1075, datë 23.7.2008 ; nr. 1235, datë 16.12.2009, nr. 38 datë 19.1.2011)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 "Për statusin i invalidit", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Personave përfitues, sipas përcaktimit të nenit 1 të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit", të ndryshuar, u jepet një shtesë mujore mbi pensionin e invaliditetit, si përfitim paaftësie, në masën:

a) 3300 (tre mijë e treqind) lekë në muaj, nëse janë invalidë të plotë, nga sëmundje të përgjithshme;

b) 2200 (dy mijë e dyqind) lekë në muaj, nëse janë invalidë të pjesshëm, nga sëmundje të përgjithshme;

c) 4000 (katër mijë) lekë në muaj, nëse janë invalidë të plotë, nga aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale;

ç) 2700 (dy mijë e shtatëqind) lekë në muaj, nëse janë invalidë të pjesshëm, nga aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale.

2. Invalidi do ta përfitojë shtesën për paaftësi, sipas përcaktimeve të dhëna në shkronjat "a", "b", "c" e "d" të pikës 1 të këtij vendimi, edhe kur del në pension pleqërie.

3. *Pagesa e përfitimit të paaftësisë, për invalidin, paguhet nga shërbimet bankare ose Posta Shqiptare, pranë njësisë të qeverisjes vendore ku ka vendbanimin përfituesi.*

4. Efektet financiare shtesë, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, në masën 97 000 000 (nëntëdhjetë e shtatë milionë) lekë të përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e vitit 2008, për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

5. *Fondi 70 000 000 (shtatëdhjetë milionë) lekë të përballohet nga fondi i kontingjencës dhe të derdhet në buxhetin e vitit 2008, miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.*

6. Ministria e Financave dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, të nxjerrin udhëzime në zbatim të këtij vendimi, për përcaktimin e procedurave dhe të dokumentacionit të nevojshëm për dhënien e përfitimit.

7. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

8. Vendimet nr.381, datë 20.5.1996 "Për zbatimin e ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit"" dhe nr.204, datë 16.4.2004 "Për masën dhe kriteret për përfitim paaftësie nga personat me statusin e invalidit të punës" të Këshillit të Ministrave, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1503, datë 19.11.2008

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR SHFRYTËZIMIN E HAPËSIRAVE
NGA ANA E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, dhe të neneve 13 e 20 të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar, që i bashkëlidhet këtij vendimi.³

2. Në rregulloren e urbanistikës, miratuar me vendimin nr.722, datë 19.11.1998 të Këshillit të Ministrave, ndryshuar me vendimin nr.401, datë 25.6.2004 të Këshillit të Ministrave, pika 141 “Rregullat dhe normat urbanistike dhe arkitektonike për personat me aftësi të kufizuar”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LIGJ
Nr.8098, datë 28.3.1996

PËR STATUSIN E TË VERBËRIT

(Ndryshuar me ligjin nr. 26/2012, datë 15.3.2012)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Përfitojnë nga ky ligj të gjithë personat me mungesë të plotë ose të pjesshëm shikimi, të lindur ose të fituar, të cilët sipas kritereve mjekësore janë të paaftë për punë në kushte normale.

Neni 2

Shteti dhe shoqëria marrin në mbrojtje personat e verbër dhe krijojnë të gjitha kushtet për integrimin e tyre në jetën normale. Me integrim kuptohet pjesëmarrja aktive duke plotësuar kushtet e mëposhtme:

³ -Rregullorja “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar” është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 178, datë 5.12.2008.

a) krijimin e kushteve të përshtatshme për banim, të sipërfaqes së banimit dhe të pajisjeve të zakonshme dhe speciale;

b) punësimin në kushte të favorshme e me përparësi, duke përcaktuar profesionet e mbrojtura me ligj;

c) risistemimi në punë i atyre të verbërve që për arsye të ndryshme janë pushuar ose kanë humbur punën dhe gjatë kësaj kohe marrin një shpërblim të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave;

ç) përcaktimin e fondeve për depistimin dhe ridiagnostikimin nga klinikat okulistike të sistemit të shërbimit shëndetësor shtetëror nën mbikëqyrjen dhe me ndihmën e specialistëve të huaj të klinikave të përparuara perëndimore, si dhe krijon kushte të favorshme për mjekimin e syve dhe sëmundjeve të tjera të lindura apo të fituara.

Neni 3

Shteti mbron të verbërit nga të gjitha llojet e shfrytëzimit, diskriminimit, abuzimit, fyerjes dhe talljes. Kur këto përbëjnë vepër penale, iniciativën për fillimin e çështjes penale, përveç kujdestarit e ka edhe organi i prokurorisë apo organizata, në të cilën ata bëjnë pjesë ose përkujdeset për ta.

Neni 4

Të verbërit përjashtohen nga çdo lloj takse dhe tatimi të drejtpërdrejtë, me përjashtim të rasteve kur ata kryejnë veprimtari private si persona juridikë.

Neni 5

Pavarësisht nga të ardhurat e tjera që përfitohen nga shteti, të verbërit marrin një shtesë për shkak të verbërisë së tyre në masën e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave e cila nuk llogaritet në të ardhurat familjare për efekt varfërie. Po në këtë masë pagesën e përfiton edhe kujdestari i tyre, të cilin e zgjedhin vetë.

Neni 6

Personat juridikë shtetërorë apo privatë që punësojnë të verbërit, përveç kriterëve të përcaktuara në ligjin nr.7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, përfitojnë ulje në tatimin mbi fitimin të barabartë me përqindjen e fuqisë punëtore të verbër.

Neni 7

Këshillat e Rregullimit të Territorit dhe organet e urbanistikës nuk miratojnë asnjë projekt për rrugët e mjediset publike, në qoftë se në to nuk janë mbajtur parasysh përshtatjet e nevojshme dhe të mundshme të tyre për të verbërit.

Shteti kujdeset për strehimin e të verbërve, duke siguruar veçanërisht për të verbërit e grupit të parë, ose që barazohen me ta, një dhomë mbi kubaturën normale dhe përshtatjen e saj në raport me kushtet fizike.

Enti Kombëtar i Banesave përballon shpenzimet për blerjen dhe përshtatjen e banesës që përfitojnë të verbërit.

Neni 8

Arsimimi i të verbërve në sistemin shtetëror bëhet falas, kurse pranimi i tyre në arsimin e zakonshëm bëhet me kriterë të veçanta të përcaktuara nga Ministria e Arsimit. Gjatë kohës së studimit në arsimin e mesëm, universitar ose pasuniversitar, si dhe gjatë periudhës së kualifikimit, të verbërit përfitojnë pagesën e vendosur nga Këshilli i Ministrave. Ata me gradë shkencore këtë pagesë e përfitojnë në mënyrë të përhershme.

Këshilli i Ministrave merr masa dhe përcakton fonde për ngritjen e shkollave dhe institucioneve për arsimimin, edukimin dhe rehabilitimin e të verbërve.

Neni 9

Shteti bën sigurimin shëndetësor të të verbërve falas , si dhe përfitimin e ilaçeve dhe pajisjeve ndihmëse mjekësore falas, deri në masën e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave. Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit përcakton listën e pajisjeve ndihmëse.

Neni 10

Këshilli i Ministrave merr masat dhe përcakton fondet për ndërtimin e dy qendrave të pushimit bregdetare dhe malore me kapacitet të mjaftueshëm për numrin e të verbërve në Shqipëri. Administrimi i tyre bëhet nga Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë dhe subvencionohet nga shteti në masën e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave. Në funksion të çlodhjes dhe argëtimit shteti përkrah veprimtarinë kulturore të të verbërve, si dhe u siguron falas hyrjen në mjediset kulturore.

Neni 11

(ndryshuar me ligjin nr. 26/2012, datë 15.3.2012)

Të verbrit dhe shoqëruesit e tyre përfitojnë kompensim për shërbimin e transportit. Masa, kriteret dhe procedurat e këtij përfitimi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave .

Neni 12

(ndryshuar me ligjin nr. 26/2012, datë 15.3.2012)

Të gjithë personat e verbër, sipas nenit 1 të këtij ligji, përfitojnë kompensim të faturës së energjisë elektrike dhe të faturës telefonike fikse. Masa, kriteret dhe procedurat e përfitimit të këtij kompensimi financiar përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 13

Shteti mbron dhe përkrah Shoqatën e të Verbërve të Shqipërisë.

Ai i njeh asaj rolin aktiv në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të të verbërve, duke e trajtuar si palë konsultative në hartimin e ligjeve e akteve nënligjore, si dhe zgjidhjen e problemeve të të verbërve.

Shteti financo veprimtarinë e Shoqatës së të Verbërve të Shqipërisë sipas burimeve financiare të planifikuara për këtë qëllim.

Shteti vë në dispozicion të Shoqatës së të Verbërve mjedise pune në qendër dhe në rrethe, të cilat ua jep në përdorim.

Neni 14

Asnjë organ nuk ka të drejtë të japë të dhëna për gjendjen e invaliditetit të një personi pa pëlqimin e këtij të fundit.

Neni 15

Personat e verbër të përcaktuar në nenin 1 të këtij ligji përfitojnë të gjitha të drejtat e parashikuara në ligjin nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statutin e invalidit”.

Neni 16

Paditë e ngritura në gjykatë për mozbatimin e këtij ligji shqyrtohen me procedurë të përshpejtuar. Shpenzimet përballohen nga shteti.

Neni 17

Ngarkohet Këshilli i Ministrave dhe ministritë përkatëse të nxjerrin akte nënligjore në zbatimin e këtij ligji.

Neni 18

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekreten nr.1458, datë 9.4.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Sali Berisha**

VENDIM

Nr. 671, datë 15.12.2000

PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT MJEKËSOR TË PËRCAKTIMIT TË VERBËRISË

(Ndryshuar me VKM nr. 221, datë 10.4.2003)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbërit”, me propozimin e ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijimin e Komisionit Mjekësor të Përcaktimit të Verbërisë (KMPV), për përcaktimin e personave që përfitojnë nga statusi i të verbërit. Komisioni e ka qendrën në Tiranë dhe është në varësi të *Shërbimit Social Shtetëror*. Numri, përbërja dhe mënyra e funksionimit të komisionit të përcaktohet nga ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale.

2. KMPV-ja kryen detyrat dhe ka të drejtat e përcaktuara për KMCAP-në, sipas vendimit nr. 277, datë 18.6.1997, të Këshillit të Ministrave, “Për përfitimin nga statusi i të verbërit”

3. Brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të përfundojnë procedurat e kalimit të përgjegjësive nga KMCAP në KMPV. *Ngarkohet drejtori i Shërbimit Social Shtetëror* të normojë dhe të kontrollojë procesin e kalimit të këtyre përgjegjësive.

4. Kriteret mjekësore, për përfitimin nga “statusi i të verbërit”, janë të veçanta dhe përcaktohen nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe nga Ministria e Shëndetësisë.

5. *Pagesa e mjekëve dhe e anëtarëve të tjerë të komisionit të bëhet në bazë të pjesëmarrjes në çdo komision dhe, përkatësisht, për kryetarin e komisionit në masën 23 për qind, ndërsa për anëtarët e komisionit 20 për qind të pagës mujore, sipas strukturës së pagave të përcaktuara në vendimin nr.306, datë 27.6.2002 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve me arsim të lartë në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë”, kreu I.1, lidhja nr.1, emërtimi “mjek”, por jo më shumë se një pagë mujore e këtij emërtimi. Komisioni mblidhet jo më shumë se katër herë në muaj.*

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga pagesat për KMPV-në, të përballohen nga fondi i *Shërbimit Social Shtetëror*

7. Në vendimin nr. 277, datë 18.6.1997, të Këshillit të Ministrave, “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, bëhen ndryshimet si vijon:

a) “Kudo në vendim ku përmendet “KMCAP” (të rrethit përkatës) të zëvendësohet me “KMPV”.

b) Paragrafi i parë, pika 3 të riformulohet:

“Shoqata e të verbërve të Shqipërisë lëshon librezën e verbërisë, si dokument prove për përfitimin nga ligji nr. 8098, datë 28.3.1996, e cila nuk është e njëjtë me librezën e anëtarësisë. Librezat e verbërisë jepen vetëm kur Kryesisë së Shoqatës të së Verbërve të Shqipërisë i vihen në dispozicion nga KMPV-ja, raportet mjekësore dhe dokumentacioni tjetër, i nevojshëm për çdo person.”.

8. Ngarkohen Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

UDHËZIM
Nr. 4038, datë 4.9.2015

**PËR PËRCAKTIMIN E SHËRBIMEVE UNIVERSALE POSTARE, QË OFROHEN
PA PAGESË, PËR PERSONAT E VERBËR DHE PJESËRISHT TË VERBËR**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 4 të nenit 28 të ligjit nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Çdo person i verbër, ose pjesërisht i verbër, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për statusin e të verbërve, si dhe Shoqata e të Verbërve në Shqipëri, përfitojnë marrjen e shërbimeve universale postare pa pagesë sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi.

2. Objektet postare të dërguara në adresë të një personi të verbër, ose pjesërisht të verbër, do të përjashtohen nga të gjitha tarifat e shërbimit universal postar, me përjashtim të tarifave shtesë të transportit ajror në masën që këto objekte postare të jenë të pranueshme si të tilla në shërbimin e brendshëm të ofruesit të shërbimit universal postar të caktuar.

3. Objektet postare të dërguara nga një person i verbër, ose pjesërisht i verbër, do të përjashtohen nga të gjitha tarifat e shërbimit universal postar, me përjashtim të tarifave shtesë të transportit ajror, në masën që këto objekte postare të jenë të pranueshme si të tilla në shërbimin e brendshëm të ofruesit të shërbimit universal postar të caktuar.

4. Përjashtimi nga pagesat për dërgesat e objekteve postare do të aplikohet edhe për Shoqatën e të Verbërve në Shqipëri, e cila përfaqëson zyrtarisht personat e verbër dhe pjesërisht të verbër, duke mbrojtur të drejtat dhe interesat e tyre.

5. Përjashtimi nga tarifat e shërbimit universal postar zbatohet me kusht që dërguesi dhe/ose marrësi të jetë person i verbër sipas pikës 1 të këtij udhëzimi ose kur dërguesi dhe/ose marrësi është një shoqatë e njohur zyrtarisht që vepron në ndihmë të të verbërve sipas pikës 4 të këtij udhëzimi.

6. Objektet postare, në zbatim të këtij udhëzimi, përfshijnë:

a) korrespondencën, literaturën për personat e verbër dhe pjesërisht të verbër në çfarëdo formati (përfshirë regjistrimet me zë);


b) pajisje apo materiale të çfarëdo lloji të përshtatura për të ndihmuar personat e verbër dhe pjesërisht të verbër në lehtësimin e problemeve të shikimit.

7. Objekte postare, paketa, koliposta të dërguara nga vende të tjera, që përmbajnë materiale për personat e verbër apo për Shoqatën e të Verbërve në Shqipëri, do të përjashtohen nga tarifa e magazinimit dhe dorëzimit.

8. Kufiri maksimal i peshës për objektin postar të dërguar në adrese të, dhe/ose nga një person i verbër dhe pjesërisht i verbër, si dhe në adresë të, dhe/ose nga Shoqata e të Verbërve në Shqipëri për brenda dhe jashtë vendit është deri në 7 kg.

9. Objektet postare për personat e verbër dhe pjesërisht të verbër duhet të plotësojnë kërkesat si më poshtë:

- a) literatura për të verbrit, të jenë të shtypura në relief që përdoren nga të verbrit;
- b) të ambalazhohen në mënyrë të atillë që të mbrohet mirë përmbajtja, por edhe të mos pengohet një verifikim i lehtë dhe i shpejtë i tyre si objekte për të verbrit;
- c) objektet për të verbrit, të pranuarat e të adresuarat brenda vendit, rekomandohet të pajisen me një etiketë të bardhë me simbolin e paraqitur si më poshtë, me shënimin: “*Objekt postar për të verbër*” dhe në pako postare me mbishkrimin: “*Materiale për përdorim nga të verbrit*”;



d) objektet për të verbrit, të pranuarat për jashtë vendit, rekomandohet të pajisen me etiketën me simbolin e mësipërm dhe me shënimin me mbishkrimin në gjuhën frënge: “*Envois pour les aveugles*” dhe/ose në gjuhën angleze me mbishkrimin: “*Items for the blind*”;

e) cekogramet nuk mund të përmbajnë mbishkrime, objekte të korrespondencës, pullë postare, ndonjë formë parapagimi, të anuluar ose jo, ose ndonjë letër që përfaqëson një vlerë monetare, me përjashtim të rasteve kur objekti postar përfshin një kartolinë, zarf ose ambalazh që ka të printuar adresën e dërguesit të objektit ose përfaqësuesit të tij në shtetin e postimit apo të destinacionit të objektit, kthimi i të cilit është parapaguar.

10. Ngarkohet ofruesi i shërbimit universal postar për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I SHTETIT PËR INOVACIONIN DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE
Milena Harito

URDHËR
Nr. 47/1, datë 11.1.2018

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR ORGANIZIMIN, TË DREJTAT,
DETYRAT DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT MJEKËSOR TË CAKTIMIT TË
AFTËSISË PËR PUNË, PËR VLERËSIMIN E PERSONAVE ME AFTËSI TË
KUFIZUARA DHE KOMISIONIT MJEKËSOR TË PËRCAKTIMIT TË
VERBËRISË”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 4, pika 3, dhe nenit 7, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, të nenit 15, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, vendimit nr. 813, datë 29.12.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 618, datë 7.9.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”, vendimit nr. 671, datë 15.2.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Komisionit Mjekësor të Përcaktimit të Verbërisë”, vendimit nr. 505, datë 10.6.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për

organizimin, funksionimin dhe shpërblimin e Komisioneve Eprore të Caktimit të Aftësisë për Punë”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore “Për organizimin, të drejtat, detyrat dhe funksionimin e Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, për vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe Komisionit Mjekësor të Përcaktimit të Verbërisë”, bashkëngjitur këtij urdhri, si pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Shërbimi Social Shtetëror, institucionet e varësisë dhe institucionet shëndetësore të specializuara për zbatimin e këtij urdhri.

3. Rregullorja nr. 75, datë 11.1.2002, “Për organizimin, funksionimin, të drejtat dhe detyrat e Komisionit Mjekësor të Përcaktimit të Verbërisë”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

RREGULLORE

PËR ORGANIZIMIN, TË DREJTAT, DETYRAT DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT MJEKËSOR TË CAKTIMIT TË AFTËSISË PËR PUNË, PËR VLERËSIMIN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA DHE KOMISIONIT MJEKËSOR TË PËRCAKTIMIT TË VERBËRISË

I. Organizimi i Komisioneve Mjekësore të Vlerësimit të personave me aftësi të kufizuara

1. Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë, për vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara (më poshtë do të quhet KMCAP), është organ mjekësor dhe ligjor, që e mbështet veprimtarinë e tij në dispozitat ligjore të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 618, datë 7.9.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuara”, të ndryshuar. KMCAP e ushtron aktivitetin e tij pranë Shërbimit Social Shtetëror (SHSSH) dhe përgjigjet para SHSSH-së për aktivitetin që kryen.

2. KMCAP-i Rajonal ngrihet në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror (DRSHSSH). KMCAP-i Rajonal përbëhet nga pesë anëtarë. Anëtarë të komisioneve zgjidhen mjekë specialistë, që kanë njohuri shumë të mira në specialitetin e tyre dhe eksperiencë mbi 5-vjet. Mjeku i DRSHSSH-së është anëtar i KMCAP-it Rajonal.

Mbështetur në detyrimet që rrjedhin nga konventat e miratuara dhe detyrimi ligjor për një shërbim cilësor ndaj kësaj kategorie, KMCAP-et kanë në përbërje të tyre mjekë nga disa specialitete, në raport me prevalencën e diagnozave që shqyrtojnë.

Mbështetur në strukturën e personave me aftësi të kufizuara në qark, anëtarët e KMCAP-eve duhet të kenë këto specialitete: kardiolog dhe/ose internist (reumatolog, nefrolog, pneumofiziater, endokrinolog etj.), ortoped, pediatër, neurolog, psikiatër dhe okulist.

Numri, llojet e specialiteteve dhe anëtarët e KMCAP-it caktohen nga Shërbimi Social Shtetëror dhe miratohen nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. KMCAP-i Rajonal e fillon aktivitetin e tij pas miratimit nga SHSSH-ja.

Çdo ndryshim në KMCAP-in Rajonal, lidhur me llojin e specialitetit dhe numrin e specialistëve bëhet pas propozimit nga Shërbimi Social Shtetëror. Përbërja e KMCAP-eve rinovohet me rotacion çdo vit me urdhër të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

3. Komisioni Mjekësor i Përcaktimit të Verbërisë (më poshtë do të quhet KMPV) ngrihet dhe funksionon pranë Shërbimit Social Shtetëror, si dhe përgjigjet përpara tij për aktivitetin që kryen. Ky komision përbëhet nga 5 anëtarë (kryetari dhe 4 anëtarë), tre nga anëtarët e të cilit duhet të jenë mjekë okulistë me përvojë në këtë specialitet, të cilët miratohen nga Shërbimi Social Shtetëror. Njëri nga

anëtarët është mjek pranë Shërbimit Social Shtetëror, një anëtar është përfaqësues i Shoqatës së të Verbërve. Përbërja e KMPV-së rinovohet me rotacion çdo vit me urdhër të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

4. KMCAP-et Eprorë të specializuara ngrihen dhe funksionojnë në Drejtorinë e Përgjithshme të SHSSH-së. Numri, llojet e specialiteteve dhe anëtarët e komisioneve (mjekë specialistë me grada shkencore), caktohen nga VKM-ja nr. 505, datë. 10.6.2015, “Për organizimin, funksionimin dhe shpërbëimin e Komisioneve Eprorë të Përcaktimit të Aftësisë për Punë”.

5. Për të shqyrtuar dokumentacionin e personave që kërkojnë të përfitojnë pagesë të aftësisë së kufizuar, KMCAP-et Rajonale dhe KMPV-ja mbledhen jo më pak se tri herë në muaj, ndërsa KMCAP-et Eprorë (të shëndetit mendor, sëmundjeve të përgjithshme, statusi paratetraplegjik, verbërisë) jo më pak se një herë në muaj. Për këtë qëllim, anëtarët e KMCAP-ve, për ditët që janë në komisione, lirohen nga detyra e përditshme dhe punojnë pranë organeve të Shërbimit Social Shtetëror.

Relatorët e KMCAP-eve Eprorë (të shëndetit mendor, sëmundjeve të përgjithshme, statusit paratetraplegjik, verbërisë) aktivizohen me ekipe kontrolli sipas problematikave që shfaqen.

Relatorëve të KMCAP-eve Eprorë dhe mjekëve të DRSHSSH (u mundësohen kualifikime për ngritje profesionale të vazhdueshme).

II. Të drejtat dhe detyrat e KMCAP-eve

Anëtarët e KMCAP-eve kanë për detyrë të njohin legjislacionin në fuqi, kriteret mjekësore për vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara, si dhe t'i zbatojnë ato drejt, saktë e me përgjegjësi profesionale.

Gjatë zhvillimit të seancës, anëtarët e KMCAP-eve studiojnë praktikën me dokumentacionin e plotësuar sipas rregullores për caktimin, administrimin dhe pagesat e aftësisë së kufizuar, gjykojnë nëse plotësohen ose jo kushtet ligjore për përfitim, marrin të dhëna për ecurinë e sëmundjes dhe kohën e fillimit të trajtimit dhe në bazë të këtyre të dhënave marrin vendim mbi:

Grupin e përfitimit (i) grupi i parë, në të cilën vlerësohen personat me aftësi të kufizuara që kanë nevojë për përkujdesje, (ii) grupi i dytë, në të cilën vlerësohen personat me aftësi të kufizuara, që nuk kanë nevojë për përkujdesje, si dhe afatet e përfitimit për secilin grup.

Përveç grupit të përfitimit përcaktohet nevoja për paketën higjieno-sanitare, sipas përcaktimeve në VKM-në nr. 78, datë 7.2.2007, “Për masën, kriteret dhe procedurat e përfitimit të një paketë të veçantë higjieno-sanitare, për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni dërgohet pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror në përfundim të vlerësimit, me qëllim që DRSHSSH-ja, për personat aplikues, të hedh këtë dokumentacion brenda 10 ditëve nga data e vlerësimit/rivlerësimit në arkivin elektronik. Dosja e përfituesit, e shoqëruar me njoftimin për vendimin, përcillet nga DRSHSSH-së pranë njësisë administrative.

II/1. Të drejtat dhe detyrat e veçanta të KMCAP-eve Rajonale

- Cakton drejt dhe në përputhje me dokumentacionin shëndetësor të aplikantëve, si dhe në mbështetje të kriterëve mjekësorë, përfitimin e pagesave të aftësisë së kufizuar.

- Vlerëson shkaktun e aftësisë së kufizuar nga sëmundje e përgjithshme, sëmundje të shëndetit mendor, përfitimet nga statusi paratetraplegjik, kohën e fillimit të pagesës, periudhën e përfitimit, si edhe afatin e rivlerësimit.

- Propozon drejtimit për riaftësimin profesional të personit me aftësi të kufizuara.

- Kryen studime mbi gjendjen dhe ecurinë, si edhe problematikën e aftësisë së kufizuar në qark.

II/2. Të drejtat dhe detyrat e veçanta të KMPV-së

- Anëtarët e KMPV-së kanë për detyrë të njohin legjislacionin në fuqi, kriteret mjekësore për përfitimet e statusit të të verbrit dhe t'i zbatojnë ato sa më drejt.

- Anëtarët e KMPV-së para zhvillimit të seancës së komisionimit, studiojnë dosjet e aplikuesve për përfitimin e statusit të të verbrit dhe marrin vendim nëse përfitojnë apo jo nga ligji 8098, datë 23.8.1996, “Për statusin e të verbrit”, përcaktojnë shkaktun e dëmtimit të shikimit, shkallën e humbjes së tij dhe nëse ka mundësi riaftësimi edhe mënyrën që duhet ndjekur për riaftësim.

- Caktojnë grupin e përfitimit nga ky status: (i) grupi i parë, në të cilën vlerësohen personat e verbër që kanë nevojë për përkujdesje, (ii) grupi i dytë, në të cilën vlerësohen personat e verbër që nuk kanë nevojë për përkujdesje, si dhe afatet e përfitimit për çdo grup.

- Kryejnë studime mbi gjendjen dhe ecurinë e përfituesve nga statusi i të verbrit dhe përcaktojnë drejtimit dhe rrugët e përmirësimit të treguesve, si dhe përsosin vazhdimisht kriteret mjekësore për përfitimin e këtij statusi.

- Dërgojnë menjëherë dokumentacionin pranë Drejtorisë së Komisionimit të Aftësisë së Kufizuar në Shërbimin Social Shtetëror, në përfundim të vlerësimit/rivlerësimit të verbërisë, për hedhjen e tij brenda 30 ditëve nga data e vlerësimit/rivlerësimit në arkivin elektronik. Dosja e përfituesit, e shoqëruar me njoftimin për vendimin, përcillet nga DRSHTSH-ja pranë njësisë administrative.

II/3. Të drejta dhe detyra të veçanta të KMCAP-eve Eprorë të specializuara

- Shqyrton dhe zgjidh kërkesat e personave me aftësi të kufizuara, që apelojnë vendimet e KMCAP-eve Rajonale, si edhe shqyrton dhe zgjidh rastet e dërguara me divergjencë nga KMCAP-et Rajonale.

- Studion praktikën e dërguara nga Kontrolli i Shërbimit Social Shtetëror, merr masa për plotësimin e tyre, thërret dhe viziton rastin në mbledhjen e radhës dhe, në varësi të problematikave të konstatuara dhe gjendjes shëndetësore, merr vendim për vlerësimin e aftësisë së kufizuar. Relatorët e KMCAP-eve krijojnë grupe kontrolli, të cilat kontrollojnë aktivitetin e KMCAP-eve Rajonale dhe bën vlerësime mbi punën e kryer. Kur evidenton shkelje të dispozitave ligjore, akteve nënligjore, si edhe të kriterëve mjekësorë orientues për caktimin e përfitimit të pagesave të aftësisë së kufizuar, mban akt konstatimi për gjetjet dhe merr masa në zbatim të ligjit.

- Sipas natyrës dhe rëndësisë së shkeljeve urdhëron KMCAP-in Rajonal që të rivlerësojë përfituesit dhe të rregullojë vendimet, ku caktimi i pagesës së aftësisë së kufizuar ka qenë i kundërligjshëm ose organizon vetë në rajon apo në SHSSH, një seancë të veçantë për rikontrollin e tyre. Në këto raste, KMCAP-i, për çdo individ që do të rivlerësojë, merr vendim të ri për vlerësimin e aftësisë së kufizuar.

- Kryen studime mbi gjendjen dhe ecurinë e sëmundshmërisë dhe cakton drejtimit dhe rrugët për përmirësimin e treguesve.

III. Rregullat e drejtimit, mënyra e shqyrtimit dhe marrja e vendimit në KMCAP, KMPV dhe KMCAP-in Epror.

III/1. Rregullat e drejtimit, mënyra e shqyrtimit dhe marrja e vendimit në Komisionet Mjekësore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar (KMCAP).

1. Personat që pretendojnë të përfitojnë pagesë të aftësisë së kufizuar janë vetëm personat që plotësojnë kushtet sipas ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, VKM-së nr. 618, datë 7.9.2006, "Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuara", të ndryshuar me VKM-në nr. 813, datë 29.12.2017. Drejtimi për në KMCAP përfshin:

a) "Fletëdrejtimin për në KMCAP" si dokumenti kryesor mjekësor, që pasqyron gjendjen shëndetësore dhe që jep të drejtën për t'u drejtuar në organet e Shërbimit Social Shtetëror, për efekt përfitimi sipas ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar. Ky dokument plotësohet saktë, qartë dhe me përgjegjësi nga mjeku kurues, duke iu përgjigjur plotësisht rubrikave që ka formati dhe duke shënuar ID-në e personit. Në përfundim, ky dokument nënshkruhet me emrin e mbiemrin e mjekut kurues, shefit të pavijonit apo klinikës, shefit të shërbimit dhe drejtuesit të institucionit.

b) Nga institucionet mjekësore të specializuara me shtretër (spitali), kur dokumentacioni i të sëmurit drejtohet në KMCAP-i për herë të parë, përmban "Fletëdrejtimin për në KMCAP". Pajisja ose jo me këtë dokument vendoset në vizitën e përgjithshme ose në konferencën klinike të drejtuar nga shefi i klinikës ose shefi i shërbimit. Vendimi i marrë duhet të pasqyrohet edhe në kartelën klinike e të firmoset nga mjeku kurues, shefi i pavijonit apo shefi i klinikës dhe, në mungesë të tij, shefi i shërbimit.

c) Nga Komisionet Mjekësore (KM), kur i sëmuri paraqitet për herë të parë në KMCAP dhe vuan nga sëmundje të syve, kirurgjikale, ortopedike, gjendje pas djegies dhe shëndetit mendor (raste që nuk

përbëjnë trajtim në institucione me shtretër). Në këto raste lëshohet “Fletëdrejtimi për në KMCAP”, që plotësohet saktë, qartë dhe me përgjegjësi, duke përmbushur të gjitha kërkesat e formatit dhe të shënohet ID-ja e personit. Në të gjitha rastet, fleta e drejtimit të plotësohet në formë elektronike.

Kur personi pretendon për gjendje shëndetësore të rënduar, lëshohet “Fletëdrejtimi për në KMCAP” nga institucionet shëndetësore të specializuara ose Komisionet Mjekësore, të cilat dërgojnë dokumentacionin zyrtarisht për komisionim.

Nga specialistët, konsultat ose spitali, kur rivlerësohet dokumentacioni i të sëmurit, duke lëshuar “Epikrizë përcjellëse”, që plotësohet saktë, qartë dhe me përgjegjësi, duke evidentuar gjendjen shëndetësore të personit me aftësi të kufizuara nga vlerësimi i fundit deri në rivlerësimin e radhës.

Fleta e drejtimit për në KMCAP dhe Epikriza përcjellëse shoqërohen me analiza dhe ekzaminime, me përgjigje zyrtare të interpretuara nga mjeku specialist, që janë të domosdoshme, për evidentimin e plotë të gjendjes shëndetësore të individit.

2. Dokumentacioni për vlerësimin e aftësisë së kufizuar përfshin fletën e drejtimit për në KMCAP të lëshuar nga institucioni shëndetësor i specializuar me shtretër (spitali).

Dokumentacioni për rivlerësimin e aftësisë së kufizuar përfshin epikrizën në bazë të rekomandimit të mjekut të familjes.

Dokumentacioni për vlerësimin/rivlerësimin e aftësisë së kufizuar, së bashku me kopje të dokumentit të identifikimit, dërgohet brenda 5 ditëve nga institucioni shëndetësor, pranë njësisë administrative ku individi ka vendbanimin.

Kur dosja vlerësohet për herë të parë, fleta e drejtimit për në KMCAP shoqërohet me analiza dhe ekzaminime, me përgjigje zyrtare të interpretuara nga mjeku specialist, që janë të domosdoshme për evidentimin e plotë të gjendjes shëndetësore të individit.

Kur dosja rivlerësohet, Epikriza përcjellëse shoqërohet me analiza dhe ekzaminime shtesë, me përgjigje zyrtare të interpretuara nga mjeku specialist, që janë të domosdoshme për evidentimin e plotë të gjendjes shëndetësore të individit.

3. Mjeku i DRSHSSH-së merr me procesverbal nga protokoli i Drejtorisë Rajonale praktikën e kompletuar të dosjeve që vlerësohen për herë të parë, bën verifikimet e nevojshme të dokumentacionit mjekësor, dhe brenda 30 ditëve KMCAP-i shqyrton dosjen.

Në rivlerësimin e dosjeve, mjeku i DRSHSSH-së merr me procesverbal nga administratori shoqëror dokumentacionin e plotë ekzistues, si dhe Epikrizën përcjellëse, e cila shoqërohet me analiza dhe ekzaminime, me përgjigje zyrtare të interpretuara nga mjeku specialist, që janë të domosdoshme për evidentimin e plotë të gjendjes shëndetësore të tij.

Mjeku i DRSHSSH-së, kur konstaton se dosja e paraqitur nuk është subjekt i përfitimit nga ligji nr. 9355, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar, por mund të jetë objekt përfitimi nga skema e sigurimeve shoqërore, në bazë të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në RSH”, të ndryshuar, dërgon zyrtarisht dosjen pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore.

4. Caktimi i pagesës për aftësinë e kufizuar bëhet nga KMCAP-i Rajonal, për periudhën e përfitimit, mbështetur në kriteret diagnostike të miratuara për çdo diagnozë.

5. Rivlerësimi i dosjes në KMCAP bëhet në varësi të gjendjes shëndetësore dhe gjithmonë dy muaj para përfundimit të afatit që është vendosur në vendimin e fundit.

Dosjet e personave me aftësi të kufizuara që nuk paraqesin dokumentacionin për rivlerësim në KMCAP në datën e rivlerësimit, ruajnë të drejtën e rishqyrtimit gjatë periudhës tremujore në vazhdim. Kur dokumentacioni paraqitet brenda kësaj periudhe, e drejta e përfitimit ruhet edhe për periudhën e prapambetur.

Kur dokumentacioni për rivlerësim nuk paraqitet në KMCAP edhe gjatë kësaj periudhe, KMCAP-i, në mbështetje të VKM-së nr. 618, datë 7.9.2006, “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuara”, të ndryshuar me VKM-në nr. 813, datë 29.12.2017, dosja konsiderohet e mbyllur dhe praktika duhet të nisë si procedurë vlerësimi për herë të parë.

6. Vlerësimi/rivlerësimi i dosjeve të personave pretendues për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar bëhet në zbatim të kriterëve mjekësorë dhe diagnostike, periudhës së riaftësimit, për të cilët

afatet e rivlerësimit mund të shtrihen në afate sipas kriterëve mjekësorë (1, 3, 5 vjet dhe përgjithmonë).

Personat me aftësi të kufizuara që me vendim të KMCAP-it shpallen përfitues për t'u integruar nëpërmjet punësimit, gëzojnë të drejtën e përfitimit për 48 muaj, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar.

III/2 Rregullat e drejtimit, mënyra e shqyrtimit dhe marrja e vendimit në Komisionin Mjekësor të Përcaktimit të Verbërisë (KMPV)

Personat që pretendojnë të përfitojnë statusin e të verbrit janë vetëm personat që plotësojnë kushtet sipas ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit" dhe aktet nënligjore në fuqi. Drejtimi për në KMPV përfshin:

1. "Fletëdrejtimin për KMPV", si dokumenti kryesor mjekësor, pasqyron gjendjen shëndetësore dhe jep të drejtën për t'u drejtuar në KMPV, për përfitimin e statusit të të verbrit. Pajisja e aplikuesit me këtë dokument bëhet nga Komisionet Mjeko-Ligjore (KML), të specializuara pranë vendbanimit të individit. Fletëdrejtimi plotësohet saktë, qartë dhe me përgjegjësi, duke iu përgjigjur plotësisht rubrikave që ka formati dhe në të shënohet ID-ja e personit. Në përfundim, ky dokument nënshkruhet me emrin e mbiemrin e të gjithë anëtarëve të KML-së dhe vuloset nga institucioni që e lëshon.

2. Kur personi pretendon për gjendje shëndetësore të rënduar, lëshohet "Fletëdrejtimi për në KMPV" nga Komisionet Mjeko-Ligjore.

3. Kur dokumentacioni rivlerësohet ai përfshin "Epikrizën përcjellëse", që plotësohet saktë, qartë dhe me përgjegjësi, nga mjeku okulist pranë rrethit ku banon, duke evidentuar gjendjen shëndetësore të personit të verbër nga vlerësimi i fundit deri në rivlerësimin e radhës.

4. Personat që kërkojnë të vlerësohet/rivlerësohet dokumentacioni për përfitimin e statusit të të verbrit ndjekin sistemin shëndetësor të referimit. Dokumentacioni për vlerësimin/ rivlerësimin e verbërisë së bashku me kopje të dokumentit të identifikimit dërgohet brenda 5 ditëve nga institucioni shëndetësor, pranë njësisë administrative ku individi ka vendbanimin.

5. Mjeku pranë SHSSH-së merr me procesverbal nga protokoll praktikën e kompletuar të dosjeve që vlerësohen për herë të parë, bën verifikimet e nevojshme të dokumentacionit mjekësor dhe brenda 30 ditëve KMPV-ja shqyrton dosjen.

Në rivlerësimin e dosjeve, mjeku i SHSSH-së merr zyrtarisht nga administratori shoqëror dokumentacionin e plotë ekzistues, si dhe epikrizën.

6. Rivlerësimi i dosjes në KMPV bëhet në varësi të gjendjes shëndetësore dhe gjithmonë dy muaj para përfundimit të afatit që është vendosur në vendimin e fundit.

Dosjet e personave që nuk përmbajnë dokumentacionin e kërkuar për rivlerësim në KMPV në datën e rivlerësimit, ruajnë të drejtën e rishqyrtimit gjatë periudhës tremujore në vazhdim. Kur dokumentacioni paraqitet brenda kësaj periudhe, e drejta e përfitimit ruhet edhe për periudhën e prapambetur.

Kur dokumentacioni për rivlerësim nuk paraqitet në KMPV edhe gjatë kësaj periudhe, dosja konsiderohet e mbyllur dhe praktika duhet të nisë si procedurë vlerësimi për herë të parë.

7. Vlerësimi/Rivlerësimi i dosjeve të personave pretendues për përfitimin e statusit të verbërisë bëhet në bazë të nivelit të shkallës së pamjes dhe mundësisë për riaftësim.

Për rastet kur kemi një humbje të plotë të aftësisë për shikim nga shkaqe të ndryshme, trajtimi i të cilave nuk jep rezultat dhe konsiderohen të pakorrigjueshme, ato përcaktohen me afat të përhershëm. Për të gjitha rastet e tjera, kur ekziston mundësia e korigjimit dhe eliminimi i shkakut që kanë sjellë uljen apo humbjen e shikimit, koha për rivlerësim përcaktohet nga KMPV-ja dhe afatet kohore mund të shtrihen nga 1, 3 e deri në 5 vjet. Në këto raste rekomandohet edhe mënyra e trajtimit të tyre, kur është e mundur dhe ka rezultat.

III/3 Rregullat e drejtimit, mënyra e shqyrtimit dhe marrja e vendimit në KMCAP-in Epror

1. Kundër vendimit të KMCAP-it Rajonal/KMPV, personi apelon në KMCAP-in Epror të specializuar. Kërkesa është e vlefshme kur ajo bëhet brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njofimit për vendimin e marrë nga KMCAP-i Rajonal. Ankesa bëhet me shkrim pranë administratorit

shoqëror, i cili dokumenton marrjen e njofimit në një regjistër të veçantë dhe ky i fundit e dorëzon pranë Drejtorisë Rajonale së bashku me dosjen e personit. Brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës, DRSHSSH-ja dërgon në SHSSH dosjen e të sëmurit së bashku me një relacion të hollësishëm, ku argumentohet vendimi i marrë nga KMCAP-i Rajonal.

2. Në KMCAP-in Epror i sëmurë ose kërkuar paraqitet vetëm në datën e kontrollit, që caktohet nga mjeku i Shërbimit Social Shtetëror, si edhe në datën e rikontrollit, që caktohet nga vendimi i KMCAP-it gjatë komisionimit të fundit.

3. Kur për arsye të gjendjes shëndetësore të rëndë, përfituesi nuk mund të paraqitet në KMCAP-in Epror në datën e caktuar, atëherë komisionimi i tij bëhet në banesë ose në spitalin ku ndodhet i shtruar. Në këto raste, të afërmit duhet të njoftojnë KMCAP-in Epror 15 ditë para datës së paraqitjes në komision, me anë të dokumentit të lëshuar nga mjeku kurues (epikrizë përcjellëse), e cila evidenton gjendjen e rënduar, duke argumentuar edhe arsyen e pamundësisë së paraqitjes në KMCAP-in Epror.

4. KMCAP-i Epror i specializuar detyrohet të komisionojë apeluesit brenda periudhës dymujore nga data e paraqitjes së dokumenteve në Drejtorinë e Përgjithshme të SHSSH-së. Kur apeluesit nuk paraqiten në këto komisione dy herë radhazi dhe refuzojnë të kryejnë ekzaminimet e kërkuara/mjekimin e rekomanduar, KMCAP-i Epror merr vendim pa përfitim të pagesës dhe dosja i kthehet DRSHSSH-së përkatëse. Në këtë rast, dosja konsiderohet e mbyllur dhe për rihapjen e saj do të ndiqet procedura si për rastet që paraqiten në KMCAP për herë të parë. Të gjitha rastet e rrëzuara nga ana e KMCAP-it Epror për të njëjtin status mjeko-ligjor nuk i nënshtrohen procesit të rivlerësimit.

III/4 Vendimmarrja

1. Vendimi është dokumenti bazë juridik-mjekësor-administrativ që njeh të drejtën për përfitime nga ligji nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar, VKM-ja nr. 618, datë 7.9.2006, “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”, e ndryshuar me VKM-në nr. 813, datë 29.12.2017, ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar.

2. Vendimi plotësohet saktë, qartë me përgjegjësi sipas kërkesave të formatit, me shkrim të lexueshëm, pa korrigjime, vërtetohet me emrin dhe mbiemrin e anëtarëve të KMCAP-it, nënshkrimin e tyre, si dhe vuloset me vulën e komisionit.

3. Vendimi ka fuqi ligjore ekzekutive kur është i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e KMCAP-it. Në rastet kur ndërmjet anëtarëve të komisionit ka mendime të ndryshme, vendimi merret me divergjencë dhe anëtari që nuk është dakord me të tjerët, argumenton vendimin me arsyet e divergjencës.

Në këto raste, vendimi mbetet pezull dhe së bashku me dosjen dërgohet zyrtarisht në KMCAP-in Epror të specializuar.

4. Kur anëtarët e KMCAP-it Epror të specializuar kanë mendime të kundërta, vendimi merr formën e prerë me shumicë votash.

5. Vendimi i KMCAP-it Epror të specializuar ka formë të prerë. Ai nuk mund të ndryshohet nga KMCAP-i Rajonal. Në ato raste kur KMCAP Rajonal gjykon se kërkuar paraqet gjendje shëndetësore të rënduar dhe bën objekt për të ndryshuar kushtet e përfitimit, ai merr vendim duke argumentuar edhe arsyen e këtij ndryshimi. Në këto raste, pavarësisht vendimit të KMCAP-it Rajonal, vendimi do të marrë formë të prerë vetëm pas miratimit të KMCAP-it Epror të specializuar.

IV. ADMINISTRIMI I DOKUMENTEVE

1. Dosja me dokumentacionin e plotë të personit me aftësi të kufizuar sistemohet në praktikën e tij të veçantë, mbahet dhe ruhet në njësinë administrative/bashkinë ku ka vendbanimin individ.

2. Mjeku mban regjistrin e personave me aftësi të kufizuara, ku evidentohej të gjitha të dhënat lidhur me vendimin e KMCAP-it, ID-në, emër, mbiemër, afatin e përfitimit, diagnozën, grupin e përfitimit dhe vendbanimin. Vendimi në çdo rast plotësohet gjatë mbledhjes së KMCAP-it.

Krahas plotësimit të vendimit, KMCAP-i plotëson edhe vërtetimin, i cili përmban shkurtimisht të dhënat kryesore të vendimit.

3. Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, në përfundim të vlerësimit të aftësisë së

kufizuar, për personat aplikues, hedhin brenda 10 ditëve nga data e vlerësimit/rivlerësimit në arkivin elektronik, dokumentacionin që përmban dosja e përfituesit dhe e dërgojnë atë pranë njësisë administrative të shoqëruar me njoftimin për vendimin për çdo person.

4. Drejtoria e Komisionit të Aftësisë së Kufizuar në Shërbimin Social Shtetëror, në përfundim të vlerësimit të verbërisë për personat aplikues, hedh brenda 30 ditëve nga data e vlerësimit/rivlerësimit në arkivin elektronik dokumentacionin që përmban dosja e përfituesit dhe e dërgojnë atë pranë njësisë administrative të shoqëruar me njoftimin për vendimin për çdo person.

5. Personeli mjekësor, anëtarët e Komisionit Mjekësor, si edhe anëtarët e KMCAP-it/KMPV-së që me veprimet e tyre dëmtojnë fondet e buxhetit të shtetit, mbajnë përgjegjësi disiplinore, përgjegjësi materiale, përgjegjësi penale.

Anëtarët e KMCAP-eve, që në veprimtarinë e tyre veprojnë në kundërshtim me normat e caktuara dhe dëmtojnë fondet e buxhetit të shtetit, dënohen me gjobë sipas legjislacionit në fuqi.

Kundër vendimit të gjobës bëhet ankim brenda 30 ditëve nga data e njoftimit, pranë Komisionit të Apelimit, i cili ngrihet nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror, i cili lë në fuqi, anulon ose ndryshon masën e gjobës.

6. Kontrolli i zbatimit të kësaj rregulloreje realizohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror.

LIGJ **Nr.8626, datë 22.6.2000**

STATUSI I INVALIDIT PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK *(Ndryshuar me ligjin nr. 9506, datë 3.4.2006; me ligjin nr. 27/2012, datë 15.3.2012)* *(i përditësuar)*

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI **I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Neni 1

Nga ky ligj përfitojnë të gjithë invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, pavarësisht nga mosha, koha, vendndodhja e aksidentit dhe çasti i sigurimit.

Neni 2

Në kuptimin e këtij ligji:

1. “Paraplegjik” nënkupton çdo person që vuan nga paraliza e dy anësive të poshtme si pasojë e dëmtimit të palcës kurrizore nga shkaqe të ndryshme.

2. “Tetraplegjik” nënkupton çdo person, që vuan nga paraliza e katër anësive si pasojë e dëmtimit të palcës kurrizore nga shkaqe të ndryshme dhe i klasifikuar si i tillë me vendimin e Komisionit Mjekësor të Aktësive për Punë.

Neni 3

Shteti krijon kushte për të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, që ata të marrin pjesë në jetën shoqërore njëloj si të tjerët, duke siguruar për ta një nivel ekonomik të nevojshëm për të

jetuar në mënyrë dinjitoze, kushte banimi, jetesë e punë të përshtatshme, si dhe u krijon mundësi normale për kurim, arsimim, veprimtari çlodhëse, argëtuese dhe sportive.

Ministria e Shëndetësisë parashikon çdo vit në buxhetin e shpenzimeve të saj fondet e nevojshme për kontrole periodike vjetore nga mjekë të specializuar për të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Neni 4

Shteti mbron të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë nga të gjithë llojet e shfrytëzimit, të diskriminimit, të abuzimit dhe të fyerjes.

Neni 5

Të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë pajisen me dëshmi zyrtare identifikimi.

Kriteret e dhënies së dëshmisë dhe forma e saj përcaktohen me rregullore të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe të Administratës së Përgjithshme të Ndihmës dhe të Shërbimeve Sociale.

Neni 6

Të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë përjashtohen nga taksat e drejtpërdrejta. Në rastet kur ata vetëpunësohen si persona fizikë dhe janë subjekte të tatimit mbi biznesin e vogël, kuota e tatimit fiks është sa gjysma e asaj të përcaktuar në nenin 3 të ligjit nr.8313, datë 26.3.1998 “Për tatimin mbi biznesin e vogël”.

Neni 7

Personat juridikë, shtetërorë ose privatë që punësojnë të sëmurë paraplegjikë dhe tetraplegjikë, përveç kriteve të përcaktuara në ligjin nr.7955, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, përfitojnë për çdo vit kalendarik ulje tatimi mbi fitimin, të barabartë në përqindjen e fuqisë punëtore të invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Ministria e Financave nxjerr aktet nënligjore përkatëse në bazë të këtij ligji.

Neni 8

Shteti favorizon arsimimin e të sëmurëve paraplegjikë në shkollat e larta të sistemit shtetëror. Këshilli i Ministrave merr masa dhe përcakton fonde për ngritjen e shkollave dhe të institucioneve për arsimimin, edukimin dhe rehabilitimin e invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Neni 9

(ndryshuar me ligjin nr. 9506, datë 3.4.2006)

Shteti përjashton të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë nga pagesat për kontributet shëndetësore dhe u jep të drejtën e përfitimit falas të barnave, të mbuluara nga skema e sigurimeve të kujdesit shëndetësor.

Paraplegjikët dhe tetraplegjikët, të cilët kanë përfituar statusin, përfitojnë një shtesë në të ardhura për mbulimin e shpenzimeve të paketës së domosdoshme me materiale të veçanta higjieno-sanitare. Masa, kriteret dhe procedura e përfitimit të kësaj shtese në të ardhura përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 10

Të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë që janë në gjendje të rëndë dhe në pamundësi për t'u paraqitur në institucionet shtetërore, përfitojnë shërbimin në banesë nga mjeku i familjes dhe

mjeku specialist për ato procedura mjekësore që mund të kryhen në mënyrë ambulatorë dhe në kushte shtëpie. Ministria e Shëndetësisë nxjerr aktet nënligjore përkatëse për këtë qëllim.

Neni 11

(ndryshuar me ligjin nr. 27/2012, datë 15.3.2012)

Të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe shoqëruesit e tyre përfitojnë kompensim për shërbimin e transportit. Masa, kriteret dhe procedurat e këtij përfitimi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 12

(ndryshuar me ligjin nr. 27/2012, datë 15.3.2012)

Të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të cilët kanë përfituar statusin, përfitojnë kompensim të faturës së energjisë elektrike dhe të faturës së telefonisë fikse. Masa, kriteret dhe procedura e përfitimit të këtij kompensimi financiar përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave .

Neni 13

Shteti financo veprimtaritë e organizuara nga shoqatat e invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë sipas burimeve financiare të planifikuara për këtë qëllim në buxhetin e shtetit.

Neni 14

Shteti merr përsipër të vërë në dispozicion dhe të japë falas mjedise për zhvillimin e veprimtarisë së shoqatës të invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Neni 15

Invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, pavarësisht nga të ardhurat që përfitojnë nga shteti, marrin një shtesë në të holla për shkak të paralizës së tyre, në masën e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave. Kjo shtesë nuk llogaritet në të ardhurat familjare për efekte të nivelit ekonomik. Invalidët kanë të drejtë për një pagesë, po në këtë masë, për kujdestarin e tyre, të zgjedhur sipas procedurave ligjore.

Neni 16

Administrata e Përgjithshme e Ndihmës dhe e Shërbimeve Sociale administron mjetet e përshtatura për të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Kriteret përcaktohen me rregullore nga Administrata e Përgjithshme e Ndihmës dhe e Shërbimeve Sociale.

Personat e sëmurë paraplegjikë dhe tetraplegjikë përjashtohen nga taksat doganore për mjete, të cilat ndihmojnë në integrimin e tyre në jetë, përfshirë këtu dhe autovetura të përshtatura për përdorim prej tyre.

Neni 17

Shteti merr përsipër trajtimin me përparësi me strehim, nëpërmjet kredive të dhëna me kushte lehtësuese për të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Neni 18

(shfuqizuar me ligjin nr. 27/2012, datë 15.3.2012)

Neni 19

Ministria e Shëndetësisë merr masa që në spitalet e nivelit të dytë dhe të tretë të përshtaten dhe të pajisen një deri dy dhoma për shtrimin eventual të të sëmurëve paraplegjikë dhe tetraplegjik.

Neni 20

Në vende publike (aeroporte, stacione treni, stadione, hotele etj.) krijohen mjedise për lëvizjen, qëndrimin dhe shërbimin për të sëmurët paraplegjikë sipas ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Statusi i invalidit”.

Neni 21

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda tre muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore në zbatim të neneve 6, 9, 11, 12, 13, 14, 16, 17 dhe 19 të këtij ligji.

Neni 22

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2670, datë 04.07.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

VENDIM

Nr.31, datë 20.1.2001

PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I INVALIDIT PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK

*(Ndryshuar me VKM nr. 302, datë 27.6.2002; nr. 619, datë 7.9.2006; nr. 871, datë 18.6.2008;
nr. 1689, datë 17.12.2008; nr. 326, datë 12.3.2009; nr. 1236, datë 16.12.2009; nr. 604,
datë 23.7.2010; nr. 37, datë 19.1.2011)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 21 të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000, “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP) në rreth shqyrton të gjitha kërkesat e paraqitura nga personat e bërë paraplegjikë apo tetraplegjikë, për shkaqe që lidhen me punësimin, të cilët përfitojnë nga ligji nr.8626, datë 22.6.2000.

Komisioni vendos edhe shkallën e invaliditetit, sipas ndarjes që vijon:

I. Grupi i parë, ku përfshihen:

a) të sëmurët tetraplegjikë, që kanë humbur mbi 55 për qind të aftësisë për punë, që nuk kanë mundësi fizike për të vetëshërbyer e që kanë nevojë për kujdestar.

b) të sëmurët paraplegjikë, që kanë humbur mbi 55 për qind të aftësisë për punë, që nuk kanë mundësi fizike për të vetëshërbyer e që kanë nevojë për kujdestar.

II. Grupi i dytë, ku përfshihen të sëmurët paraplegjikë pjesërisht të aftë për punë të përzgjedhur, që janë në gjendje për të vetëshërbyer.

2. KMCAP-ja i lëshon të interesuarit raportin mjekësor, duke përcaktuar shkallën e paaftësisë dhe nevojën për kujdestar. Invalidi, paraplegjik ose tetraplegjik, duhet të deklarojë para administratorit shtetëror emrin e kujdestarit i cili shënohet në një regjistër të veçantë. Ndërrimi i kujdestarit mund të bëhet sa herë që invalidi, paraplegjik ose tetraplegjik, e sheh të arsyeshme, por është i detyruar të njoftojë menjëherë KMCAP-në.

3. Invalidët, paraplegjikë ose tetraplegjikë, pajisen me dëshmi zyrtare identifikimi.

4. Masa e përfitimit për invalidët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë, është 8 700 (tetë mijë e shtatë qind) lekë në muaj dhe kjo masë indeksobet, me indeksin e çmimeve të konsumit. Kjo pagesë përfitohet pavarësisht nga mosha dhe të ardhurat, që përfitojnë nga shteti. Kujdestari i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, i caktuar në përputhje me pikën 1 të këtij vendimi, përfiton një pagesë, në masën 9200 (nëntë mijë e dyqind) lekë në muaj.⁴

Pagesa e aftësisë së kufizuar në masën e përcaktuar në paragrafin e parë të kësaj pike, paguhet nga shërbimet bankare ose Posta Shqiptare, pranë njësive të qeverisjes vendore ku ka vendbanimin përfituesi.

4/1. Periudha e shërbimit si kujdestar, për invalidin paraplegjik dhe tetraplegjik, i cili nuk është ekonomikisht aktiv, si dhe nuk përfiton të ardhura nga skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror, vlerësohet periudhë siguri, për efekt përfitimi pensioni, barrëllindje, aksidenti në punë dhe sëmundje profesionale, dhe siguri shëndetësor.

Kontributi paguhet në bazë të pagës minimale, për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimit të detyrueshëm shoqëror, dhe përballohet nga Buxheti i Shtetit.

4/2. Shërbimi Social Shtetëror, mbështetur në informacionin e dërguar nga njësitë e qeverisjes vendore, barton listat e kujdestarëve përfitues, çdo vit dhe sa herë ndryshon kjo listë, në bazë të të cilave përlogariten fondet, që nevojiten për pagesën e kontributit për këtë kategori personash. Procedurat për zbatimin e kësaj pike përcaktohen në udhëzimin e përbashkët të Ministrisë të Financave dhe Ministrisë të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

5. Efektet financiare për këto pagesa të përballohen brenda fondeve të dhëna për vitin 2001, Administratës së Përgjithshme të Ndihmës dhe Shërbimeve Sociale, në zërin “Përfitim paaftësie”.

6. Personat që do të fitojnë statusin e invalidit, paraplegjik ose tetraplegjik, para datës 30 qershor 2001, do ta përfitojnë këtë pagesë, në zbatim të pikës 4 të këtij vendimi, që nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000, “Statusi i invalidit, paraplegjik ose tetraplegjik.”

Të gjithë personat e tjerë që do ta fitojnë këtë status pas datës 30 qershor 2001, do ta përfitojnë këtë pagesë një muaj pas daljes në KMCAP.

7. Për çdo shpërdorim, personit përgjegjës i merret dëshmia për një periudhë deri në 3 vjet dhe, sipas rastit, zbatohen edhe dispozitat për kundërvajtjet administrative deri në kallëzim për ndjekje penale.

8. Ngarkohen Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe Ministria e Financave të nxjerrin udhëzimet përkatëse, në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Ilir Meta

⁴ Ndryshuar me udhëzimin nr. 1957, datë 19.9.2006 (shfuqizuar); me udhëzimin nr. 2211, datë 16.12.2010 (shfuqizuar); me udhëzimin nr. 113, datë 4.8.2011 (shfuqizuar); me udhëzimin nr. 9, datë 16.10.2012 (shfuqizuar); me udhëzimin nr. 5, datë 7.8.2013 (shfuqizuar); me udhëzimin nr. 12, datë 29.9.2014 (shfuqizuar); me udhëzimin nr. 23, datë 20.8.2015 (shfuqizuar); me udhëzimin nr. 19, datë 30.8.2016 (shfuqizuar); me udhëzimin nr. 365, datë 21.9.2017 (shfuqizuar); me udhëzimin nr. 625, datë 27.8.2018 (shfuqizuar); me udhëzimin nr. 593, datë 1.8.2019 (në fuqi)

VENDIM
Nr.387, datë 31.5.2001

PËR PËRJASHTIMIN NGA TAKSAT DHE TATIMET TË INVALIDËVE
PARAPLEGJIKË DHE TETRAPLEGJIKË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 6,16 dhe 21 të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për efekt të zbatimit të nenit 6 të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë përjashtohen nga këto taksa:

- a) Taksat për shërbimet konsullore;
- b) Taksa e regjistrimit të përvitshëm të automjeteve;
- c) Taksa për pajisjen me dëshmi aftësie për drejtim automjeti;
- ç) Taksa për përdorimin e aparateve radiotelevizive;
- d) Taksa për përdorimin e aparateve telefonikë;
- dh) Taksa për regjistrimin në arsimin e lartë;
- e) Taksa për kalimin e kufirit të Republikës së Shqipërisë me avion;
- ë) Taksa për pajisjen me pasaportë lundrimi;
- f) Taksa për pastrimin, largimin dhe kompostimin e mbeturinave;
- g) Taksa për gjuetinë dhe peshkimin amator;
- gj) Taksa e solidaritetit për rendin dhe mbrojtjen.

2. Mjetet që u përkasin të sëmurëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë që përfitojnë nga përjashtimi i detyrimeve të importit janë:

- a) Pajisje të thjeshta të përdorimit vetjak të të sëmurëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë.
- b) Karroca me dhe pa motor, si dhe autovetura të përshtatura për përdorimin nga këta të sëmurë.

Procedurat e përjashtimit nga detyrimet e importit të këtyre mjeteve përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Administratës së Përgjithshme të Ndihmës e të Shërbimeve Sociale dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

3. Ngarkohen Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

d2c	A ke vështirësi të bësh rutinën ditore si p.sh. në mëngjes të ngrihesh nga shtrati, të vishesh, të lash dhëmbët, të lash fytyrën e të krehësh flokët, të përgatisësh mëngjesin, të hash mëngjesin? Nëse po, si krahasohesh me moshatarët? Cilat janë vështirësitë? Sa është shkalla e vështirësive?	0 ☐	1 ☐	2 ☐	3 ☐	4 ☐
d2d	A ke vështirësi të presësh derisa të vijë radha për të luajtur në këndin e lojërave ose me shokët në kopësht, të presësh autobuzin, të rrish në një radhë të gjatë për të blerë diçka, ose të presësh sa të mbarojë së foluri bashkëbiseduesi pa e ndërprerë? A ke vështirësi të përqëndrohesh në punën/lojën që ke në dorë derisa të përfundojë? Nëse po, si krahasohesh me moshatarët? Cilat janë vështirësitë? Sa është shkalla e vështirësive?	0 ☐	1 ☐	2 ☐	3 ☐	4 ☐
d2e	A ke vështirësi të pranosh udhëzimet ose kritikën që të jepen nga të tjerët? A e kontrollon dot reagimin tënd emocional ndaj njerëzve të tjerë, kafshëve shtëpiake apo sendeve/objekteve (të mos bërtasësh apo të shash, të godasësh, të hedhësh përtokë, të thyesh, etj)? Nëse po, si krahasohesh me moshatarët? Cilat janë vështirësitë? Sa është shkalla e vështirësive?	0 ☐	1 ☐	2 ☐	3 ☐	4 ☐
d3	KOMUNIKIMI					
	(a) Komunikimi me mesazhe të folura (përfshirë kuptimin tekstual dhe të nënkuptuar të mesazheve në gjuhën e folur)	Aspak Lehtë Mod Rëndë Plotë				
		0 ☐	1 ☐	2 ☐	3 ☐	4 ☐
	(b) Komunikimi me mesazhe të shkruara (të kuptuarit dhe nënkuptuarit e mesazheve letrare që janë dhënë përmes gjuhës së shkruar, duke përfshirë shkrimin Braille)					
	(c) Të folurit (artikullimi mesazheve verbale, përfshin përdorimin e gjuhës së shenjave)					
	(d) Biseda (Të mbash një bisedë me një njeri ose shumë njerëz)					
d3a	A ke vështirësi të kuptosh se çfarë të thonë të tjerët kur flasin? Nëse po, si krahasohesh me moshatarët? Cilat janë vështirësitë? Sa është shkalla e vështirësive?	0 ☐	1 ☐	2 ☐	3 ☐	4 ☐
d3b	A ke vështirësi të kuptosh se çfarë të thonë të tjerët ndërmjet shenjave të zakonshme (p.sh., fërkimi i syve tregon që personi ka nevojë të fletë)? A ke vështirësi të kuptosh se çfarë do të thotë një shprehje zemërimi në fytyrë? A ke vështirësi të kuptosh se çfarë është shkruar në një mesazh? A ke vështirësi të kuptosh shenjat e qarkullimit rrugor, p.sh. ku duhet të kalojë këmbësori në rrugë? Nëse po, si krahasohesh me moshatarët? Cilat janë vështirësitë? Sa është shkalla e vështirësive?	0 ☐	1 ☐	2 ☐	3 ☐	4 ☐
d3c	A ke vështirësi të shprehësh mendimet e tua me anë të të folurit/shenjave përkatëse? Nëse po, si krahasohesh me moshatarët? Cilat janë vështirësitë? Sa është shkalla e vështirësive?	0 ☐	1 ☐	2 ☐	3 ☐	4 ☐
d3d	A ke vështirësi të fillosh një bisedë dhe ta mbash gjallë atë duke ju referuar temave të ndryshme; të diskutosh me një person; të flasësh në telefon, etj.? Nëse po, si krahasohesh me moshatarët? Cilat janë vështirësitë? Sa është shkalla e vështirësive?	0 ☐	1 ☐	2 ☐	3 ☐	4 ☐
d4	LËVIZJA/MOBILITETI					
	(a) Ngritja dhe mbajtja e objekteve (duke ngritur lart një objekt ose të marrësh diçka nga një vend në tjetrin, të tilla si të ngresh një filxhan, një lodër, një pako nga një dhomë në një tjetër)					
	(b) Ecja në shtëpi					
	(c) Të ndenjurit në këmbë (P.Sh për 30 minuta)					
	(d) Uljen dhe ngritjen në këmbë (nga karrigja, divani, etj).					
d4a	A ke vështirësi të ngresh një lodër nga tavolina? A mund të ngresh një gotë me ujë tek buzët? A mund të mbash një karrige nga një dhomë tek tjetra? A mund të ngresh dy libra nga tavolina tek divani? Nëse po, si krahasohesh me moshatarët? Cilat janë vështirësitë? Sa është shkalla e vështirësive?	0 ☐	1 ☐	2 ☐	3 ☐	4 ☐
d4b	A ke vështirësi të ecësh nëpër shtëpi, p.sh., të shkosh nga guzhina në dhomën e gjumit? Nëse po, si krahasohesh me moshatarët? Cilat janë vështirësitë? Sa është shkalla e vështirësive?	0 ☐	1 ☐	2 ☐	3 ☐	4 ☐

d4c	A ke vështirësi të rrish në këmbë për një kohë relativisht të gjatë (15-30 minuta), p.sh. të presësh autobuzin apo të rrish në rradhë? Nëse po, si krahasohesh me moshatarët? Cilat janë vështirësitë? Sa është shkalla e vështirësive?	0	1	2	3	4
		☐	☐	☐	☐	☐
d4d	A ke vështirësi të ngrihesh pa ndihmë pasi je ulur (p.sh., nga karrigia, nga divani)? Nëse po, si krahasohesh me moshatarët? Cilat janë vështirësitë? Sa është shkalla e vështirësive?	0	1	2	3	4
		☐	☐	☐	☐	☐
d4e	A mund të lëvizësh jashtë shtëpie i pavarur, i pashoqëruar dhe pa ndihmë? Nëse po, si krahasohesh me moshatarët? Cilat janë vështirësitë? Sa është shkalla e vështirësive?	0	1	2	3	4
		☐	☐	☐	☐	☐
d5	KUJDESI PËR VETEN NË MËNYRË TË PAVARUR					
	(a) Larja e të gjithë trupit (larja dhe tharja e tërë trupit, apo pjesë të trupit, duke përdorur materiale ose metoda të përshtatshme pastrimi si bërja banjë, dush, larja e duarve dhe këmbëve, fytyrës dhe flokëve, dhe tharja me peshqir)					
	(b) Kujdesi higjeno-sanitar (kryerja e planifikuar në banjë e urinimit dhe defekimit, kujdesi për menstruacionet dhe pastrimi i vetvetes)					
	(c) Pastrimi i vetvetes (pas kryerjes së nevojave higjienike)					
	(d) Të veshurit (në përputhje me kushtet klimatike)					
	(e) Të ushqyerit dhe të pirët					
	(f) Kujdesi për shëndetin vetjak (marrja e ilaçeve dhe respektimi i dietës ushqimore të kërkuar)					
d5a	A ke vështirësi të kujdesesh për veten, p.sh., të lash duart, faqet, dhëmbët, të krehësh flokët, të bësh dush pa ndihmën e të tjerëve, etj.? Nëse po, si krahasohesh me moshatarët? Cilat janë vështirësitë? Sa është shkalla e vështirësive?	0	1	2	3	4
		☐	☐	☐	☐	☐
d5b (d530)	A ke vështirësi në të kryerit e tualetit si urinimi e jashtëqitja, pa ndihmën e të tjerëve? Nëse po, si krahasohesh me moshatarët? Cilat janë vështirësitë? Sa është shkalla e vështirësive?	0	1	2	3	4
		☐	☐	☐	☐	☐
d5c	A ke vështirësi në pastrimin e vetvetes pas kryerjes së nevojave higjienike? Nëse po, si krahasohesh me moshatarët? Cilat janë vështirësitë? Sa është shkalla e vështirësive?	0	1	2	3	4
		☐	☐	☐	☐	☐
d5d	A ke vështirësi të vishesh në përputhje me kushtet klimaterike dhe moshën (dmth, të zgjedhësh rrobat vetë, të veshësh një fustan, fund, bluze, këmbishë, pantallona, corape, këpucë, etj.)? Nëse po, si krahasohesh me moshatarët? Cilat janë vështirësitë? Sa është shkalla e vështirësive?	0	1	2	3	4
		☐	☐	☐	☐	☐
d5e	A ke vështirësi të hash e të pish vetë pa ndihmën e të tjerëve (të përdorësh lugën, pirunin dhe thikën, ta hedhësh ujin në gotë dhe të pish një lëng me gotë ose tas)? Nëse po, si krahasohesh me moshatarët? Cilat janë vështirësitë? Sa është shkalla e vështirësive?	0	1	2	3	4
		☐	☐	☐	☐	☐
d5f	A ke vështirësi të kujdesesh për shëndetin tënd pa dihmën e të tjerëve (dmth të marrësh ilaçet sipas porosisë së mjekut, të respektosh dietën ushqimore të kërkuar, etj.)? Nëse po, si krahasohesh me moshatarët? Cilat janë vështirësitë? Sa është shkalla e vështirësive?	0	1	2	3	4
		☐	☐	☐	☐	☐
d6	JETA SHTËPIAKE					
	(a) Blerja e mallrave dhe shërbimeve					
	(b) Përgatitja e ushqimit					
	(c) Kryerja e punëve të shtëpisë (në përputhje me moshën dhe rolet në shtëpi)					
	(d) Kujdesi dhe ndihma për të tjerët që jetojnë me personin					
d6a	A ke vështirësi të përfshihesh në jetën shtëpiake, p.sh., të bësh pazarin apo të blesh mallrat të ndryshme? Nëse po, si krahasohesh me moshatarët? Cilat janë vështirësitë? Sa është shkalla e vështirësive?	0	1	2	3	4
		☐	☐	☐	☐	☐
d6b	A ke vështirësi të gatuash apo të përgatisësh ushqim për vetëveten (p.sh., të presësh bukën, të lyesh bukën me gjalpë, të fërgosh një vezë, të bësh makarona, pilaf etj.)? Nëse po, si krahasohesh me moshatarët? Cilat janë vështirësitë? Sa është shkalla e vështirësive?	0	1	2	3	4
		☐	☐	☐	☐	☐

d6c	A ke vështirësi të bësh punët e shtëpisë që të ngarkohen (p.sh., të lash rroba me dorë apo lavatriçe, të varësh rroba për t'u tharë, të fshish dhomën, të hekurosësh, të kujdesesh për objektet shtëpiake duke bërë riparime të vogla, të hedhësh plehurat, të lash xhamat, të ujisësh lulet apo të ushqesh kafshët shtëpiake)? Nëse po, si krahasohesh me moshatarët? Cilat janë vështirësitë? Sa është shkalla e vështirësive?	<table border="0"> <tr> <td>0</td><td>1</td><td>2</td><td>3</td><td>4</td> </tr> <tr> <td>☐</td><td>☐</td><td>☐</td><td>☐</td><td>☐</td> </tr> </table>	0	1	2	3	4	☐	☐	☐	☐	☐					
0	1	2	3	4													
☐	☐	☐	☐	☐													
d6d	A ke vështirësi të ndihmosh anëtarët e tjerë të familjes (p.sh., të kujdesesh për një fëmijë ose për anëtarë të familjes që janë të sëmurë duke i ushqyer, duke i dhënë ilaçet, duke i shoqëruar në banjo, etj). Nëse po, si krahasohesh me moshatarët? Cilat janë vështirësitë? Sa është shkalla e vështirësive?	<table border="0"> <tr> <td>0</td><td>1</td><td>2</td><td>3</td><td>4</td> </tr> <tr> <td>☐</td><td>☐</td><td>☐</td><td>☐</td><td>☐</td> </tr> </table>	0	1	2	3	4	☐	☐	☐	☐	☐					
0	1	2	3	4													
☐	☐	☐	☐	☐													
d7	MARRËDHËNIET ME TË TJERËT (a) Ndërveprimet themelore ndërpersonale (shfaqja e respektit të duhur dhe reagimi me mirëkuptim dhe bashkëveprimi sipas rregullave shoqërore) (b) Njohja e diferencës ndërmjet marrëdhënieve zyrtare formale dhe ato joformale (shokë/shoqe, fqinj) (c) Marrëdhëniet intime	<table border="0"> <tr> <td>Aspak</td><td>Lehtë</td><td>Mod</td><td>Rëndë</td><td>Plotë</td> </tr> <tr> <td>0</td><td>1</td><td>2</td><td>3</td><td>4</td> </tr> <tr> <td>☐</td><td>☐</td><td>☐</td><td>☐</td><td>☐</td> </tr> </table>	Aspak	Lehtë	Mod	Rëndë	Plotë	0	1	2	3	4	☐	☐	☐	☐	☐
Aspak	Lehtë	Mod	Rëndë	Plotë													
0	1	2	3	4													
☐	☐	☐	☐	☐													
d7a	A ke vështirësi në marrëdhëniet me njerëzit, dmth, me anëtarët e familjes së ngushtë dhe të zgjeruar, miqtë, fqinjët, shokët e shoqet e kopshtit, klasës, shokët e shoqet e punës? A ke vështirësi të sillësh sipas normave sociale të kërkuara në këtë kontekst, si p.sh., të mos e ngresh zërin në bisedë, të mos i prekësh të tjerët në mënyrë të papërshtatëshme, etj.? Nëse po, si krahasohesh me moshatarët? Cilat janë vështirësitë? Sa është shkalla e vështirësive?	<table border="0"> <tr> <td>0</td><td>1</td><td>2</td><td>3</td><td>4</td> </tr> <tr> <td>☐</td><td>☐</td><td>☐</td><td>☐</td><td>☐</td> </tr> </table>	0	1	2	3	4	☐	☐	☐	☐	☐					
0	1	2	3	4													
☐	☐	☐	☐	☐													
d7b	A ke vështirësi të kuptosh ndryshimin në marrëdhënie ndërmjet njerëzve që i ke njohur për shumë kohë (si p.sh., të afërme dhe shokëve të kopshtit/klasës/ punës) dhe të njerëzve që sapo i ke takuar dhe nuk ke krjuar marrëdhënie? Nëse po, si krahasohesh me moshatarët? Cilat janë vështirësitë? Sa është shkalla e vështirësive?	<table border="0"> <tr> <td>0</td><td>1</td><td>2</td><td>3</td><td>4</td> </tr> <tr> <td>☐</td><td>☐</td><td>☐</td><td>☐</td><td>☐</td> </tr> </table>	0	1	2	3	4	☐	☐	☐	☐	☐					
0	1	2	3	4													
☐	☐	☐	☐	☐													
d7c	A ke vështirësi në marrëdhëniet intime, dmth të dallos nëse dikush të pëlqen, ke të drejtë ta pëlqesh, të krijosh dhe të mbash marrëdhënie romantike ose bashkëshortore, etj.? Nëse po, si krahasohesh me moshatarët? Cilat janë vështirësitë? Sa është shkalla e vështirësive?	<table border="0"> <tr> <td>0</td><td>1</td><td>2</td><td>3</td><td>4</td> </tr> <tr> <td>☐</td><td>☐</td><td>☐</td><td>☐</td><td>☐</td> </tr> </table>	0	1	2	3	4	☐	☐	☐	☐	☐					
0	1	2	3	4													
☐	☐	☐	☐	☐													
d8	FUSHAT KRYESORE TË JETËS: EDUKIMI/ARSIMIMI DHE PUNËSIMI DHE NDËRVEPRIMET EKONOMIKE NË PËRPUTHJE ME MOSHËN (a) Përfshirja në lojë (b) Edukimi parashkollor (Cerdhe apo kopësht) (c) Arsimi shkollor (nëntëvjeçar dhe i mesëm) (d) Trajnimi profesional (e) Arsimi i lartë (f) Punësimi me kohë të pjesshme (me kohë të plotë dhe vetëpunësim) (g) Aftësia për të kontrolluar financel personale (llogaritë bankare etj.)	<table border="0"> <tr> <td>Aspak</td><td>Lehtë</td><td>Mod</td><td>Rëndë</td><td>Plotë</td> </tr> <tr> <td>0</td><td>1</td><td>2</td><td>3</td><td>4</td> </tr> <tr> <td>☐</td><td>☐</td><td>☐</td><td>☐</td><td>☐</td> </tr> </table>	Aspak	Lehtë	Mod	Rëndë	Plotë	0	1	2	3	4	☐	☐	☐	☐	☐
Aspak	Lehtë	Mod	Rëndë	Plotë													
0	1	2	3	4													
☐	☐	☐	☐	☐													
d8a	(Për fëmijët) A has vështirësi të luajë me lodra (përshtirë ato elektronike), apo në sheshin e lojërave, etj. vetëm apo me shokë/shoqe? Nëse po, si krahasohesh me moshatarët? Cilat janë vështirësitë? Sa është shkalla e vështirësive?	<table border="0"> <tr> <td>0</td><td>1</td><td>2</td><td>3</td><td>4</td> </tr> <tr> <td>☐</td><td>☐</td><td>☐</td><td>☐</td><td>☐</td> </tr> </table>	0	1	2	3	4	☐	☐	☐	☐	☐					
0	1	2	3	4													
☐	☐	☐	☐	☐													
d8b	(Për fëmijët e moshës parashkollorore) A has vështirësi për të ndjekur rutinën e kërkuar dhe procesin e mësimin në çerdhe apo kopësht gjithëpërfshirës? Nëse po, si krahasohesh me moshatarët? Cilat janë vështirësitë? Sa është shkalla e vështirësive?	<table border="0"> <tr> <td>0</td><td>1</td><td>2</td><td>3</td><td>4</td> </tr> <tr> <td>☐</td><td>☐</td><td>☐</td><td>☐</td><td>☐</td> </tr> </table>	0	1	2	3	4	☐	☐	☐	☐	☐					
0	1	2	3	4													
☐	☐	☐	☐	☐													
d8c	(Për fëmijët e moshës shkollorore) A has vështirësi për të ndjekur rutinën e kërkuar dhe procesin e mësimin në arsin gjithëpërfshirës? Nëse po, si krahasohesh me moshatarët? Cilat janë vështirësitë? Sa është shkalla e vështirësive?	<table border="0"> <tr> <td>0</td><td>1</td><td>2</td><td>3</td><td>4</td> </tr> <tr> <td>☐</td><td>☐</td><td>☐</td><td>☐</td><td>☐</td> </tr> </table>	0	1	2	3	4	☐	☐	☐	☐	☐					
0	1	2	3	4													
☐	☐	☐	☐	☐													

d8d	(Për personat që ndjekin/mund të ndjekin arsimin profesional) A has vështirësi për të ndjekur rutinën e kërkuar dhe procesin e mësimin në një kurs trajnimi profesional? Nëse po, si krahasohesh me moshatarët? Cilat janë vështirësitë? Sa është shkalla e vështirësive?	0	1	2	3	4
		☐	☐	☐	☐	☐
d8e	(Për personat që ndjekin/mund të ndjekin arsimin e lartë) A has vështirësi për të ndjekur rutinën e kërkuar dhe procesin e mësimin në universitet? Nëse po, si krahasohesh me moshatarët? Cilat janë vështirësitë? Sa është shkalla e vështirësive?	0	1	2	3	4
		☐	☐	☐	☐	☐
d8f	(Për personat e moshës së punës) A ndjen vështirësi që vijnë nga gjendja jote shëndetësore të kërkuar për një punë me pagesë me kohë të pjesshme ose kohë të plotë dhe të plotësosh detyrimet e saj? Nëse jeni i vetëpunësuar, a ndjen vështirësi që vijnë nga gjendja jote shëndetësore të plotësosh detyrimet për të mbajtur biznesin tuaj? Nëse po, si krahasohesh me moshatarët? Cilat janë vështirësitë? Sa është shkalla e vështirësive?	0	1	2	3	4
		☐	☐	☐	☐	☐
d8g	(Për personat mbi 18 vjeç) A ndjen vështirësi të bësh veprime në bankë si p.sh. të hapësh një llogari bankare, të depozitosh para, të tërheqësh para, etj.? Nëse po, si krahasohesh me moshatarët? Cilat janë vështirësitë? Sa është shkalla e vështirësive?	0	1	2	3	4
		☐	☐	☐	☐	☐
d9	KOMUNITETI, JETA SHOQËRORE DHE QYTETARE NË PËRPUTHJE ME MOSHËN					
	(a) Pjesëmarrjen në organizata/shoqata (përfshirë ato të avokatisë, klube, parti etj.)					
	(b) Pjesëmarrjen në lojë me të tjerët dhe sporte (frekuentimi i kinemasë, teatrit, galerive të artit etj., luajtja e një instrumenti muzikor ose pjesëmarrja në kor, shfaqje teatrale etj.)					
	(c) Pjesëmarrja në ceremoni fetare apo jetën politike (si p.sh. të votosh)					
d9a	A ndjen vështirësi që vijnë nga gjendja jote shëndetësore të marrësh pjesë në grupime, skuadra, organizata, klube jashtëshkollore, shoqata, organizata avokatie, parti ku ke dëshirë të jesh pjesë e të kontribuosh? Nëse po, si krahasohesh me moshatarët? Cilat janë vështirësitë? Sa është shkalla e vështirësive?	0	1	2	3	4
		☐	☐	☐	☐	☐
d9b	A ndjen vështirësi që vijnë nga gjendja jote shëndetësore të marrësh pjesë në lojëra, aktivitete artistike apo sportive (ndeshje formale dhe informale) ku ke dëshirë të marrësh pjesë? Nëse po, si krahasohesh me moshatarët? Cilat janë vështirësitë? Sa është shkalla e vështirësive?	0	1	2	3	4
		☐	☐	☐	☐	☐
d9c	A ndjen vështirësi që vijnë nga gjendja jote shëndetësore të marrësh pjesë në në aktivitete fetare ku ke dëshirë të marrësh pjesë? A ndjen vështirësi që vijnë nga gjendja jote shëndetësore të marrësh pjesë në aktivitete politike ku ke dëshirë të marrësh pjesë, si p.sh., të votosh ose të marrësh pjesë në një miting? Nëse po, si krahasohesh me moshatarët? Cilat janë vështirësitë? Sa është shkalla e vështirësive?	0	1	2	3	4
		☐	☐	☐	☐	☐
FAKTORËT MJEDISORË						
Faktorët mjedisorë përbëjnë mjedisin fizik, social dhe të sjelljes në të cilat njerëzit jetojnë. Dy lloje cilësorësh do të përdoren. Për të treguar një pengesë, rretho cilësorin e duhur dhe shto një - (minus). Për të treguar një lehtësues, rretho cilësorin më të përshtatshme dhe pastaj shto një + (plus). Për efekt të llogaritjes së nivelit të aftësisë së kufizuar, vetëm cilësorët me minus (-), dmth faktorët pengues do të llogariten. Për të mbledhur informacion, bëni pyetjet e mëposhtme duke zgjedhur ato pyetje që janë të aplikueshme për personin që po intervistohet. Në bazë të përgjigjes, rrethoni cilësorin që përfaqëson më mirë situatën. Në fushën e objektit përkatës, pas Shënimit: shkruaj çështjen, p.sh. Ka nevojë për karrocë me rrota, ose ka nevojë për ndihmë ekonomike, ose ka nevojë për trajnim profesional, ose ndjek një qendër ditore. Për zgjedhjen e cilësorit përfaqësues për kategorinë, zgjidhni cilësorin negativ të përdorur më shpesh brenda kategorisë ose që ju duket me i rëndësishmi brenda fushave të përfshira në kategori. Kjo ka lidhje të drejtpërdrejtë me natyrën e aftësisë së kufizuar. P.sh., për një person që përdor karrige me rrota cilësori për e1g dhe e1c janë përcaktues për cilësorin e e1. Ndërsa për një person që përdor gjuhën e shenjave, cilësori përcaktues do të jetë e1d. Në fund shënoni pikët për kategorinë në e1, e2, e3, e4 dhe e5.						
e1	PRODUKTE DHE TEKNOLOGJI	Aspak	Lehtë	Mod	Rëndë	Plotë
	(a) Cilësinë e ushqimit	0	1	2	3	4
		☐	☐	☐	☐	☐
	(b) Pajisjen me ilace					
	(c) Teknologjia ndihmëse dhe përgatitjet për lëvizje					
	(d) Teknologjia ndihmëse për komunikim					

(shëno mbështetjen që individi ose ka nevojë të ketë)

e1f (Për personat që kanë mundësi të punojnë) A ke nevojë për mjete dhe materiale të përshtatura për punësim? Cfarë mungesash ka? Nëse ka mungesa, çfarë ndikimi kanë këto mungesa në mundësinë tuaj për realizimin e punës? Sa është shkalla e ndikimit?

0	1	2	3	4
☐	☐	☐	☐	☐

(shëno mbështetjen që individi ose ka nevojë të ketë)

e1g (Për personat që kanë probleme me lëvizshmërinë) A është i përshtatur mjedisi në shtëpinë tuaj dhe në lagjen ku ju banoni? Cfarë mungesash ka? Nëse ka mungesa, çfarë ndikimi kanë këto mungesa në mundësinë tuaj për realizimin e veprimeve bazë të jetës ditore? Sa është shkalla e ndikimit?

0	1	2	3	4
☐	☐	☐	☐	☐

(shëno mbështetjen që individi ose ka nevojë të ketë)

e2 **MJEDISI NATYROR DHE NDRYSHIMET MJEDISORE NGA DORA E NJERIUT**

Aspak 0	Lehtë 1	Mod. 2	Rëndë 3	Plotë 4
------------	------------	-----------	------------	------------

(a) Gjeografinë dhe densitetin e popullsisë që lidhet me jetesën në zona urbane dhe rurale

☐	☐	☐	☐	☐
--------------------------	--------------------------	--------------------------	--------------------------	--------------------------

(b) Kushtet klimaterike

(c) Zhurmat

(d) Cilësinë e ajrit

e2e Ku jeton individi? A jeton në një zonë urbane që ofron mundësi për shoqërim dhe shërbime apo në një zonë rurale që nuk i ofron këto mundësi? Nëse ka mungesa, çfarë ndikimi kanë këto mungesa në mundësinë tuaj për realizimin e veprimeve bazë të jetës ditore dhe pjesëmarrjen në jetën shoqërore? Sa është shkalla e ndikimit?

0	1	2	3	4
☐	☐	☐	☐	☐

(shënim)

(e) Teknologjia ndihmëse për arsimimin

(f) Teknologjia ndihmëse për punësim

(g) Përshtatshmëria e mjedisit

- e1a** Si është cilësia e ushqimit që merr? A i mbulon kërkesat e dietës së personit në përputhje me nevojat e tij? Cfarë mungesash ka? Nëse ka mungesa, çfarë ndikimi kanë këto mungesa në aftësinë e kufizuar të personit? Sa është shkalla e ndikimit?

0 1 2 3 4
☐ ☐ ☐ ☐ ☐

(shënim)

- e1b** A i merr të gjitha ilaçet e nevojshme të rekomanduara nga mjekët? Cfarë mungesash ka? Nëse ka mungesa, Cfarë ndikimi kanë këto mungesa në aftësinë e kufizuar të personit? Sa është shkalla e ndikimit?

0 1 2 3 4
☐ ☐ ☐ ☐ ☐

(shënim)

- e1c** A ke nevojë për paisje e mbështetëse të tilla si një karrige me rrota, paterica, etj.? Cfarë paisjesh ke? Cfarë mungesash ka? Nëse ka mungesa, çfarë ndikimi kanë këto mungesa në mundësinë tuaj për realizimin e veprimeve bazë të jetës ditore? Sa është shkalla e ndikimit?

0 1 2 3 4
☐ ☐ ☐ ☐ ☐

(shëno pajisjet që ka ose ka nevojë të ketë)

- e1d** A ke nevojë për mbështetje për komunikim si përkthyes i gjuhës së shenjave/materiale të printuara në rail, programe kompjuterike për komunikim me zë e figura, etj.? Cfarë mbështetje ke? Cfarë mungesash ka? Nëse ka mungesa, çfarë ndikimi kanë këto mungesa në mundësinë tuaj për realizimin e veprimeve bazë të jetës ditore? Sa është shkalla e ndikimit?

0 1 2 3 4
☐ ☐ ☐ ☐ ☐

(shëno mbështetjen që individ i ose ka nevojë të ketë)

- e1e** (Për personat e moshës shkollore) A ke nevojë për mjete dhe materiale të përshtatura për shkolim? Cfarë mjetesh dhe materialesh ke? Cfarë mungesash ka? Nëse ka mungesa, çfarë ndikimi kanë këto mungesa në mundësinë tuaj për realizimin e procesit arsimor? Sa është shkalla e ndikimit?

0 1 2 3 4
☐ ☐ ☐ ☐ ☐

e2b Si janë kushtet klimaterike në zonën ku banon (individit)? A ka temperaturë të larta në verë e shumë të ulëta në dimër të shoqëruara nga rreshje dëbore? Cfarë ndikimi kanë këto kushte klimaterike në mundësinë tuaj për realizimin e veprimeve bazë të jetës ditore dhe pjesëmarrjen në jetën shoqërore? Sa është shkalla e ndikimit?

0	1	2	3	4
☐	☐	☐	☐	☐

(shënim)

e2c Si janë kushtet e banimit (të individit) në lidhje me zhurmat? A ka zhurma shqetësuese të vazhdueshme (pranë rrugës, pranë shinave të trenit, etj) që nuk e lejojnë të pushojë e të flejë si duhet? Cfarë ndikimi kanë këto zhurma në mundësinë tuaj për realizimin e veprimeve bazë të jetës ditore? Sa është shkalla e ndikimit?

0	1	2	3	4
☐	☐	☐	☐	☐

(shënim)

e2d A është i ndotur mjedisi/ajri në zonën ku banon (individit) përtej normave të lejuara? Cfarë ndikimi ka ndotja e ajrit në mundësinë tuaj për realizimin e veprimeve bazë të jetës ditore? Sa është shkalla e ndikimit?

0	1	2	3	4
☐	☐	☐	☐	☐

(shënim)

e3 MBËSHTETJA DHE MARRËDHËNIET

(a) Familjen

Aspak	Lehtë	Mod.	Rëndë	Plotë
0	1	2	3	4
☐	☐	☐	☐	☐

(b) Fqinjët, miqtë, të njohurit

(c) Ofruesit e kujdesit personal dhe ndihmësit personal

(d) Profesionistët e kujdesit shëndetësor dhe të shërbimeve aftësuese e sociale

A merr mbështetje/trajtohesh me respekt nga familja e ngushtë (si bashkëshorti, partneri, prindi, vëllai /motra, fëmija, prindi kujdestar, prindi adoptues, gjyshi, tezja, halla, xhaxhai, daja-nëse jeton në një familje të zgjeruar, etj.). Cfarë mungesash ka? Nëse ka mungesa në mbështetje, çfarë ndikimi kanë këto mungesa në mundësinë tuaj për realizimin e veprimeve bazë të jetës ditore? Sa është shkalla e ndikimit?

0	1	2	3	4
☐	☐	☐	☐	☐

(shëno mbështetjen)

e4 QËNDRIMET PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR DHE PËRFSHIRJEN E TYRE NË SHOQËRI SI TË BARABARTË ME TË TJERËT

Aspak	Lehtë	Mod	Rëndë	Plotë
0	1	2	3	4
☐	☐	☐	☐	☐

Këtu përfshihen qëndrimet që vijnë nga zakonet, tradita, mentaliteti, normat shoqërore dhe besimet fetare në komunitetin e personit (në bashki dhe/apo qark)

e4a Si janë qëndrimet sociale e politike në lidhje me vlerat e personit me aftësi të kufizuara dhe në mundësitë e tij për gjithëpërfshirje sociale në përputhje me moshën në bashkinë/qarkun ku banon? Nëse ka probleme, çfarë ndikimi kanë këto mungesa në mundësinë tuaj për realizimin e veprimeve bazë të jetës ditore dhe pjesëmarrjen në jetën shoqërore? Sa është shkalla e ndikimit?

0	1	2	3	4
☐	☐	☐	☐	☐

(shënim)

e5 SHËRBIMET, SISTEMET DHE POLITIKAT

Aspak	Lehtë	Mod	Rëndë	Plotë
0	1	2	3	4
☐	☐	☐	☐	☐

Kjo përfshin ekzistencën e shërbimeve dhe sistemeve administrative që mundësojnë gjithëpërfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në fusha të ndryshme të jetës të ngritura si rezultat i politikave dhe/ose programeve lokale, kombëtare e ndërkombëtare. Kjo përfshin:

(a) shërbimet dhe politikat

(b) strehimin dhe ndërtimet

(c) të komunikimit

(d) të mbrojtjes shoqërore

(e) të shërbimeve shëndetësore

(f) të shërbimeve riaftësuese në përputhje me moshën dhe aftësinë e kufizuar

(g) të shërbimeve dhe programeve mbështetëse për arsim në përputhje me moshën dhe aftësinë e kufizuar

(h) të shërbimeve dhe programeve mbështetëse për trajnim profesional

(i) të shërbimeve dhe programeve të punësimit

e5a A ndikohet kryerja e veprimeve bazë të jetës dhe pjesëmarrja juaj në jetën shoqërore nga shërbimet dhe politikat e strehimit dhe kërkesave për aksesueshmëri? (P.sh., keni hapësirën e nevojshme për strehim, ose nëse keni problem të lëvizjes dhe jetoni në një apartament mbi katin e dytë, a keni mundësinë të përdorni një ashensor?) Nëse po, cili është ndikimi në mundësinë tuaj për realizimin e veprimeve bazë të jetës ditore dhe pjesëmarrjen në jetën shoqërore? Sa është shkalla e ndikimit?

0	1	2	3	4
☐	☐	☐	☐	☐

(shënim)

e5b

A ndikohet kryerja e veprimeve bazë të jetës dhe pjesëmarrja juaj në jetën shoqërore nga shërbimet dhe politikat e komunikimit, të tilla si p.sh., mundësia e përdorimit të një telefoni me linjë tokësore ose celular, mundësia e përdorimit të një kompjuteri-me programe të adaptuara për persona që kanë problem shikimi, me internet, prania e shërbimit postar, mundësia e një përkthyesi të shenjave, mundësia e printimit në brail, etj. ? Nëse po, cili është ndikimi në mundësinë tuaj për realizimin e veprimeve bazë të jetës ditore dhe pjesëmarrjen në jetën shoqërore? Sa është shkalla e ndikimit?

0	1	2	3	4
☐	☐	☐	☐	☐

(shënim)

e5c

A ndikohet kryerja e veprimeve bazë të jetës dhe pjesëmarrja juaj në jetën shoqërore nga shërbimet dhe politikat e transportit, të tilla si mundësia e përdorimit të transportit urban dhe interurban (të përshtatur- nëse është e nevojshme). Nëse po, cili është ndikimi në mundësinë tuaj për realizimin e veprimeve bazë të jetës ditore dhe pjesëmarrjen në jetën shoqërore? Sa është shkalla e ndikimit?

0	1	2	3	4
☐	☐	☐	☐	☐

(shënim)

e5d

A ndikohet kryerja e veprimeve bazë të jetës dhe pjesëmarrja juaj në jetën shoqërore nga shërbimet dhe politikat/programet e mbrojtjes sociale, të tilla si aktiviteti i administratorit social, ndihma ekonomike, pagesa suplementare e energjisë, etj. ? Nëse po, cili është ndikimi në mundësinë tuaj për realizimin e veprimeve bazë të jetës ditore dhe pjesëmarrjen në jetën shoqërore? Sa është shkalla e ndikimit?

0	1	2	3	4
☐	☐	☐	☐	☐

(shënim)

e5e

A ndikohet kryerja e veprimeve bazë të jetës dhe pjesëmarrja juaj në jetën shoqërore nga shërbimet dhe programet e shërbimeve shëndetësore të tilla si mjeku i familjes, mjeku specialist, spitali, etj. (kujdesi ndaj jush, cilësia e shërbimit, mundësia e vizitave mjeksore, cilësia e vizitave mjeksore, largësia nga qendra e banimit, farmacitë (largësia nga qendra e banimit, çmimet/rimbursimi i ilaçeve), etj.? Nëse po, cili është ndikimi në mundësinë tuaj për realizimin e veprimeve bazë të jetës ditore dhe pjesëmarrjen në jetën shoqërore? Sa është shkalla e ndikimit?

0	1	2	3	4
☐	☐	☐	☐	☐

(shënim)

- e5f** A merrni shërbime rraftësuese psiko-sociale? A ndikohet kryerja e veprimeve bazë të jetës dhe pjesëmarrja juaj në jetën shoqërore nga këto shërbime dhe programe rraftësuese psiko-sociale (në një qëndër, ose nga një a më shumë specialistë rraftësimi) të cilat sigurojnë mësimin e shprehive të ndryshme për kryerjen e veprimeve bazë të jetës së përditëshme dhe të vetëkujdesit, ndihmojnë me çrregullimet e sjelljes, rrisin shkallën e aftësive si edhe japin ndihmë me veprimtari të tilla si bërja e pazarit, punët e shtëpisë, shoqërimi për të shkuar në punë/shkollë apo aktivitete çlodhëse, kulturore e artistike? Nëse po, cili është ndikimi në mundësinë tuaj për realizimin e veprimeve bazë të jetës ditore dhe pjesëmarrjen në jetën shoqërore? Sa është shkalla e ndikimit?

0	1	2	3	4
☐	☐	☐	☐	☐

(shënim)

- e5g** A shkoni në kopësht/shkollë/universitet? A ndikohet realizimi me sukses i shkollimit tuaj nga shërbimet dhe programet mbështetëse për arsim parashkollor, shkollor apo universitar në përputhje me moshën dhe aftësinë e kufizuar? Nëse po, cili është ndikimi në mundësinë tuaj për realizimin e veprimeve bazë të jetës ditore dhe pjesëmarrjen në jetën shoqërore? Sa është shkalla e ndikimit?

0	1	2	3	4
☐	☐	☐	☐	☐

(shënim)

- e5h** A merrni pjesë në programe për trajnim profesional? A mendoni se mbështetja për të përfituar nga trajnimi profesional në përputhje me aftësinë e kufizuar rrit shkallën e mundësive tuaj për realizimin e punësimit me orë të pjesëshme apo të plota? Sa është shkalla e ndikimit?

0	1	2	3	4
☐	☐	☐	☐	☐

(shënim)

- e5i** A merrni shërbime punësimi si gjetja e punës të përshtatëshme, përshtatja e mjedisit të punës, trajnimi për vendin e punës dhe mbajtjen e vendit të punës, etj? A mendoni se mbështetja për të përfituar nga shërbimet e punësimit në përputhje me aftësinë e kufizuar rrit shkallën e mundësive tuaj për realizimin e punësimit me orë të pjesëshme apo të plota? Sa është shkalla e ndikimit?

0	1	2	3	4
☐	☐	☐	☐	☐

(shënim)

Kategoria e aftësisë së kufizuar:

- ☐ Autizëm
 ☐ Sëmundje kronike
 ☐ Aftësi e kufizuar intelektuale
 ☐ Shëndet mendor
- ☐ Dëmtim në të dëgjuar
 ☐ Dëmtim në shkrim
 ☐ Dëmtime ortopedike

Niveli i dëmtimit të aftësive funksionale:

- ☐ I lehtë
 ☐ I moderuar
 ☐ I rëndë
 ☐ I thellë/I plotë

Përfitimet:

Paketa higjienike dhe sanitare

☐ Po

Interpret i gjuhës së shenjave

☐ Po

Ndihmësi personal

☐ Po

Shërbimet e rekomanduara:

- ☐ Shërbime të edukimit special
 ☐ Trajnim profesional dhe mbështetja në lidhje me të
 ☐ Shërbimet e punësimit dhe mbështetja në lidhje me to
 ☐ Shërbime ditore
- ☐ Shërbimet rezidenciale
 ☐ Terapi Fizike
 ☐ Gjuha e shenjave
 ☐ Këshillim/Psikoterapi
- ☐ Shërbime transporti
 ☐ Të tjera (specifiko)

Teknologji asistive (përfshin mjetet e lëvizjes si edhe ato të komunikimit):

- ☐ Karrige me rrota
 ☐ Mjete ndihmëse në shikim
 ☐ Mjete ndihmëse në dëgjim
 ☐ Proteza
- ☐ Orteza
 ☐ Paterica/Deambulatorë
 ☐ Printim në Braille
 ☐ Tjetër (specifiko)

Përfitimet janë të vlefshme për një periudhë _____ (vjeçare)

Shënime (nëse ka mosmarrëveshje ndërmjet anëtarëve të komisionit):

KLAUZOLA DEKLARATIVE

Unë i/e nënshkruari/a _____ në dijeni të përgjegjësive penale që rrjedhin nga deklarimi dhe paraqitja e të dhënave e rrethanave të rreme, nën përgjegjësinë time personale deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta.

Nënshkrimi i plotësuesit të formularit

Data		Muaji		Viti			

Nënshkrimi i aplikantit

Data		Muaji		Viti			



FORMULAR APLIKIMI

VLERËSIMI PËR PËRCAKTIMIN E NEVOJËS PËR NDIHMËSIN PERSONAL

SHËRBIMI SOCIAL SHETËROR
MINISTRIA E MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË



Nëse keni pyetje, lutemi kontaktoni: Tel: E-mail: Web:	HAPËSIRË E REZERVUAR VETËM PËR INSTITUCIONIN
Shënim: Ju lutem plotësoni me kujdes dhe qartë informacionin e kërkuar në fushat më poshtë, ME SHKRONJË TË MADHE E NË NGJYRË BLU.	

SEKSIONI A: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKANTIN

1. Emri		2. Mbiemri	
3. Emri i Babait		4. NID Nr. i identifikimit personal	
5. Gjinia	☐ Mashkull ☐ Femër	6. Datëlindja	
7. Vendlindja		8. Shtetësia	
9. Adresa			
10. Qyteti		11. Rrethi	
12. Kodi Postar		13. Nr. Tel	
14. E-mail		15. Nr. Sig shëndetësor	

SEKSIONI A1: INFORMACION SPECIFIK MBI PERSONIN E AUTORIZUAR

BURIMI I INFORMACIONIT

☐ I afërm/anëtar i familjes		☐ Kujdestar (jo anëtar i familjes)	
1. Emri		2. Mbiemri	
3. Emri		4. Mbiemri	

SEKSIONI B: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKIMIN

NEVOJA PERSONALE

1. HIGJENA

- ☐ 1- Rregullisht, mund të lahet vetë (duart , fytyrën, kembët, etj.) e në mënyrë të pavarur.
☐ 2 - Mund të lahet vetë (duart, fytyrën, kembët, etj.), nëse i jepet sapun, peshqir, etj.
☐ 3 - Mund të lahet vetë (duart , fytyrën, kembët, etj.), nëse është i mbikqyrur dhe i jepet ndihmë, sipas nevojës.
☐ 4 - I pa aftë për t'u larë vetë dhe nevojitet ndihmë e plotë.
☐ 0 - Nuk aplikohet

2. BANJA/DUSHI

- ☐ 1- Rregullisht, bën banjë /dush e në mënyrë të pavarur
☐ 2 - Ka nevojë për t'u shoqëruar/hapur dushi, por mund të lahet në mënyrë të pavarur
☐ 3 - Ka nevojë për mbikqyrje dhe duhet t'i kërkohej të lahet.
☐ 4 - Totalisht i varur, nevojitet ndihmë e plotë.
☐ 0 - Nuk aplikohet

3. DHËMBËT

- ☐ 1- Rregullisht, pastron dhëmbët/protezat në mënyrë të pavarur
- ☐ 2 - Pastron dhëmbët/protezat, nëse i jepen mjetet e duhura
- ☐ 3 - Kërkon pak ndihmë, si pasta e dhëmbëve në furçë, furça në gojë, etj
- ☐ 4 - Nevojitet ndihmë e plotë
- ☐ 0 - Nuk aplikohet

4. VESHJA

- ☐ 1 - Rregullisht, zgjedh veshjet e duhura dhe vishet vetë
- ☐ 2 - Vishet vetë, por në mënyrë të gabuar dhe /ose mbrapsht, të pakthyera ose të palara
- ☐ 3 - I pamundur të vishet vetë, por lëviz gjymtyrët për të ndihmuar
- ☐ 4 - I pamundur për të ndihmuar dhe kërkon ndihmë totale për t'u veshur
- ☐ 0 - Nuk aplikohet

5. TUALETI

- ☐ 1 - Përdor tualetin në mënyrë të përshtatshme, kur ka nevojë
- ☐ 2 - Nevojitet të dërgohet në tualet dhe t'i jepet ndihmë
- ☐ 3 - Urinë ose feçe e pakontrolluar
- ☐ 4 - Urinë dhe feçe e pakontrolluar
- ☐ 0 - Nuk aplikohet

6. TRANSFERIMI

- ☐ 1- Mund të ulet/ngrihet nga kolltuku/karrigia/divani pa ndihmë
- ☐ 2 - Mund të ulet në kolltuk/karrige/divan, por do ndihmë të ngrihet
- ☐ 3 - Nevojë për ndihmë për t'u ulur/ngritur nga kolltuku/karrigia/divani
- ☐ 4 - Krejtësisht i varur për t'u ulur apo ngritur nga kolltuku/karrigia/divani
- ☐ 0 - Nuk aplikohet

7. LËVIZSHMËRIA

- ☐ 1 - Ecën i pavarur
- ☐ 2 - Ecën me ndihmë p.sh. duke u mbajtur nëpër mobiljet, kolltuqe për mbështetje
- ☐ 3 - Përdor mjete ndihmëse për të lëvizur përreth p.sh.deambulatorë, paterica, karrige me rrota, etj
- ☐ 4 - E ka të pamundur të ecë edhe me mbështetje
- ☐ 0 - Nuk aplikohet

8. MJEKIMI

- ☐ 1 - Merr vetë mjekimin e tij/saj
- ☐ 2 - Merr mjekimin e tij/saj, por duhet ta kujtojë.
- ☐ 3 - Nevojitet ndihmë për të marrë mjekimin e duhur
- ☐ 4 - Nevojitet t'i jepen mjekimet
- ☐ 0 - Nuk aplikohet

9. MBIKQYRJA

- ☐ 1- Nuk ka nevojë për mbikqyrje në shtëpi ose në komunitet
- ☐ 2 - Ka nevojë të shoqërohet në komunitet, por mund të qëndrojë vetëm në shtëpi për periudha të shkurtra, të cilat nuk tejkalojnë dy orë
- ☐ 3 - Ka nevojë të shoqërohet në komunitet, por mund të qëndrojë vetëm në shtëpi për periudha të zgjatura.
- ☐ 4 - Nevojitet mbikëqyrje e përhershme (dmth., të jetë vazhdimisht nën vëzhgimin e dikujt) në shtëpi ose në komunitet
- ☐ 0 - Nuk aplikohet

NEVOJAT SHTËPIAKE

10. PËRGATITJA E USHQIMIT

- ☐ 1 - Zgjedh dhe përgatit ushqimin, si kërkohet
- ☐ 2 - I/e aftë të përgatisë ushqimin, nëse i jepen përbërësit
- ☐ 3 - Mund të përgatisë ushqimin, nëse nxitet dhe mbikqyret hap pas hapi
- ☐ 4 - I pazoti të përgatisë ushqimin edhe kur nxitet ose mbikqyret
- ☐ 0 - Nuk aplikohet

11. TË NGRËNIT

- ☐ 1 - Ha në mënyrë të përshtatshme, duke përdorur takëmin e saktë
- ☐ 2 - Ha në mënyrë të përshtatshme, në qoftë se ushqimi është i menaxhueshëm dhe/ose përdor lugën
- ☐ 3 - Përdor gishtërinjtë/duart për t'u ushqyer (nuk përdor dot lugën apo pirunin)
- ☐ 4 - Ka nevojë për t'u ushqyer nga dikush tjetër
- ☐ 0 - Nuk aplikohet

12. PËRGATITJA E LËNGJEVE

- ☐ 1 - Zgjedh dhe përgatit lëngjet si kërkohet (ujë, qumësht, çaj, kafe, lëng portokalli, etj).
- ☐ 2 - I/e aftë të përgatisë lëngjet, nëse i jepen përbërësit (çaj, kafe, etj)
- ☐ 3 - Mund të përgatisë lëngjet dhe t'i shërbejë vetes (çaj, kafe, ujë, qumësht, etj.), nëse nxitet dhe mbikqyret hap pas hapi.
- ☐ 4 - I pazoti të përgatisë dhe t'i japë vetes lëngje (ujë, qumësht, lëng portokalli, çaj, kafe, etj.) edhe kur nxitet ose mbikqyret.
- ☐ 0 - Nuk aplikohet

13. TË PIRËT

- ☐ 1 - Pi lëngje në mënyrë të përshtatshme (gotë, filxhan, etj.).
- ☐ 2 - Pi lëngje në mënyrë të përshtatshme me mjete ndihmëse si pipëz etj.
- ☐ 3 - Megjithëse përpiqet, nuk mund të pijë vetë edhe me mjete ndihmëse si pipëz etj.
- ☐ 4 - Pi vetëm kur i japin të pijë me mjete ndihmëse.
- ☐ 0 - Nuk aplikohet

14. PUNË SHTËPIAKE

- ☐ 1 - Në gjendje të bëjë punët e shtëpisë/ të kopshtit, ashtu si kërkohet.
- ☐ 2 - Në gjendje të bëjë punët e shtëpisë /të kopshtit, por jo në standartet e duhura.
- ☐ 3 - Mund të bëjë dëmtim me nxitje dhe mbikqyrje
- ☐ 4 - Pa dëshirë/i pa aftë të marrë pjesë në punët e shtëpisë/kopshtit.
- ☐ 0 - Nuk aplikohet

15. PAZARI/BLERJET

- ☐ 1 - Në gjendje të bëjë blerjet e nevojshme (më shumë se tre artikuj)
- ☐ 2 - Në gjendje të blejë 1 ose 2 artikuj, me ose pa listë, por jo më shumë
- ☐ 3 - I/e paaftë të bëjë blerje/pazar vetëm, por merr pjesë kur është i/e shoqëruar
- ☐ 4 - I/e paaftë të marrë pjesë në blerje, as kur është i/e shoqëruar
- ☐ 0 - Nuk aplikohet

16. TRANSPORTI

- ☐ 1 - Në gjendje të ngasë makinën, bicikletën ose përdorë transportin publik në mënyrë të pavarur
- ☐ 2 - I/e paaftë të ngasë makinën, por përdor transportin publik, biçikletën etj
- ☐ 3 - I/e paaftë të përdorë transportin publik, vetëm, i pashoqëruar
- ☐ 4 - I/e paaftë të përdorë transportin publik edhe i/e shoqëruar
- ☐ 0 - Nuk aplikohet

17. FINANCAT

- ☐ 1 - Njeh vlerën e parave, përdor kartë krediti dhe është i/e përgjegjshëm për financat e tij
- ☐ 2 - Mund të njohë vlerën e parave, por nuk është përgjegjës për financat e tij si dhe të përdorë kartë krediti
- ☐ 3 - Ka disa njohuri për paratë (njeh kartmonedhat), por është i paaftë të njohë vlerën e parave dhe të kuptojë çmimin
- ☐ 4 - I/e paaftë të njohë vlerën e kartmonedhave
- ☐ 0 - Nuk aplikohet

NEVOJAT SHOQËRORE

18. KOMUNIKIMI

- ☐ 1 - Është në gjendje të filloje dhe të mbajë gjallë një bisedë
- ☐ 2 - Tregon se kupton dhe përpiqet të përgjigjet verbalisht dhe me gjepte
- ☐ 3 - Mund të komunikojë dëshirat e tij/saj, por ka vështirësi për të kuptuar të tjerët
- ☐ 4 - Nuk përgjigjet, apo komunikon gojarisht me të tjerë
- ☐ 0 - Nuk aplikohet

19. TELEFONI

- ☐ 1 - Përdor telefonin në mënyrë të përshtatshme, duke përfshirë edhe gjetjen e numrave saktësisht
- ☐ 2 - Përdor telefonin nëse i jepet numri ose i formulohet numri
- ☐ 3 - Përgjigjet në telefon, por nuk bën dot thirrje
- ☐ 4 - I/e paaftë/ pa dëshirë të përdorë telefonin
- ☐ 0 - Nuk aplikohet

20. AKTIVITETET ÇLODHËSE

- ☐ 1 - Merr pjesë në aktivitete çlodhëse dhe argëtuese, në përputhje me moshën, në mënyrë të pavarur
- ☐ 2 - Merr pjesë në aktivitete çlodhëse dhe argëtuese, por nevojitet udhëzim/mbikqyrje
- ☐ 3 - Heziton të bashkohet, të marrë pjesë në aktivitete çlodhëse dhe argëtuese, ka nevojë për nxitje dhe mbështetje
- ☐ 4 - Nuk ka mundësi/dëshirë të marrë pjesë në aktivitete çlodhëse dhe argëtuese
- ☐ 0 - Nuk aplikohet

21. TË SHKUARIT NË PUNË DHE/OSE SHKOLLË/FAKULTET
- ☐ 1 - Mund të shkojë në punë/shkollë/fakultet i/e pavarur
- ☐ 2 - I nevojitet trajnim për të mesuar rrugën/për të marrë autobusin, etj. për të shkuar në punë/shkollë/fakultet
- ☐ 3 - I nevojitet ndihmë për të shkuar në punë/shkollë/fakultet, por jo shoqërim i plotë
- ☐ 4 - I nevojitet shoqërim për të shkuar në punë/shkollë/fakultet
- ☐ 0 - Nuk aplikohet

22. ORIENTIMI NË HAPËSIRË
- ☐ 1 - Plotësisht i/e orientuar në mjedis/hapësirë.
- ☐ 2 - I/e orientuar vetëm në mjedise të njohura.
- ☐ 3 - Humbet nëpër shtëpi, nevojitet ta kujtosh/t'i tregosh ku është tualeti, etj.
- ☐ 4 - Nuk e njeh shtëpinë si të vetën dhe përpiqet të ikë.
- ☐ 0 - Nuk aplikohet

23. PËRDORIMI I RADIOS DHE TELEVIZORIT
- ☐ 1 - Përdor radion dhe/ose TV i/e pavarur
- ☐ 2 - Është i aftë të zgjedhë emisionin e pëlqyer të radio/TV, por nevojitet ndihmë në programimin
- ☐ 3 - Ka interes në disa programe të preferuar në radio dhe/ose televizive, por nuk mund të zgjedhë dhe të vendosë ato pa ndihmë
- ☐ 4 - Nuk ka interes në programe e radios dhe/ose TV
- ☐ 0 - Nuk aplikohet

24. ADVOKIMI
- ☐ 1 - Është në gjendje për të advokuar/mbrojtur nevojat e tij / saj në takime
- ☐ 2 - Është në gjendje për të advokuar/mbrojtur nevojat e tij / saj personalisht
- ☐ 3 - Ka nevojë të inkurajohet për të advokuar/mbrojtur nevojat e tij / saj
- ☐ 4 - Është i pazoti të advokojë/mbrojë të drejtat e tij
- ☐ 0 - Nuk aplikohet

25. PJESËMARRJA NË AKTIVITETE SHOQËRORE DHE ÇLODHËSE
- ☐ 1 - Mund të marrë pjesë vetë në aktivitete shoqërore dhe shlodhëse.
- ☐ 2 - I nevojitet të shoqërohet për në aktivitete shoqërore dhe shlodhëse, por mund të qëndrojë vetë.
- ☐ 3 - I nevojitet të shoqërohet për në dhe gjatë aktiviteteve shoqërore dhe shlodhëse, por nuk ka nevojë për ndihmë për të marrë pjesë.
- ☐ 4 - I nevojitet të shoqërohet për në dhe gjatë aktiviteteve shoqërore dhe shlodhëse dhe ka nevojë për
- ☐ 0 - Nuk aplikohet

Numri mesatar i orëve të shërbimit direkt ditor sipas nevojave individuale

- ☐ 1- 4 orë ☐ 5- 6 apo më shumë orë

KLAUZOLA DEKLARATIVE

Unë i/e nënshkruari/a _____ në dijeni të përgjegjësive penale që rrjedhin nga deklarimi dhe paraqitja e të dhënave e rrethanave të rreme, nën përgjegjësinë time personale deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta.

Nënshkrimi i aplikantit

Nënshkrimi i personit të autorizuar

Nënshkrimi i plotësuesit të formularit

Pozicioni

Agjencia

--	--	--	--	--	--	--	--

Data Muaji Viti

--	--	--	--	--	--	--	--

Data Muaji Viti

--	--	--	--	--	--	--	--

Data Muaji Viti



FORMULAR APLIKIMI
VËRTETIM PËR AFTËSINË E KUFIZUAR



SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

Nëse keni pyetje, lutemi kontaktoni: Tel: E-mail: Web:	HAPËSIRË E REZERVUAR VETËM PËR INSTITUCIONIN
Shënim: Ju lutem plotësoni me kujdes dhe qartë informacionin e kërkuar në fushat më poshtë, ME SHKRONJË TË MADHE E NË NGJYRË BLU.	

SEKSIONI A: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKANTIN

1. Emri		2. Mbiemri	
3. Emri i Babait		4. NID Nr. i identifikimit personal	
5. Gjinia	☐ Mashkull ☐ Femër	6. Datëlindja	
7. Vendlindja		8. Shtetësia	
9. Adresa			
10. Qyteti		11. Rrethi	
12. Kodi Postar		13. Nr. Tel	
14. E-mail		15. Nr. Sig shëndetësor	
16. Tipi i dokumentit të identifikimit	☐ Pasaportë ☐ Kartë Identiteti ☐ Certifikatë lindjeje me fotografi		

SEKSIONI B: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKIMIN

Zyra rajonale e vlerësimit të aftësisë së kufizuar

INFORMACION MJEKËSOR

Diagnoza 1		Kodi ICD	
Diagnoza 2		Kodi ICD	
Diagnoza 3		Kodi ICD	
Diagnoza 4		Kodi ICD	

DËMTIMET E FUNKSIONEVE TRUPORE

Funksioni	Kodi ICF	Cilësori
FUNKSIONET MENDORE	b1	
FUNKSIONET NDIJORE DHE DHIMBJA	b2	
FUNKSIONET E ZËRIT DHE LIGJËRIMIT	b3	
FUNKSIONET E SISTEMIT KARDIOVASKULAR, HEMATOLOGJIK, IMUNOLOGJIK DHE TË FRYMËMARRJES	b4	
FUNKSIONET E SISTEMEVE TË TRETJES, METABOLIZMIT DHE GJENDRAVE ENDOKRINE	b5	

FUNKSIONET GJENITOURINARE DHE TË RIPRODHIMIT	b6	
FUNKSIONET NEURO-MUSKULO-SKELETORË DHE ATO TË LIDHURA ME LËVIZJEN	b7	
FUNKSIONET E LËKURËS DHE STRUKTURAT E LIDHURA ME TË	b8	

DËMTIMET E STRUKTURAVE TRUPORE

Struktura trupore	Kodi ICF	Cilësori i dëmtimit		
		Shkalla	Loji	Vendi
STRUKTURAT E SISTEMIT NERVOR	s1			
SYRI, VESHI DHE STRUKTURAT E TJERA TË LIDHURA ME TO	s2			
STRUKTURAT, PËRFSHIRË ATO NË ZË DHE LIGJËRIM	s3			
STRUKTURAT E SISTEMEVE KARDIOVASKULARE, IMUNOLOGJIKE DHE RESPIRATORE	s4			
STRUKTURAT E LIDHURA ME SISTEMET E TRETJES, METABOLIZMIT DHE ENDOKRINALE	s5			
STRUKTURAT E LIDHURA ME SISTEMET GJENITALE DHE TË RIPRODHIMIT	s6			
STRUKTURAT E LIDHURA ME LËVIZJEN	s7			
LËKURA DHE STRUKTURAT E LIDHURA ME TË	s8			

AKTIVITETET DHE PJESËMARRJA

TË NXËNIT DHE ZBATIMIN E NJOHURIVE
KRERJA E DETYRAVE TË PËRGJITHSHME
KOMUNIKIMI
LËVIZJA/MOBILITETI
KUJDESI PËR VETEN
JETA SHITËPIAKE
MARRËDHËNIET ME TË TJERËT
FUSHAT KRYESORE TË JETËS, ARSIMIMI, PUNËSIMI
KOMUNITETI, JETA SHOQËRORE DHE QYTETARE

Kodi ICF	SHKALLA E VËSHTIRËSIVE				
d1	Lehtë	Mod	Rëndë	Plotë	
d2	Lehtë	Mod	Rëndë	Plotë	
d3	Lehtë	Mod	Rëndë	Plotë	
d4	Lehtë	Mod	Rëndë	Plotë	
d5	Lehtë	Mod	Rëndë	Plotë	
d6	Lehtë	Mod	Rëndë	Plotë	
d7	Lehtë	Mod	Rëndë	Plotë	
d8	Lehtë	Mod	Rëndë	Plotë	
d9	Lehtë	Mod	Rëndë	Plotë	

FAKTORËT MJEDISORË ME NDIKIM PENGUES

PRODUKTE DHE TEKNOLOGJI
MJEDISI NATYROR
MBËSHTETJA DHE MARRËDHËNIET
QËNDRIMET PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR DHE PËRFSHIRJEN E TYRE NË SHOQËRI
SHËRMBIMET, SISTEMET DHE POLITIKAT

Kodi ICF	SHKALLA E NDIKIMIT				
e1	Lehtë	Mod	Rëndë	Plotë	
e2	Lehtë	Mod	Rëndë	Plotë	
e3	Lehtë	Mod	Rëndë	Plotë	
e4	Lehtë	Mod	Rëndë	Plotë	
e5	Lehtë	Mod	Rëndë	Plotë	

FAKTORËT PERSONALË

1. Viti i lindjes

Data		Muaji		Viti			

2. Gjinia

☐ Mashkull

☐ Femër

3. Arsimi

☐ Pa arsim

☐ Fillor

☐ 9-vjeçar

☐ I mesëm

☐ I lartë

4. Kategoria e aftësisë së kufizuar

☐ Dëmtim në shikim

☐ Autizëm

☐ Sëmundje kronike

☐ Shëndet mendor

☐ Aftësi e kufizuar intelektuale

☐ Dëmtim në të dëgjuar

☐ Dëmtime ortopedike

5. Niveli i dëmtimit të aftësive funksionale

☐ I lehtë

☐ I moderuar

☐ I rëndë

☐ I thellë/ i plotë

PËRCAKTIMI I PËRFITIMEVE

6. Përfitime në para (fëmijë 0-18 vjeç)

☐ Niveli 1 (i lehtë)

☐ Niveli 2 (i moderuar)

☐ Niveli 3 (i rëndë)

☐ Niveli 4 (i thellë/ i plotë)

7. Përfitime në para (për të rritur)

☐ Niveli 1 (i lehtë)

☐ Niveli 2 (i moderuar)

☐ Niveli 3 (i rëndë)

☐ Niveli 4 (i thellë/ i plotë)

8. Ndihmësi personal

☐ Niveli 4 (Mbështetje e përhershme)

☐ Niveli 3 (Mbështetje e herëpashershme)

REKOMANDIME PËR SHËRBIME

☐ Shërbime të edukimit special

☐ Trajnim profesional dhe mbështetje në lidhje me të

☐ Shërbimet e punësimit dhe mbështetje në lidhje me to

☐ Shërbime ditore

9. Teknologji asistive (përfshin mjetet e lëvizjes dhe komunikimit):

☐ Karrige me rrota

☐ Mjete ndihmëse në shikim

☐ Mjete ndihmëse në dëgjim

☐ Proteza

☐ Orteza

☐ Printim në Braille

☐ Paterica/deambulatorë

☐ Tjetër (specifiko)

--

☐ Shërbime rezidenciale

☐ Terapi fizike

☐ Gjuha e shenjave

☐ Këshillim/ Psikoterapi

☐ Shërbime transporti

☐ Të tjera (specifiko)

--

VLEFSHMËRIA

10. Vlefshmëria e certifikatës (në vite)

--

11. Certifikata bëhet e pavlefshme në

Data		Muaji		Viti			

VENDI DHE DATA E LËSHIMIT

12. Vendi

--

13. Data

Data		Muaji		Viti			

KLAUZOLA DEKLARATIVE

Unë i/e nënshkruari/a _____ në dijeni të përgjegjësive penale që rrjedhin nga deklarimi dhe paraqitja e të dhënave e rrethanave të rreme, nën përgjegjësinë time personale deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta.

ANËTARËT E EKIPIT MULTIDISCIPLINAR TË VLERËSIMIT

	Mjeku	Punonjësi social	Drejtuesi i Zyrës së Vlerësimit
Emri			
Mbiemri			
Nënshkrimi			



FORMULAR APLIKIMI

VLERËSIMI MJEKËSOR PËR PËRCAKTIMIN E AFTËSISË SË KUFIZUAR FORMA E KONTROLLIT MJEKËSOR VJETOR

SHËRBIMI SOCIAL SHETËROR
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE



Nëse keni pyetje, lutemi kontaktoni:

Tel:
E-mail:
Web:

HAPËSIRË E REZERVUAR VETËM PËR INSTITUCIONIN

Shënim: Ju lutem plotësoni me kujdes dhe qartë
informacionin e kërkuar në fushat më poshtë,
ME SHKRONJË TË MADHE E NË NGJYRË BLU.

SEKSIONI A: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKANTIN

1. Emri		2. Mbiemri	
3. Emri i Babait		4. NID Nr. i identifikimit personal	
5. Gjinia	☐ Mashkull ☐ Femër	6. Datëlindja	
7. Vendlindja		8. Shtetësia	
9. Adresa			
10. Qyteti		11. Rrethi	
12. Kodi Postar		13. Nr. Tel	
14. E-mail		15. Nr. Sig shëndetësor	

SEKSIONI A1: INFORMACION SPECIFIK MBI MJEKUN

1. Emri		2. Mbiemri	
3. Numri i licencës		4. Specialiteti	
5. Adresa			
6. Qyteti		7. Rrethi	
8. Kodi Postar		9. Nr. Tel	
10. E-mail			

SEKSIONI B: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKIMIN

Plotësoni fushat e mëposhtme mbi aftësinë e kufizuar të pacientit tuaj me përgjegjësi. Informacioni do të përdoret si evidencë mjekësore për vazhdimin apo ndërprerjen e përfitimit të aftësisë së kufizuar.

1. A është kjo hera e parë që ju e vizitoni pacientin për rekomandim të përfitimit të pagesës së aftësisë së kufizuar?
☐ Po ☐ Jo

2. Nëse "jo", për sa kohë e keni trajtuar pacientin?

3. Nëse "jo", sipas të dhënave tuaja, sa herë e keni vizituar pacientin në 12 muajt e fundit?

4. Cila është diagnoza kryesore e pacientit? Shënoni emërtimin për diagnozën që përkon me Udhëzuesin e Vlerësimit Bio-Psiko-Social.

Data e shfaqjes (Viti)

5. A ka diagnoza të tjera (nëse janë të aplikueshme)? Shënoni emërtimin për diagnozën që përkon me emërtimin në Udhëzuesin e Vlerësimit Bio-Psiko-Social.

--	--	--	--	--	--	--	--

Data e shfaqjes (Viti)

--	--	--	--	--	--	--	--

Data e shfaqjes (Viti)

--	--	--	--	--	--	--	--

Data e shfaqjes (Viti)

6. Shënoni gjetjet klinike më kryesore si dhe rezultatet e çdo testi mjekësor dhe/ose analiza laboratorike të KRYERA NË TRE MUAJT E FUNDIT, duke përfshirë edhe këtë vizitë:

a.

b.

c.

d.

e.

7. Përshkruani çdo trajtim mjekësor të bërë në vitin e fundit dhe rezultatet e trajtimit:

Trajtimet

Rezultatet e trajtimit

8. Sipas opinionit tuaj, mendoni që gjendja e pacientit ka ndryshuar që prej vizitës së një viti më parë?

☐

Po

☐

Jo

9. A rekomandoni ri-vlerësim për përfitimin e aftësisë së kufizuar?

☐

Po

☐

Jo

10. Nëse po, shënoni arsyen/arsyet kryesore:

☐

Ndryshime në shkallë e aftësisë së kufizuar

☐

Ka nevojë për ndihmës personal

☐

Ka nevojë për paketë higjienike

SEKSIONI C: DOKUMENTACIONI I PARAQITUR

Bashkëngjisni të gjitha dokumentet/shënime të duhura mjekësore, klinike dhe laboratorike që ju keni për pacientin dhe përdorni hapësirën më poshtë për çdo koment apo informacion shtesë që ju mendojnë të nevojshëm. Mos e plotësoni dhe firmosni formularin nëse këto dokumente/shënime mjekësore, klinike apo laboratorike mungojnë. Personi mund të humbasë përfitimin e aftësisë së kufizuar nëse këto dokumente mungojnë.

--

KLAUZOLA DEKLARATIVE

Unë i/e nënshkruari/a _____ në dijeni të përgjegjësive penale që rrjedhin nga deklarimi dhe paraqitja e të dhënave të rreme, nën përgjegjësinë time personale deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta.

Nënshkrimi i Mjekut

--

Data	Muaji	Viti					

UDHËZIM Nr. 596, datë 1.8.2019

MBI PËRCAKTIMIN E MASËS PËR PËRFITIMIN E PAGESËS SË AFTËSISË SË KUFIZUAR E TË NDIHMËSIT PERSONAL

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, nenit 42/3, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, pikave 2, 3, 16 dhe 17, të kreut IV të vendimit nr. 431, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit, procedurave dhe të masës për përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre në zonat pilot”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Paga bazë për shkak të aftësisë së kufizuar, e përcaktuar në pikën 2, të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, të ndryshuar, është 10,871 (dhjetëmijë e tetëqind e shtatëdhjetë e një) lekë në muaj.

2. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2 germa “a”, të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, të ndryshuar, për personat mbi 18 vjeç, është 6,523 (gjashtëmijë e pesëqind e njëzet e tre) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, germa “a”, të kreut I të vendimit.

3. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2 germa “b”, të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, të ndryshuar, për personat mbi 18 vjeç, është 8,697 (tetëmijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, germa “a”, të kreut I të vendimit.

4. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2 germa “c”, të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, të ndryshuar, për personat mbi 18 vjeç, është 10,871 (dhjetëmijë e

tetëqind e shtatëdhjetë e një) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, germa “a”, të kreut I të vendimit.

5. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2 germa “ç”, të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, të ndryshuar, për personat mbi 18 vjeç, është 13,045 (trembëdhjetëmijë e dyzet e pesë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, germa “a”, të kreut I të vendimit.

6. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2 germa “d”, të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, të ndryshuar, për fëmijët, është 4,892 (katërmijë e tetëqind e nëntëdhjetë e dy) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, germa “a”, të kreut I të vendimit.

7. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2, germa “dh”, të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, të ndryshuar, për fëmijët, është 6,523 (gjashtëmijë e pesëqind e njëzet e tre) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, germa “a”, të kreut I të vendimit.

8. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2 germa “e”, të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, të ndryshuar, për fëmijët, është 8,153 (tetëmijë e njëqind e pesëdhjetë e tre) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, germa “a”, të kreut I të vendimit.

9. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2 germa “ë”, të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, të ndryshuar, për fëmijët, është 9,785 (nëntëmijë e shtatëqind e tetëdhjetë e pesë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, germa “a”, të kreut I të vendimit.

10. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 16, të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, të ndryshuar, për shërbimet gjithëpërfshirëse të ndihmësit personal, është 13,045 (trembëdhjetëmijë e dyzet e pesë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, germa “a”, të kreut I të vendimit.

11. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 17, të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, të ndryshuar, për shërbimet e herëpashershme të ndihmësit personal, është 8,697 (tetëmijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, germa “a”, të kreut I të vendimit.

12. Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtatori i vitit 2019 dhe përballohen me fondet e akorduara për vitin 2019, për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

13. Udhëzimi nr. 629, datë 27.8.2018, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe shtrin efektet nga 1.9.2019.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

VENDIM
Nr. 566, datë 29.9.2018

PËR PROCEDURAT E KRYERJES SË KONTROLLIT TË VEPRIMTARISË E TË ZBATIMIT TË LEGJISLACIONIT PËR NDIHMËN EKONOMIKE DHE AFTËSINË E KUFIZUAR NË STRUKTURAT E VARËSISË SË SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR DHE PRANË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “e”, të pikës 5, të nenit 27, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kontrolli i ndihmës ekonomike dhe pagesës për personat me aftësi të kufizuara bëhet nga struktura përgjegjëse në Shërbimin Social Shtetëror, në nivel qendror dhe rajonal, sipas procedurave të përcaktuara në këtë vendim.

2. Kontrolli i strukturave rajonale dhe me përzgjedhje në njësitë e vetëqeverisjes vendore bëhet nga struktura përgjegjëse e Shërbimit Social Shtetëror në nivel qendror, bazuar në planin vjetor të kontrollit dhe në programet mujore në zbatim të tij. Programi i kontrollit miratohet nga titullari i institucionit, sipas modelit standard, të përcaktuar me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet sociale.

3. Kontrolli i njësive të vetëqeverisjes vendore nga strukturat përgjegjëse në Shërbimin Social Shtetëror në nivel rajonal bazohet në planin vjetor të kontrollit dhe në programet mujore në zbatim të tij. Programi i kontrollit miratohet nga titullari i institucionit, sipas modelit standard, të përcaktuar me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet sociale.

4. Programi i kontrollit duhet të përmbajë:

- a) Subjektet, që do të kontrollohen;
- b) Llojin e kontrollit, që do të ushtrohet;
- c) Periudhën, për të cilën do të bëhet kontrolli;
- ç) Objektivat që duhet të realizohen.

5. Kontrolli programohet për çdo muaj. Kontrolli mund të jetë i plotë ose tematik, sipas analizës së riskut. Në çdo rast, përpara kryerjes së kontrollit subjekti njoftohet me shkrim për fillimin e kontrollit, qëllimin, si dhe objektivat që do të realizohen. Kontrolli nga struktura përgjegjëse për pagesat e ndihmës ekonomike dhe të aftësisë së kufizuar, në nivel qendror ose rajonal, do të jetë si më poshtë vijon:

a) Struktura përgjegjëse për pagesat e ndihmës ekonomike dhe të aftësisë së kufizuar në nivel qendror kryen kontroll të plotë një herë në dy vjet për strukturat rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe, duke zbatuar metodën me përzgjedhje, në bazë të analizës së riskut, kryen kontrole tematike për veprimtarinë e njësive të vetëqeverisjes vendore;

b) Struktura përgjegjëse për pagesat e ndihmës ekonomike dhe të aftësisë së kufizuar në nivel rajonal kryen kontroll të plotë një herë në dy vjet në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe kontrole tematike, sipas analizës së riskut, në përputhje me programin e kontrollit, të përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi.

6. Kontrolli mund të jetë i paparalajmëruar, në rastet kur ka sinjalizime për abuzime ose shkelje ligjore nga subjekti përkatës.

7. Sinjalizime konsiderohen:

a) Njoftime me shkrim ose me mjete të tjera komunikimi të personave të interesuar për veprimtarinë e subjektit, pasi ky veprim të jetë vlerësuar si abuziv;

b) Njoftime ose ankime të çdo forme, nga entet publike;

c) Raporte specifike, të gjeneruara nga sistemi.

8. Grupi i kontrollit në nivel qendror ushtron kontroll për zbatimin e legjislacionit për ndihmën ekonomike, për:

a) Veprimtarinë e strukturave rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe, me përzgjedhje, të njësisë të vetëqeverisjes vendore, të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit për ndihmën ekonomike;

b) Veprimtarinë e strukturave vendore në bashki dhe njësi administrative, të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit të ndihmës ekonomike, duke kryer me përzgjedhje, sipas analizës së riskut, kontrolle tematike;

c) Procedurën e kryerjes së verifikimeve automatike në drejtoritë rajonale, nëpërmjet Regjistrat Elektronik Kombëtar të Ndhmës Ekonomike dhe verifikimeve manuale, nëse ka;

ç) Procedurën e vendimmarrjes për familjet aplikuese dhe përfituese të ndihmës ekonomike;

d) Performancën e strukturave rajonale të Shërbimit Social Shtetëror në kryerjen e kontrollit të ndihmës ekonomike në njësitë të vetëqeverisjes vendore.

9. Grupi i kontrollit të strukturave rajonale ushton kontroll për zbatimin e legjislacionit për ndihmën ekonomike, për:

a) Veprimtarinë e strukturave vendore në bashki dhe njësi administrative, të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit përkatës për ndihmën ekonomike;

b) Dokumentacionin dhe procedurën e kryerjes së aplikimeve në Regjistrin Elektronik Kombëtar të Ndhmës Ekonomike, si dhe dokumentacionin në dosjen e përfituesit të ndihmës ekonomike;

c) Dokumentacionin e kategorive përfituese të ndihmës ekonomike dhe afatin e vlefshmërisë së përfitimit, sipas legjislacionit në fuqi;

ç) Kryerjen e verifikimeve social-ekonomike nga administratorët shoqërorë, afatet dhe pasqyrimin e tyre në sistem;

d) Përputhshmërinë e deklaramentit të familjes përfituese me vizitën në shtëpi, të pasqyruar nga administratori shoqëror në sistem, nëpërmjet realizimit të verifikimeve social-ekonomike me përzgjedhje;

dh) Familjet që kanë rezultuar me deklarament të rremë dhe afatin e përjashtimit të tyre nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë 6-mujore, sipas legjislacionit në fuqi;

e) Deklarimet tremujore të ndryshimit të situatës social-ekonomike të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike;

ë) Aplikimet e familjeve që kanë në përbërjen e tyre një person me aftësi të kufizuara, invalid pune etj.;

f) Procedurën e ndjekur ndërmjet bashkisë dhe postës/bankës për rakordimin dhe marrjen e informacionit për listën emërore të familjeve që nuk kanë tërhequr ndihmën ekonomike brenda afatit, si dhe ndjekjen e procesit të largimit të familjes nga përfitimi i ndihmës ekonomike;

g) Përputhjen ndërmjet borderosë dhe thesarit, numrit të familjeve përfituese dhe shumave të përfitimit të ndihmës ekonomike;

gj) Saktësinë e të dhënave në planifikimin e nevojave për fonde;

h) Mënyrën e planifikimit të fondit të ndihmës ekonomike dhe plotësimin e të dhënave statistikore, sipas legjislacionit në fuqi;

i) Procedurat dhe dokumentacionin e shpërndarjes së pagesave të ndihmës ekonomike për familjet që mbështeten me fondin deri në 6%, në bazë të kriterëve të miratuara nga këshilli bashkiak dhe sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

j) Dokumentacionin dhe pagesat e kompensimit të energjisë elektrike për familjet përfituese të skemës së ndihmës ekonomike.

10. Grupi i kontrollit në nivel qendror dhe rajonal ushtron kontroll për zbatimin e legjislacionit për personat me aftësi të kufizuara, për:

a) Veprimtarinë e strukturave vendore në bashki dhe njësitë administrative, të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit për pagesën e aftësisë së kufizuar;

b) Dokumentacionin e përfitimeve të aftësisë së kufizuar në dosjen fizike të përfituesit;

c) Përputhjen ndërmjet listëpagesave dhe thesarit, numrit të përfituesve dhe shumave të përfitimit të pagesës për aftësinë e kufizuar;

ç) Saktësinë e të dhënave në planifikimin e nevojave për fonde;

d) Mënyrën e planifikimit të fondit të pagesave të aftësisë së kufizuar, sipas legjislacionit në fuqi.

11. Grupi i kontrollit harton projektraportin për kontrollin e kryer dhe një kopje ia dorëzon subjektit të kontrolluar, i cili, brenda 10 ditëve pune paraqet vërejtjet apo kundërshtitë, nëse ka, të argumentuara me dokumentacionin përkatës.

12. Raporti përfundimtar i kontrollit bëhet nga grupi i kontrollit, i cili vlerëson vërejtjet apo kundërshtitë e subjektit të kontrolluar dhe jep argumentet përkatëse në raport.

13. Titullari i institucionit ia paraqet raportin përfundimtar:

a) Kryetarit të Bashkisë;

b) Prefektit të qarkut;

c) Drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit Social Shtetëror;

ç) Drejtorit rajonal të Shërbimit Social Shtetëror.

14. Në raportin përfundimtar evidentohen të gjitha shkeljet e konstatuara nga strukturat përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit për ndihmën ekonomike dhe pagesat e aftësisë së kufizuar, propozimet përkatëse për përmirësimin e gjendjes dhe masat për personat përgjegjës, si më poshtë vijon:

a) Masë disiplinore për shkelje nga strukturat rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, lidhur me:

i. verifikimin e të dhënave nëpërmjet regjistrit kombëtar elektronik dhe në autoritetet shtetërore përgjegjëse;

ii. caktimin e familjes/individëve në nevojë, përfitues të ndihmës ekonomike;

iii. refuzimin e përfitimit të ndihmës ekonomike;

iv. dërgimin e vendimit kryetarit të bashkisë.

b) Masë disiplinore për shkelje nga struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki, lidhur me:

i. hartimin e projektvendimit për familjet/ individët në nevojë/përfituesit e pagesave të aftësisë së kufizuar;

ii. propozimin e tij në këshillin bashkiak;

iii. hartimin e kërkesave për ndihmën ekonomike dhe pagesat për personat me aftësi të kufizuara për buxhetin dhe projektbuxhetin për vitin pasardhës;

iv. grumbullimin dhe përgatitjen e informacioneve e të statistikave;

v. regjistrin e përfituesve;

vi. ndjekjen e shpenzimeve për ndihmën ekonomike dhe pagesat e personave me aftësi të kufizuara.

c) Masë disiplinore për shkelje, në lidhje me:

i. identifikimin e familjeve që kanë nevojë për ndihmë ekonomike dhe personat me aftësi të kufizuara;

ii. verifikimin e gjendjes shoqërore dhe ekonomike të familjeve në nevojë;

iii. paraqitjen e të dhënave pranë strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki për familjet/individët në nevojë, të cilët kanë aplikuar për ndihmë ekonomike dhe personat me aftësi të kufizuara;

iv. përgatitjen dhe administrimin e dokumentacionit për personat që aplikojnë për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe të pagesës së aftësisë së kufizuar;

v. hartimin e kërkesave për bllokndihmën dhe fondin e pagesës së personave me aftësi të kufizuara çdo dymujor;

vi. hedhjen në regjistrin elektronik kombëtar të të dhënave të deklaruara nga aplikuesit për ndihmë ekonomike.

ç) Gjohë, nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë, në rastet kur vërehet që shkeljet e përcaktuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të kësaj pike, janë kryer në mënyrë të përsëritur;

d) Shpërblimin e dëmit nga administratori shoqëror dhe/ose familja dhe/ose punonjësi i strukturës rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, nëse konstatohet se është shkaktuar dëm ekonomik;

dh) Kallëzim penal, në rast se dyshohet se janë konsumuar elementet e veprës penale. Struktura përgjegjëse për kontrollin e ndihmës ekonomike dhe të pagesave për personat me aftësi të kufizuara, kur vlerëson se janë konsumuar elementet e veprës penale nga personat e ngarkuar për zbatim, bën kallëzimin penal pranë autoriteteve kompetente për shkelësit e ligjit.

Çdo shkelje e menaxhimit të fondeve buxhetore, që programohen e përdoren për ndihmën ekonomike dhe pagesën e aftësisë së kufizuar, kur nuk përbën vepër penale përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjohë, sipas përcaktimeve të nenit 71, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

15. Vendimi nr. 512, datë 31.5.2006, i Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e kryerjes së kontrollit të ndihmës ekonomike, të pagesës së aftësisë së kufizuar dhe të shërbimeve shoqërore”, i ndryshuar, shfuqizohet.

16. Ngarkohet ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për nxjerrjen e udhëzimeve për metodologjinë e kontrollit të pagesave të ndihmës ekonomike, metodologjinë e kontrollit të pagesave të aftësisë së kufizuar dhe mekanizmat e monitorimit.

17. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

UDHËZIM **Nr. 26, datë 25.11.2019**

PËR MËSUESIN NDIHMËS PËR NXËNËSIT ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 65/3, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

KREU I **KRITERET DHE PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES SË MËSUESIT NDIHMËS**

1. Mësuesi ndihmës, për nxënësit me aftësi të kufizuara (AK) në institucionet arsimore publike, duhet të plotësojë këto kritere:

a) të jetë i pajisur me licencë mësuesi në profilin “Arsim special”;

b) kur nuk ka mësues të profilit “Arsim special”, të jetë i pajisur me diplomë të ciklit të dytë në fushën e edukimit, konform kërkesave të nenit 57, pika 2, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të ketë kryer trajnime për arsimimin e nxënësve me aftësi të kufizuara dhe të jetë i pajisur me certifikatë/dëshmi/diplomë që vërteton këtë kompetencë profesionale të shtuar.

2. Procedurat e përzgjedhjes së mësuesit ndihmës janë në përputhje me udhëzimin për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet publike

të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”.

3. Norma mësimore javore e mësuesit ndihmës dhe qëndrimi fizik në institucionin arsimor është i njëjtë me atë të mësuesit të zakonshëm në klasë, sipas udhëzimit për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar.

4. Një mësues ndihmës mund të punojë me 2 deri në 3 nxënës me aftësi të kufizuara brenda të njëjtë institucion arsimor, sipas rekomandimit të Komisionit Multidisiplinar të ngritur pranë Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP-ve), bazuar në nivelin e vështirësisë dhe të nevojës për mbështetje që paraqet nxënësi.

5. Në një klasë ku ka më shumë se një nxënës me AK nuk mund të punojë më shumë se një mësues ndihmës.

6. Komisioni Multidisiplinar i ngritur pranë ZVAP-ve, mbështetur në dokumentacionin e paraqitur për çdo nxënës nga prindi/kujdestari ligjor apo nga institucioni arsimor, vlerëson shkallën e vështirësisë së nxënësit dhe përcakton:

- a) nevojat arsimore të nxënësit;
- b) nevojën për mësues ndihmës në klasë;
- c) nevojën për mësues ndihmës në shtëpi;
- ç) numrin e orëve mësimore të nevojshme për çdo nxënës me AK dhe e shënon atë në dosjen e vlerësimit;
- d) pas çdo vlerësimi (një herë në vit) bën rivlerësim të nevojës së nxënësit për mësues ndihmës.

7. Bazuar në këtë vlerësim dhe në pikën 5 dhe shkronjën “d”, të pikës 6 të këtij udhëzimi, drejtori i shkollës, në bashkëpunim me komisionin e shkollës, përcakton numrin e orëve që një mësues ndihmës do të ketë për çdo fëmijë me AK, brenda klasës ose në shtëpi.

KREU II DETYRAT E MËSUESIT NDIHMËS

1. Mësuesi ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara ka këto detyra kryesore:

- a) punon për zhvillimin e plotë të potencialit intelektual, socioemocional, zhvillimor e fizik të nxënësit;
- b) njeh dhe zbaton pedagogjinë me në qendër nxënësin dhe ndihmon në krijimin e mjedisit gjithëpërfshirës të të nxënësit;
- c) në bashkëpunim me mësuesin e klasës/mësuesin lëndor, psikologun, punonjësin social të shkollës dhe prindin, harton dhe zbaton programin edukativ individual (PEI), të miratuar nga komisioni i shkollës për nxënësit me AK;
- ç) në bashkëpunim me mësuesin e klasës/mësuesin lëndor planifikon ndërhyrjet për të plotësuar nevojat më prioritare të të nxënësit për nxënësin;
- d) bashkëpunon me mësuesin e lëndës dhe me shërbimin psikosocial të institucionit arsimor për vlerësimin e nxënësit, sipas nivelit të arritjeve të fushave të zhvillimit të përcaktuara në PEI;
- dh) asiston nxënësin gjatë procesit mësimor, si brenda, ashtu dhe jashtë klasës, për të bërë të mundur pjesëmarrjen e tij/saj sa më të plotë në të gjitha orët mësimore dhe në aktivitetet shkollë;
- e) në ato shkolla ku ekzistojnë hapësira zhvillimore, shfrytëzon mundësitë për të zbatuar program kurrikular alternativ në përputhje me PEI-n e nxënësit;
- ë) punon në bashkëpunim me psikologun e shkollës, punonjësin social ose stafin e specializuar për zhvillimin e nxënësi të aftësive sociale, emocionale, zhvillimore dhe aftësive të tjera për jetën, duke nxitur dhe stimuluar kalimin e nxënësit nga varësia në pavarësi;
- f) ndjek dhe dokumenton aspektet e ecurisë, si dhe ruan e respekton konfidencialitetin e informacionit për nxënësin, sipas ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar;

g) punon me nxënësit me AK krahas mësuesit në të gjitha orët mësimore apo në një pjesë të tyre, gjithashtu jashtë klasës, me nxënës të veçantë me AK ose me grupe të vogla të klasave I–III, IV–V, VI–IX dhe X–XII, bazuar në rekomandimin e komisionit multidisiplinar të ZVAP-së, sipas një orari të miratuar nga drejtoria e shkollës;

gj) ndjek trajnimet e ofruara për zhvillimin e tij profesional me parimet e arsimit gjithëpërfshirës dhe arsimit special;

h) raporton në komisionin e shkollës mbi ecurinë e fëmijës dhe realizimin e PEI-t.

2. Mësuesi ndihmës informon prindërit/kujdestarët ligjorë për progresin mësimor dhe zhvillimor të nxënësit në takime të përcaktuara nga drejtoria e shkollës.

3. Mësuesit dhe mësuesi ndihmës bashkëpunojnë me prindërit, në mënyrë që veprimtaritë që zhvillohen dhe njohuritë e marra në institucionin arsimor dhe në shtëpi, të plotësojnë dhe të përforcojnë njëra-tjetrën.

4. Mësuesi ndihmës, mësuesi kujdestar, shërbimi psikosocial i institucionit arsimor informon prindërit/kujdestarët ligjorë të nxënësit me AK për shërbime të specializuara për të cilat ka nevojë nxënësi, të cilat ofrohen në shkollë ose në zonë.

5. Në ato zona ku ekzistojnë shërbime lëvizëse të operatorëve socialë të asistencës shtëpiake për fëmijët me AK, që nuk aksesojnë dot një institucion arsimor, mësuesi ndihmës bashkërendon punën për të ofruar shërbimin së bashku me ekipin lëvizës të asistencës shtëpiake.

KREU III DISPOZITAT E FUNDIT

1. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

2. Udhëzimi nr. 38, datë 7.10.2014, “Për kriteret e mësuesit ndihmës për nxënësit më aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi.

3. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
Besa Shahini

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Qendra e Botimeve Zyrtare

Përmbledhje legjislacioni për personat me aftësi të kufizuar /

Qendra e Botimeve Zyrtare. - Tiranë : QBZ, 2020

... f. ; ... cm.

ISBN 978-9928-01-115-2

1.E drejta 2.Të paaftë 3.Ligje 4.Shqipëri

342 .726 -056(496.5)

Tirazhi 50